



Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Analizë Krahasimore e Ndikimeve Shoqërore – Politike të Diplomacisë Perëndimore në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut

Mentori:
Pr.Dr.Hasan Jashari

ID:120786

Kandidati:
Ramadan Ramadani

Tetovë, 2019

Përmbajtja

KAPITULLI I.....	4
Aspekti metodologjik	4
2. Qëllimet e hulumtimit	5
3. Hipotezat	5
3.1 Hipoteza gjenerale.....	5
3.2 Hipoteza e vecantë	5
4. Metodologjia e hulumtimit.....	5
5. Rëndësia e punimit.....	6
6. Strukturimi i punimit.....	6
KAPITULLI II	7
• Analiza teorike e problemit	7
• Autorë të ndryshëm për Diplomacinë me Kosovën	11
• Kushtet aktuale shoqëro- politike në Kosovë.....	12
• Privatizimi, AKM-AKP-ja dhe prona në Kosovë.....	15
• Njohja e shtetit të Kosovës dhe vendet e BE-së që nuk e njohën atë	16
• Zbatimi i Paketës së Ahtisarit dhe Veriu i Kosovës	17
• Katër komuna serbe në Anamoravë.....	19
• Veriu i Kosovës dhe bisedimet me Serbinë	20
• Papunësia, varfëria , migrimi i popullsisë.....	21
• Ngërcet politike pozitë-opozitë.....	25
• Bisedat Kosovë –Serbi	27
• Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkrimi i Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015	34
• Marëveshja sot dhe si më tutje?.....	37
• Realizimi i Marëveshjes të Brukselit	38
• Roli i diplomacisë përëndimore në biseda	40
• Liberalizmi i vizave: një premtim i parealizuar.....	42
• Bashkëpunimi me SHBA	44
KAPITULLI III	45

• Analiza teorike e problemit	45
• Autorë të ndryshëm për Diplomacinë me Maqedoninë e veriut	48
• Pak histori: qasja e Bashkimit Evropian dhe SHBA ndaj Maqedonisë së Veriut	49
• Kushtet shoqëroro- politike në Maqedoninë e Veriut	50
• Papunësia, varfëria , migrimi i popullsisë.....	51
• Diplomacia ekonomike	52
• Ngërcet politike në mes VMRO-së dhe LSDM-së ; ndërmjetësimi i vazhdueshëm i diplomacisë përëndimore	55
• Marëveshja e Përzhinos.....	56
• Marëveshja e Prespës.....	58
• Roli i diplomacisë përëndimore	60
• Diplomacia ekonomike	62
• Thirja për antarësim në NATO dhe hapja e bisedave për BE-në	63
KAPITULLI IV	67
• Rezultatet e Anketimit te 50 respondentëve.....	67
• Intervista me 3 Diplomatë të huaj dhe 2 funksionarë te Minsitrisë të punëve të jashtme dhe 1 ekspert- profesor	70
<i>Intervista</i>	71
KAPITULLI V	75
• Rekomadime dhe përfundime	75
BIBLIOGRAFIA	76

KAPITULLI I

Aspekti metodologjik

Abstrakt

Diplomacia perëndimore , BE dhe SHBA, kanë qenë të angazhuara së tepërmi në dy decenjet e fundit në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Mosëmarveshjet me fqinjët, korupcioni, lufta për pushtet në mes pozitës dhe opozitës, parregullsitë në zgjedhje, janë vetëm disa nga pikat e nxeha ku diplomacia perëndimore ka qenë shpëtues i përhershëm i situatatve të rënduara shoqëroro-politike. Nga aspekti shoqëroro-politik diplomacia perëndimore ka patur efekt të drejtëpërdrejt në eliminimin e varëfrisë, papunësisë, përmirësimin e shërbimeve në arsim, shëndetësi, mbrojtje dhe siguri etj.

Duke përshëndetur ratifikimin e marrëveshjes së Prespes nga parlamenti në Shkup, Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi deklaroi se marrëveshja e emrit mund të shërbejë si një model për zgjidhjen e një sërë mosmarrëveshjesh midis Prishtinës dhe Beogradit. Në një post në Facebook, ai tha se shpreson që viti 2019 të jetë "një vit i vendimeve të mëdha" gjatë së cilës Kosova dhe Serbia mund t'i japin fund konfliktit të përjetshëm duke i ndarë ato me një marrëveshje që do të sjellë paqe dhe normalizojë marrëdhëniet dypalëshe.

Verën e kaluar, në fakt, ndihmëssekretari i Shtetit i SHBA për Çështjet Evropiane dhe Euroazisë Eëss Mitchell i tha Komitetit të Senatit për Marrëdhëniet me Jashtë, se "Në Ballkan kemi luajtur rol në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së emrit greko-maqedonas dhe angazhimi me Serbinë dhe Kosovën për të çuar përpara dialogun e udhëhequr nga BE. Vetëm pak javë më parë, ndërkohë, Presidenti i SHBA Donald Trump i dërgoi një letër Thaçit dhe homologut të tij serb Aleksandar Vuçiç duke u kërkuar për të përshpejtuar bisedimet e pajtimit dhe paralajmëron se "dështimi për të përfituar nga kjo mundësi do të ishte një pengesë tragjike".

Perëndimi dëshiron të sjellë të gjitha vendet në rajonin e Ballkanit nën ombrellën euroatlantike, dhe veçanërisht në NATO. Kjo ka të bëjë me luftën që bën perëndimi kundër ndikimit Rus, Kinez dhe turk në rajon. Një vështirësi në hartë tregon se një herë "Maqedonia e Veriut" dhe pastaj Kosova do t'i bashkohen NATO-s, vetëm Serbia dhe Bosnje-Hercegovina do të mbeten jashtë aleancës. Pasi humbi betejën për Malin e Zi dhe tani po humbet betejën për "Maqedoninë e Veriut", presidenti rus Vladimir Putin nxitoi në Beograd javën në fillim të vitit 2019 ku mesazhi i tij ishte se Moska ende ka një dorë në të gjitha zhvillimet në Ballkan, me Serbinë si trampolinë e saj. Qëndrimi i tij tregon se beteja për Kosovën do të jetë e vështirë.

Diplomacia perëndimore gjithëherë ka patur ndikim të madh shoqërorë- politik në Ballkanin perëndimor. Ndikimet perëndimore janë realizuar nëpërmjet programeve të ndryshme ; donacioneve, organizatave qeveritare dhe joqeveritare që kanë patur ndikim të drejtëpërdrejtë në ekonomi, politikë, arsim, shëndetësi, mbrojtje, pune të brendëshme etj. Vetë komplikiteti i ndërhyrjes hapi një numër të madh të debateve të juristëve, sociologëve, politikologëve, mediave dhe i njëjti me intenzitet më të vogël, vazhdon edhe sot.

2. Qëllimet e hulumtimit

- Qëllimet e hulumtimit kanë të bëjnë me jetën e përgjithsme shoqërore-ekonomike , në Maqedoni, Kosovë të ndikuar nga diplomacia perëndimore ; luftën kundër varfërisë, lirinë e mediave, projekte të ndryshme trajnimi, projekte të infrastrukturës etj
- Ndikimet perëndimore në zgjidhjen e ngërceve politike
- Shtetbërja e Kosovës dhe Mareveshja e Brukselit
- Zhvillimet në zgjidhjen e ngërceve politike në Maqedoni dhe Marëveshja e Prespës
- Lufta për pushtet mes Partive politike në Kosovë dhe Maqedoni
- Do të analizohen situata aktuale

3. Hipotezat

Dy janë hipotezat kryesore të këtij hulumtimi:

3.1 Hipoteza gjenerale

Supozohet se influenca perëndimore në zhvillimet shoqërore politike në Kosovë dhe Maqedoni ka qenë vendimtare për ecjen përpara drejt integritetit dhe veçmas për konsolidimin, shtetbërjen, zhvillimin ekonomik, njohjen ndërkombëtare të Kosovës

Supozohet se influenca perëndimore është vendimtare në zhvillimet shoqërore politike në zgjidhjen e ngërceve disa vjeçare politike në Maqedoni, Mareveshjen e Prespës dhe rrugëtimin e sajë drejt Unionit Evropian dhe NATO-s.

3.2 Hipoteza e vecantë

1. Diplomacia perëndimore kishte dhe ka rol kyc për Marëveshjen e Perzhinos
2. Diplomacia perëndimore kishte dhe ka rol kyc në ndryshimin e realitetit historik në Kosovë.

4. Metodologjia e hulumtimit

Për të realizuar këtë punim do të bëhet krahasimi dhe me pas analizimi i literatures së autorëve të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë të cilët i kam përmendur më poshtë tek hapsira e ndarë për bibliografi. Rëndësi e vecantë i është kushtuar edhe formulimit të mirë të nocioneve që kanë të bëjnë me ngjarjet kyce në Maqedoni dhe Kosovë dhe marrëdhënjet me Bashkimin Evropian dhe SHBA.

Për konkretizimin e ngjarjeve do të mblidhen të dhëna të dorës së parë dhe të dytë

Në këtë punim do të bëhet analizë e dokumenteve kyçe si që janë Marëveshja e Brukselit dhe Marëveshja e Prespës .

Poshtu do të bëhen intervista me pjesëmarës të drejtpërdrejtë në biseda për çështje vendimtare politike

Si metoda që do të shfrytëzohet gjat këtij hulumtimi janë:

1. Metodën përshkruese- analizë e literaturës
2. Metodën komparative-Krahasimi i angazhimit të diplomacisë dhe kushteve shoqërore politike

3. Intervisten- do te intervistohen aktore politike dhe diplomatë edhe nga Kosova edhe nga Maqedonia
4. Analiza e dokumentacionit –Marëveshja e Brukselit dhe Marëveshja e Prespës
5. Anketimit te 50 respondentve- përceptimi qytetar

5. Rëndësia e punimit

Ky punim do të jepë përgjigje edhe në pyetjet se pse BE-ja dhe Shtet e Bashkuara të Amerikës duhet të jenë me diplomacinë e tyre prezent përherë në Ballkanin perëndimor? A mund të flasim për shoqëri në tranzicion të cilat ende nuk kanë formuar demokraci liberale të mirëfillta? Mund të themi lirshëm se po. Dhe se apo krijohen vazhdimisht në Kosovë dhe Maqedoni ngërce dhe zënka të reja? Ose a thua megjithatë, BE krijon pengesa të reja dhe kushtet për antarsim që vendet nuk mund të përmbushin? Në këtë mënyrë duke e zgjatur kohën e fillimit të bisedimeve apo perudhës së antërarësimit, hulumtimet shkencore tregojnë se te popullata e vendeve të Ballkanit perëndimor rritet sketicizmi

Autorë të ndryshëm janë të mendimit se fuqia e Rusisë buron nga dobësia dhe hezitimin e Perëndimit tani për të marrë këto vende në gjirin e sajë.

Punimi ka rëndësi shkencore dhe shoqërore

6. Strukturimi i punimit

Në menyrë qe ta realizoje në mënyrë më të mirë këtë që e përmenda më lartë, punimin e kam ndarë në pesë kapituj kryesore, (ndërmjet të cilëve ka edhe nëndarje të cilat i kam strukturuar në formë të nënkapitujve) të paraprirë nga hyrja, dhe në fund kam ndarë hapsirë për perfundime dhe rekomandime, të cilat do më shërbejnë si një hapsirë ku do të mund ti shpalos konkluzionet tek të cilat do të arrij nepermjet këtij hulumtimi.

KAPITULLI II

Pak histori: Roli i diplomacisë pas pavarësisë Kosovës

- Analiza teorike e problemit

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, Kosova synonte pavarësi, sipas parimeve kushtetuese juridike, ku secili popull ta kishte shtetin e tij. U veprua pandalshëm që përmes rezistencës autoktone paqësore dhe luftës për çlirim, për te ardhur deri te shtetësia e Kosovës.

Shqiptarët si popull e shprehën vullnetin e tyre për shtet, të barabartë me republikat tjera të cilat; pavarësoheshin, me rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Kosova kishte atributet e shtetësisë nëpër të gjitha etapat historike, që nga parahistoria.¹

Okupimi serb i copëtoi territoret shqiptare, në kohën kur Perandoria Turke po rrënohej, ndërsa Rusia po shënonte përparime në frontet e luftës në lindje.

Pas Betejës së Maricës (1872) Serbia ndihej e privilegjuar ku synimet grabitqare i orientoi në drejtim të tokave shqiptare. Historia tregon se, sa herë që Rusia ngrihej në këmbë, Serbia shndërrohej në “xhandar” të Ballkanit dhe sulej me zjarr e bajoneta, kundër popujve tjerë të pambrojtur për t’i futur në dorë tokat dhe pasuritë e tyre. Kështu ndodhi kundër popullit shqiptar në Ballkan.²

Punimi jep disa aspekte të fundshekullit të kaluar, të veprimeve politike, juridike, paqësore dhe luftarake për liri dhe pavarësi të Kosovës. Entiteti shqiptar në Kosovë, që nga koha e Mbretërisë Bato të Dardanisë, gjithmonë kishte tipare dalluese, demografike, organizative, gjeografike e politike. Përfaqësohej me territor dhe popullsi kompakte, gjithmonë me shumicë shqiptare, Serbia përgjatë okupimit veproi me të gjitha format e saj, gjenocidale për shkatërrimin e etnisë shqiptare.

Në vitet e ‘89-ta me masa të jashtëzakonshme, Serbia suspendojë Autonominë Politike dhe territoriale të Kosovës dhe ndryshoi dhunshëm Kushtetutën e ‘74 –ës. Në fundi të viteve të ‘90-ta, embrionet e para të shtet-ndërtimit të Kosovës fillojnë me krijimin e institucioneve paralele të RK-ës, krahas braktisjes së sistemit monist dhe shuarjes së PKJ.

Fillimisht u formua subjekti politikë “Lidhja Demokratike e Kosovës”, e më vonë edhe disa subjektet të tjera. Me rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë, në rrethana të jashtëzakonshme nga ana e Kuvendit të Kosovës u nxor “Deklarata Kushtetuese” dhe u organizuan “Zgjedhjet e Para Presidenciale”, ku projektohej mëvetësia shtetërore me pretekstin e realizimit të “Shtetit të Pavarur”. Ky akt politik i Kuvendit të Kosovës, solli lëvizjet popullore të papritura nga Minatorët e Trepçës dhe të studentëve të UP.³

Deklarata e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mbi çështjet kushtetuese në qershor ‘90, si rrjedhojë solli tri dokumente të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës:

- 1) Deklaratën e Kushtetuese të 2 korrikut,
- 2) Kushtetutën e Kaçanikut, më 7 shtator dhe
- 3) Rezolutën për Pavarësi dhe Sovranitet të Kosovës.

¹ Rexhepi, Fehmi dhe Frashër Demaj. *Historia 5*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2013.

² Bajraktari, Jusuf, Fehmi Rexhepi dhe Frashër Demaj. *Historia 10*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2011.

³ Dërguti, Menduh, Ferit Duka, Ledia Dushku dhe Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime Shkollore Albane, 2013.

Në Referendumin gjithë popullorë, te shtatorit të '91 për "Shtet Sovran dhe te Pavarur", sipas burimeve statistikore kishin dal 87.01% e popullsisë.

Një vit pas organizimit të referendumit në Kosovë në maj të '92-ës, mbahen zgjedhjet e para presidenciale, me pjesëmarrje masive të popullsisë shqiptare, e cila për herë të parë pati mundësinë e "deklarimit të lirë" në rrethana okupimi nga Serbia. Zgjedhjet presidenciale u organizuan në bazë të Ligjit mbi Zgjedhjet në Kosovë. Ky ligj kishte kombinimin e parimeve të shumicës me parimin proporcional.

Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës u bë në rrethana okupimi, ndërsa cikli i dytë i zgjedhjeve parlamentare u zhvillua në kushtet e okupimit, në kohën e luftës së armatosur në mes UÇK-së dhe forcave serbe.⁴

Më 22 mars të '98-ës, u zgjodh Kuvendi dhe Kryetari i Kosovës. Sikurse në rastin e zgjedhjeve të '92-ës, pas mbajtjes së këtyre zgjedhjeve nuk pasojë formimi i organeve dhe funksionimi i tyre sipas Kushtetutës së Kosovës të viteve të '90-ta. Kosova po ballafaqohej me sfidën e mbijetesës së politikës instaluese nga Serbia. Organizimi paralel më tepër ishte një tentativë për ndërtim të strukturave shtetërore, sesa ishte një funksionim i mirëfilltë i pushtetit.

Marrëveshja e Arsimit në mes palës kosovare dhe asaj serbe, njihet si akti më i lartë politik i lëvizjes paqësore të LDK-ës, ku për herë të parë mbahet takimi, me ndërmjetësim të komunitetit shqiptaro-italian, në mes palës shqiptare dhe asaj serbe. Ky takim vlerësohet nga përkrahësit e rezistencës paqësore, si takim i cili vuri një pikë të fillimit të shtet-ndërtimit të Kosovës dhe ushqente pak a shumë shpresën e vazhdimit të rezistencës pasive kundër okupimit të egër serb.

Marrëveshja u nënshkrua në shtator të '96-ës, nga Ibrahim Rugova dhe Slobodan Millosheviçi, me qëllim të kthimit pa kushte të nxënësve shqiptarë në objektet shkollore dhe universitare. Marrëveshja erdhi si rezultat i ndërmjetësimit Shën Exhidio-s, ku për realizimin e sajë ishte formuar një komision, i ashtuquajtur 3+3+3. Mirëpo, si çdo marrëveshje tjetër, edhe kjo nuk kishte kurrfarë vlere, mandej nuk pati asnjë rezultat.

Viti i ri shkollor në shtator të '96-ës filloi nën dhunë policore⁵

Pra deri më 10 prill të këtij viti ishte liruar vetëm objekti i Gjimnazit të Podujevës. Në vend të implementimit të marrëveshjes, dhuna policore dhe ushtarake nuk ndalej. Veprimet minuese të marrëveshjes dalin në pah më së miri, nëse shfletohen rreth 25 dokumente sekrete, informata e shënime zyrtare, për pengimin e shkollës shqipe gjatë vitit shkollorë '96-'97 të aksionit të policisë së Lypjanit, të titulluar "SHKOLLA" që ishte udhëhequr nga 21 punëtorë të SPB-së, ku flitet vetëm për një komunë!⁶

Gjenocidi serbë në Reçak i 15 janarit '99, tronditi tërë opinionin botërorë dhe zbuloi realitetin e hidhur të popullsisë shqiptare në Kosovë, se me çfarë po ballafaqohej ajo, më tepër se një shekull nga sundimi kriminal i politikës instaluese serbe.

Masakra e Reçakut dhe luftimet e zhvilluara aty, ishin shenjë alarmi për intervenim ndërkombëtar, me ç'rast Serbia u kualifikua si shkelëse e rëndë dhe e vazhdueshme e marrëveshjeve, edhe "të marrëveshjes së armëpushimit dhe kthimit të ushtrisë serbe nëpër kazerna".

⁴ Treska, Tomi dhe Menduh Dërguti. *Historia 6*. Tiranë: Botime Shkollore Albës, 2013.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

Raportet nga vendi i ngjarjes hoqën të gjitha mëdyshjet, tani Kosova ishte Krizë Ndërkombëtare, qe duhej zgjidhur, mashtrimet dhe prapavija politike e Millosheviçit dolën në sipërfaqe.⁷

Konferenca ndërkombëtare për Kosovën ishte konferenca e parë ndërkombëtare, ku serbet dhe shqiptarët po uleshin përballë njëri tjetrit, e ndikuar nga kushtet e krijuara në teren, pas Masakrës së Reçakut. Thirrja e saj po shpejtohej, ku do të vendosej për paqen e shumë pritur. Shumë shtete ofruan strehë për mbajtjen e konferencës, por Franca u zgjodh si vend adekuat për mbajtjen e saj. Serbisë duheshin shtruar kushte që t'i plotësonte ato. Me 6 shkurt të '99-ës filluan punimet në Konferencën e Rambujësë në krye të delegacionit u vendos përfaqësuesi nga radhët e UÇK-së z.Hashim Thaçi. Në këtë periudhë kohore te bisedimeve, kufomat e masakrës së Reçakut zvarriteshin korridoreve të Spitaleve në Prishtinë dhe endeshin deri në Shtime e ktheheshin prapë në Prishtinë. Në këtë atmosferë krimi e presioni, të ushtruar nga autoritet serbe, më 11 shkurt '99, organizohet varrimi i të masakruarve, me ç'rast shefi i OSBE-së z.Valter deklaroi se: "Ky krim i kryer mbi civilë të pafajshëm është krim kundër njerëzimit".⁸

Delegacioni shqiptar bëri të ditur formimin e QPK-ës; që për opinion e brendshëm, diasporën shqiptare dhe opinionin botërorë ishte veprim kulmor i pjekurisë politike të Kosovës. Ishte ky një hap inkurajues rreth realizimit të aspiratave për liri dhe shtet të pavarur, dukej në horizont lindja e një shteti të ri në truallin evropian, kjo ishte pak a shumë pika pikante e pjekurisë dhe unitet të faktorit politik e ushtarak të popullit të Kosovës.⁹

Konferenca e Rambujësë e nivelit të lartë diplomatik, në sferën ndërkombëtare nxori në sipërfaqe çështjen e Kosovës, për një marrëveshje mbi të ardhmen politike të Kosovës. Mediet botërore Konferencën e Rambujësë e vlerësuan si "Dejtoni i Kosovës", me busull orientuese te kombeve të lira, për një "Badinter të Ri", për njohjen dhe pranimin e një shteti të ri, në relacionet e marrëdhënieve ndërkombëtare.¹⁰

Më 12 mars filloi Konferenca e Parisit dhe vazhdoi punimet deri më 19 mars, me nënshkrimin e Marrëveshjes nga pala shqiptare, pala serbe e refuzojë nënshkrimin dhe vendosjen e paqes, kështu pasuan veprimet e diplomacisë ushtarake të NATO-së, dhe intervenimi mbi Jugosllavinë. Liberal demokracia amerikane e kuptoi qartë se zgjidhja e problemeve, me Serbinë mund të bëhej vetëm me intervenim ushtarak kundër Millosheviçit, i cili e njihte vetëm gjuhën e forcës. U pa qartë obstruksioni i Millosheviçit dhe dështimi i Konferencës së Rambujësë e cila ishte injoruar gjatë gjithë kohës së bisedimeve nga ana e tij. Pati zëra të pakta, satelitore ruse në përfundim kundër ndërhyrjes së NATO-së, si ç'ishte edhe një "Bolton" në SHBA.¹¹

Mirëpo opinionin publik dhe strukturat shtetërore ishin të palëkundura për intervenim të NATO-së. Një luftë e NATO-së për Kosovën ishte një shans i përsosur për të forcuar legjitimitetin e "humanizmit të ri ushtarak" për komandantët e NATO-së dhe Pentagonin, përballë Qendrës së Majtë të spektrit politikë evropianë. 50 vjetori i Aleancës së NATO-s u

⁷ Rexhepi, Fehmi. *Historia 9*. Libri Shkollor, 2013.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

festua me një sukses të pa parë deri atëherë, shtetet anëtare ishin të bashkuara në intervenim dhe ky ishte intervenimi i parë humanitar pa u pyetur KS i OKB-së, mbi bazën e kreut 7 të kartës së OKB-së mbi të Drejtat e Njeriut.

Rezoluta 1244 nuk e ka marrë parasysh krijimin e një realiteti të ri në Kosovë. Mund të thuhet se respektimi i sovranitetit dhe integriteti territorial i RFJ-së, sipas Rezolutës rrjedh nga Parimet e pa negociuara të Rambujesë, por edhe nga Marrëveshja e Rambujesë, së cilës i referohet Rezoluta 1244. Rezoluta garanton respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së, ku kjo dëshmi rrjedh nga dhjetë parimet e pa negociuara të Rambujesë, konkretisht nga parimi i pestë “integriteti territorial i RFJ dhe fqinjëve të saj”.¹²

Disa pika dhe anekse të Rezolutës 1244 nuk e paragjykojnë statusin përfundimtar të Kosovës. Në Rezolutë shtohet vetëm tërheqja e forcave serbe nga Kosova, të cilat sipas Rezolutës do të mund të kthehen për të ushtruar funksionet që parashihen në të. Sipas Marrëveshjes së Rambujesë nuk ishte paraparë të ketë trupa, aq sa ka pasur në qershor të vitit 1999, kur është futur NATO në Kosovë. Në Marrëveshjen e Rambujesë janë paraparë 28.000 trupa të NATO-së, ndërsa në qershor, kemi pas 50.000 trupa. Në Marrëveshjen e Rambujesë nuk është paraparë që Kosova të administrohet nga misioni i OKB-së. Edhe pse nuk ka forca serbe në Kosovë, nuk do të thotë se Marrëveshja e Rambujesë nuk është fare valide. Ajo marrëveshje është me një validitet, sepse 1244 e përdorë si bazë referuese gati në tërësinë e saj. Rezoluta, për dallim nga Rambujeja, jo vetëm që nuk ka ngritje për palën kosovare, por del se ka rënie. Rezoluta 1244 nuk e përcakton mandatin e UNMIK-ut, për të përgatitur popullin dhe territorin e Kosovës për pavarësi, por thuhet në Marrëveshjen e Rambujesë, se e përgatit atë për një autonomi substanciale. Rezoluta i dha fund agresionit dhe gjenocidit serb, i cili synoi spastrimin etnik të Kosovës. Kjo rezolutë shënoi përfundimin e intervenimit të NATO-së, lirinë e Kosovës dhe largimin e forcave policore ushtarake nga territori i Kosovës.

Administrative-IPAK UNMIK, u ngarkua për përgatitjen për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Ky model i administrimit ndërkombëtar, paraqet modelin e parë të OKB-së në përmasa të gjëra. Është specifik për faktin se krahas vendosjes së një vetëqeverisje vendore dhe një procesi demokratik institucional, synon të merret me mënjanimin e çështjeve që kanë shkaktuar krizën. Pra për zgjidhjen e krizës që nga burimi i saj, deri te zgjidhja politike dhe statusore.¹³

Rezoluta 1244 e KS në Aspektin Konstitucional Kushtetues, është plotësisht e papërcaktuar. Ndërsa sa i përket statusit për Kosovën, promovon një status të një vetëqeverisje (autonomisë) substanciale brenda integritetit të RF të Jugosllavisë. Pikërisht ky përcaktim, si vetëqeverisje substanciale në njërën anë, dhe integritet territorial i RFJ, në anën tjetër paraqet absurdin dhe kundërtëhënien më të madhe të

saj. Megjithatë Rezoluta promovon konceptin e vetëqeverisjes për Kosovën, kompetencat substanciale të karakterit shtetëror, rezervohen dhe ushtrohen nga UNMIK-u, i cili paraqet autoritetin përfundimtar në funksionimin e pushtetit në Kosovë në tri trajtat e tij; legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Marrëveshja e Kumanovës në mes NATO-së dhe Serbisë, erdhi si rezultat i një dokumenti të hartuar nga përfaqësuesi i ShBA-s Strobe Talbott, i BE-s Martti Ahtisaari dhe përfaqësuesi i

¹² Baldini, Gianfranco dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009).

¹³ OSCE, ‘Kosovo Assembly Elections 2004 – CRS Results’, Pristina, 3 nëntor 2004.

Rusisë V.Chernomyrdin, sipas këtij dokumenti u kërkua tërheqja e të gjitha forcave politike dhe ushtarake serbe, që refugjatët shqiptarë të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe të vendosej siguria nga trupat e NATO-së. Rezoluta 1244 vendosi administrimin e përkohshëm ndërkombëtar, nën të cilin populli i Kosovës erdhi deri te Shpallja e Pavarësisë Kosovës, më 17 shkurt 2008 Serbia, pas negociatave të Brukselit të organizuara nga BE, duke përdor alibi se ne jemi në negociata me Kosovën, në këtë drejtim po hamendësonte disa shtete rreth njohjes së Pavarësisë së Kosovës, duke e shndërruar veten si “viktimë” e viktimën “si agresor”. Kjo erdhi edhe si pasojë e diletantizmit politik të Delegacionit të Kosovës në këto bisedime, që u lëshua nga bisedat teknike të filluara, në ato politike, edhe pse Kosova tashmë nga TN kishte marrë verdiktin se Pavarësia e Kosovës nuk ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.¹⁴

- **Autorë të ndryshëm për Diplomacinë me Kosovën**

Shkaku themeltar i Luftës Çlirimtare të UÇK-së dhe të kombit shqiptar ishte pushtimi, persekutimi, dhuna dhe terrori shtetëror që po ushtronin prej gati një shekulli Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia (pas LDB). Vetëm gjatë Jugosllavisë Federative Socialiste kishte 12–13 vite që shqiptarët në Jugosllavi e posaçërisht në Kosovën administrative (KSAK) gëzuan ca të drejta të kufizuara dhe kontrolluara ekonomike, kulturore, arsimore, politike dhe kombëtare. “Viti 1974 ishte zeniti i interesave kombëtare shqiptare, së paku në çështjet e teorisë kushtetuese”. Nuk vonoi shumë që edhe këto pak të drejta t’u merren me forcën e shtetit pushtues shqiptarëve.¹⁵ “Të bindur se liria dhe të drejtat nuk fitohen me lutje, dialog e bisedime, shqiptarët (pasi kishin provuar edhe të gjitha shtigjet dhe rrugët paqësore) rrokën armët e lirisë, sepse erdhën në një pikë ku dukej qartë se vetëm forca mund ta conte problemin drejt zgjidhjes përfundimtare”. Ishte një luftë tepër e pabarabartë midis UÇK-së, e cila fitoi përkrahjen e mbarë kombit, dhe Serbisë pushtuese, e cila qëllim të fundit kishte spastrimin e plotë të krahinës së Kosovës nga popullsia shqiptare dhe sllavizimin e saj. Për shqiptarët ishte koha e fundit që të shpëtohej Kosova. Ibrahim Rugova dhe partia e tij kërkonin autonomi, dhe, siç e tregojnë faktet, kanë qenë dhe janë të gatshëm për të hyrë në bisedime me Milosheviçin menjëherë.

Kështu bëhej edhe segmentimi territorial, administrativ, politik dhe institucional i Kosovës dhe dobësimi i saj, duke krijuar disa miniserbi në Kosovë. Rezoluta 1244 nuk e përkufizoi qartë as llojin e pranisë ndërkombëtare, sikur se që nga ajo, nuk u mësua as për qëllimin praktik, as për mandatin, dhe as për kohën e asaj pranie, “fakt ky që Kosovën e futi në një labirint në të cilin dihet vetëm se kur hyhet, e jo edhe se kur dilet prej tij. Në vend se të qartësohej, perspektiva e Kosovës zbehej. Rezoluta 1244 e vështroi Kosovën si një “mozaik nacional”, edhe pse përqindja e popullsisë me shumicë të theksuar shqiptare, nuk korrespondonte me këtë parim, kështu që u sajua “shoqëria multietnike” në emër të së cilës, pakicat, në mënyrë të veçantë ajo serbe, do të duhej të përfitonin më shumë të drejta dhe privilegje se sa u takonin”. Edhe Serbia ishte tepër e interesuar dhe e angazhuar që në Kosovë të mbretëronte kaosi, anarkia dhe konfliktet. Krahas zhvillimit të këtij projekti antishqiptar UNMIK-u, OSBE-ja dhe qindra organizata, shoqata e agjentura që vepronin në

¹⁴ Po aty.

¹⁵ GLPS dhe DPC, „EULEX (i) – Drejt Një Strategjie Përfundimtare: Fuqizimi i shtetit të së drejtës përmes integritetit në BE (Raport Politikash, Nr.05, prill 2014).

Kosovë po bënin një propagandë dhe agjitacion të organizuar dhe sistematik kundër Luftës Çlirimtare të UÇK-së dhe kundër atyre që mbijetuan luftën dhe tash ishin angazhuar në parti politike dhe institucionet e përkohëshme të Kosovës. Qëllimi i tyre ishte ta ringjallnin dhe fuqizonin LDK-në dhe kryetarin e saj, I. Rugovën, me të cilin mund ta shtynin dhe realizonin projektin e tyre autonomist. Ky projekt kundërshtuar synonte ta mbante Kosovën të lidhur pas qerres serbe. Zbatimi dhe konsolidimi i këtij projekti në Kosovë do ta bënte gati të pamundur realizimin e dëshirës historike të Kosovës shqiptare për t'u bashkuar me shtetin shqiptar.¹⁶

Në këto rrethana Administratori, Hans Hakerup, «krijoi një grup ekspertësh vendor e të huaj për përgatitjen dhe hartimin e një rregulloreje (dokumenti politik) për një qeverisje kalimtare të Kosovës. Në këtë grup nuk kishin pranuar të hynin përfaqësuesit e pakicës serbe. Por, kjo nuk do ta pengojë z. Hakerup që të punojë në dy drejtime: legalisht me grupin e miratuar nga ai dhe ilegalisht me ekspertët serbë të Beogradit». Lëshimet që bënte grupi i përbashkët i vendorëve dhe ndërkombëtarëve u nënshtroheshin edhe njëherë lëshimeve të reja që bënte Hakerupi dhe UNMIK-u me grupin illegal të Beogradit. Kjo rregullore e UNMIK-ut, e cila më vonë u quajt sa për t'ua bërë qejfin shqiptarëve, «Korniza kushtetuese e Kosovës», ishte në kundërshtim me dëshirat dhe vullnetin e shumicës absolute të popullit të Kosovës. Fillimisht ajo u kundërshtua edhe nga tre udhëheqësit e partive kryesore: Thaçi, Rugova dhe Haradinaj. Forcat politike në emër të popullit të Kosovës kërkonin që për Kosovën dhe statusin e saj të parashikohej dhe garantohej organizimi dhe mbajtja e referendumit, pastaj që institucionet, të cilat do të dalin nga zgjedhjet e lira të mos jenë të kufizuara në përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, etj «Duke pranuar se ushtrimi i përgjegjësisë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë në asnjë mënyrë nuk ndikon apo zvogëlon pushtetin e plotfuqishëm të PSSP-së për zbatimin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara». Deviza e UNMIK-ut: Askush mbi ligjin, kishte për qëllim të fshihte dhe maskonte të vërtetën e dëmshme dhe të papranueshme për popullin e Kosovës, sepse ata, (UNMIK-u dhe prania tjetër ndërkombëtare), ishin mbi ligjin, ishin vet ligji në Kosovë.¹⁷

Ne gjermanët pritëm 44 vjet pas Luftës së Dytë Botërore për t'u bashkuar. Megjithatë, pritja 44 vjeçare e gjermanëve nuk mund të krahasohet me pritjen gati një shekullore të shqiptarëve (që nga Shpallja e Pavarësisë). Pastaj, gjermanët e ndarë nuk ishin të kërcënuar dhe rrezikuar nga dhuna, spastrimi, gjenocidi dhe holokausti. Rrethanat e pasluftës në Kosovë vërtet ishin komplekse, por vitet 1999-2002 ishin vitet më të mira për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Klasa politike e Kosovës nuk ishte dhe nuk u dëshmtua e përgatitur për ta kapur situatën në duart e saj. Mosmarrëveshjet, përcarjet dhe paqartësitë e klasës politike (nëse mund të quhej «klasë politike») i bënë shumë dëm çështjes së Kosovës dhe ia vazhduan jetën Serbisë, UNMIK-ut (më vonë edhe EULEX-it) në Kosovë.¹⁸

• Kushtet aktuale shoqërore-politike në Kosovë

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s mbylli një periudhë të gjatë të historisë së Kosovës dhe, kur nisi bombardimi më 24 mars, u hap një epokë e re, e cila është një histori tjetër. Është e vështirë të thuhet me saktësi shkencore se si do të zhvilloheshin ngjarjet po të mos ndërhynte

¹⁶ Freedom House, «Kosovo | Nation in Transit, 2015». Qasur në https://freedomhouse.org/sites/default/files/NIT2015_Kosovo.pdf (10 korrik 2016).

¹⁷ Po aty,

¹⁸ GAP, «Madhësia e Administratës Publike në Kosovë», (Prishtinë, korrik 2015).

NATO në Kosovë,¹⁹ por një gjë është e sigurtë: Lufta për çlirimin e Kosovës nuk do të mund të mbahej vetëm brenda kufijve të Kosovës administrative. Flakët e saj do të përhapeshin në rajon e më gjerë. Serbia nuk do të mund të përballej gjatë me kombin shqiptar. Kjo ishte edhe arsyeja themelore e ndërhyrjes së NATO-s.²⁰ Përfundimi i Luftës në Kosovë u formalizua me një Rezolutë (1244) të OKB-së, e cila e vendosi Kosovën nën një mbikëqyrje të përkohëshme civile dhe ushtarake. Administrata civile–UNMIK udhëhiqej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, ndërsa forca ushtarake, KFOR, komandohej nga NATO. Arsyeja njerëzore e donte që Serbia të vendosej nën mbikëqyrje ndërkombëtare, sepse ajo ishte përgjegjëse dhe fajtoreshë për të gjitha luftërat dhe konfliktet e fundit të shek XX, për të gjitha shkatërrimet dhe për gjenocidin ndaj popujve tjerë në Ballkan. Kosova dhe viset tjera shqiptare do të duhej të lireshin të lira dhe të vetëvendosnin për të ardhmen e tyre, bashkimin në një shtet të vetëm shqiptar. Por, raporti i forcave në botë nuk ishte më i favorshëm se kaq për shqiptarët. Pastaj, edhe fuqia reale e kombit shqiptar në Iliri-Ballkan nuk mund të bënte më shumë se kaq në këtë kohë. Ndërhyrja e NATO-s dhe vendosja e Kosovës nën mbikëqyrjen ndërkombëtare krijonte kushte dhe rrethana që çështja e Kosovës dhe çështja shqiptare në përgjithësi të zgjidhej, ndoshta, edhe me rrugë dhe mjete paqësore. Kjo, në fillim, mendohej të zgjidhej brenda një periudhe 3 deri në 5 vjeçare. Më pas UNMIK duhej t’ia linte “çelësat e shtëpisë” institucioneve vendore. Por, në Kosovë duket të jetë “e shkruar në yje” që asgjë të mos shkojë sipas planit. UNMIK-u edhe më tej po funksionon në Kosovë, me letra po administron Kosovën, ndërsa në Veri po stimulon serbët të mos integrohen në institucionet e Prishtinës zyrtare” UNMIK-u nga një mision i nevojshëm për një periudhë tre ose pesë vjeçare u shndërrua në një mision pa fund.

Ky është shqetësim i BE-së dhe i SHBA-së. Duke e njohur këtë shqetësim që ka komuniteti ndërkombëtar për të ardhmen e minoritetit serb në Kosovë, Beogradi e përdor si kartë për të përfituar sa më shumë, për të krijuar një status special për këtë minoritet që minon realisht pavarësinë e Kosovës”.²¹

Në këtë punim është folur mjaft për praninë ndërkombëtare dhe rolin e saj në Kosovë, por është e pamundur të përfshihen dhe shtjellohen të gjitha aspektet dhe i gjithë kompleksiteti i kësaj pranie në një punim si ky. Edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, në Kosovë, sidomos në Veri të Kosovës, vazhdoi prania e UNMIK-ut.²² Ata që besonin se pas shpalljes së Pavarësisë do të kishte një qeverisje të qartë dhe të mirëfilltë shtetërore në Kosovë, llogaridhënie demokratike dhe qartësi të plotë për të ardhmen e Kosovës nisën të zhgënjehen.²³ ZCN dhe Qeveria e Kosovës ishin bartëse edhe të strategjisë për Veriun, ndërsa kjo e para, ZCN, edhe përgjegjëse për krijimin e komunës së Mitrovicës Veriore, në të dy rastet mund të konstatohet se ka pasur dështim në realizim”. Edhe UNMIK-u, pas Pavarësisë, po ngurronte t’i dorëzonte kompetencat e veta te misioni i BE-së për sundimin e ligjit, EULEX. Megjithatë, UNMIK-u ishte i detyruar të bënte rikonfigurimin e tij dhe ripërshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij për të siguruar një prani të përherëshme në Kosovë, sidomos në Veri të Kosovës. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Mun, sikur ankohej në Këshillin e Sigurimit kur raportonte “se me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së

¹⁹ David Jackson, ‘Clientelism: The alternative dimension to Kosovo’s governance’ (Kosovo Local Government Institute, Prishtine, shkurt 2014)

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty,

²² Po aty.

²³ Friedrich Ebert Stiftung, ‘Demarkacioni Kosovë – Mali i Zi (Aspektet Ndërkombëtare, Gjeografike, Politike dhe Historike), Prishtinë, 2015. Qasur në <http://www.fesprishtina.org/eb/media/2015/Studimi%20per%20demarkacionin%20%20Kosove%20Mali%20i%20zi.pdf> (12 qershor 2016).

Kosovës, autoritetet kosovare i kanë marrë UNMIK-ut pushtetin në mënyrë efikase”. Sipas raportit, serbët e Kosovës kanë sfiduar misionin e OKB-së duke forcuar strukturat e tyre paralele në Veri të vendit. Këto zhvillime, sipas Sekretarit të Përgjithshëm, kanë ndikuar në krijimin e një realiteti të ri, në të cilin siç ka thënë Ban Ki-Mun, “UNMIK nuk mund të funksionojë më në mënyrë efektive sikur në të kaluarën”. Ai propozonte që “kompetencat në fushën e policisë dhe të drejtësisë t’i barten misionit të Bashkimit Evropian, EULEX, i cili, siç thuhet, do të veprojë “nën ombrellën e OKB-së”.

Ky reagim i butë, ose më saktë mosreagimi dhe pajtimi në mënyrë të heshtur me administrimin e Veriut nga Serbia dhe strukturat e saj, u jepte zemër serbëve dhe Serbisë që t’i intensifikonin veprimet e tyre kundër rendit, sigurisë dhe tërësisë tokësore të Republikës së Kosovës.²⁴

Megjithë problemet e shumta, paqartësitë dhe autoritetet e misionet e ndryshme, që krijojnë jo pak konfuzitet, Kosova dhe institucionet e saj shënuan përparime të “kënaqshme” sa për ta përmbyllur mbikëqyrjen ndërkombëtare. Grupi Drejtues Ndërkombëtar, si duket i (pa)kënaqur me punën e ZCN dhe të përfaqësuesit të tij, shpalli përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës. Pas vlerësimit të tij më datë 2 korrik 2012 se “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PGJS) është zbatuar në mënyrë substanciale dhe duke vënë re se në përputhshmëri me zotimet e tyre, institucionet e Kosovës tani i kanë miratuar pakot e ndryshimeve të Kushtetutës dhe të legjislacionit primar, duke i përfshirë në mënyrë të kënaqshme elementet e mbetura të PGJS-së brenda kornizës kushtetuese dhe juridike të Kosovës, Grupi Drejtues Ndërkombëtar shpall sot përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës dhe përfundimin e mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, thuhej në deklaratën e grupit”. Kjo ishte një e arritur, në planin politik, brenda dhe jashtë vendit. Por, institucionet vendore dhe klasa politike e Prishtinës akoma nuk ishin të formuara dhe konsoliduara mjaftueshëm për ta shfrytëzuar më me mençuri dhe më me vendosmëri situatën e krijuar dhe përkrahjen e miqve të popullit shqiptar. Institucionet vendore do të duhej të këmbëngulnin që përfundimisht të sigurohej dhe bëhej zbatimi unik i ligjeve në gjithë Kosovën. Asaj, për t’u bërë shtet i së drejtës i duhej fuqia e ligjit dhe zbatimi i tij, qoftë edhe me forcë. Ndryshe përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare do të mbetej edhe një moment i rëndësishëm i pa shfrytëzuar. Pas Veriut dhe strukturave të organizuara shtetërore të Serbisë në Kosovë, plaga më e madhe e këtij vendi mbeti sistemi i drejtësisë, i cili ishte ngritur dhe po kontrollohej nga UNMIK-u, ndërsa pas shpalljes së Pavarësisë nga EULEX-i.²⁵

Kosova dhe shqiptarët nuk mundën dhe nuk ditën t’i shfrytëzonin rrethanat e krijuara menjëherë pas Luftës së UÇK-së për ta bërë pavarësinë dhe shtetin e Kosovës fakt të kryer. “Shpërthimi i disa rivaliteteve të vogla politike, në mesin e disa prej liderëve fitimtarë të UÇK-së, dështimi i plotë i lidershit të Ibrahim Rugovës, si dhe fokusi i disa prej drejtuesve të LPK-së, si Ahmeti dhe Veliu, për sa u takon veprimeve të ardhshme ushtarake në Maqedoni, e dobësuan në mënyrë fatale impulsin drejt një Kosove të pavarur. Hashim Thaçi nuk kishte asnjë mënyrë për ta ruajtur Qeverinë e Përkohshme nga forcat që dëshironin shkatërrimin e saj”.²⁶

²⁴ Ethnic Relations in Kosovo?, *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*; Vol 13, No 4, 2014, 85-110.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

- **Privatizimi, AKM-AKP-ja dhe prona në Kosovë**

Kështu kaluan shumë vite të humbura nga vendosja e këtyre misionëve ushtarake e civile ndërkombëtare në Kosovë. Kosova vazhonte ta kishte të kërcënuar tërësinë tokësore (një të katërtën e territorit të saj e kontrollonte Serbia), por edhe varfëria vazhonte të rritej, si pasojë e shkatërrimit sistematik të ekonomisë së saj të dobët nëpërmjet “privatizimit”. Pra, si pasojë e kësaj del se prona “shoqërore”, që qeverisej dhe shfrytëzohej nga komunat e atëherëshme, nga organizatat e punës së bashkuar, nga bashkësitë vetëqeverisëse të interesit, etj., pra nga shteti, pas lufte u konsiderua si pronë pa zot! Për qeverisjen (administrimin) dhe privatizimin e saj, UNMIK-u themeloi ²⁷AKM-në (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) famëkeqe, sot AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit).²⁸ Në fakt AKM-ja, e përkrahur nga UNMIK-u dhe nga segmente, qarqe e grupe të ndryshme formale e joformale (edhe vendore), e plaçkiti, e trafikoi dhe e kontrabandoi pasurinë e Kosovës, ²⁹që e quanin “shoqërore” dhe e trajtonin më keq se një pasuri të huajën, e cila mbase për UNIMK-un edhe ishte e huaj, por të huaj e konsideronin edhe grupe të caktuara interesi me karakter dhe nuanca të theksuara mafioze e kriminale. Këto grupe bashkëpunonin dhe vazhdojnë të bashkëpunojnë ngushtë me segmente të caktuara të shtetit serb dhe me grupe e rrjete mafioze e kriminale të Serbisë. Në mungesë të dokumentacionit kadastral, që ishte grabitur nga Serbia, prona “shoqërore” para se të “privatizohej” nga AKM-AKP-ja,³⁰ “privatizohej” nga këto grupe të organizuara mafioze dhe kriminale me “dokumente” që prodhoheshin nga to nëpër bodrume të ndryshme të Kosovës dhe Serbisë. Por këto “dokumente” do të mbeteshin “letra pa vlerë” sikur në këtë “biznes” të mos përfshiheshin gjykatat, qeveritë komunale dhe segmente të caktuara edhe të Qeverisë dhe institucioneve tjera qendrore (si AKM-AKP-ja).³¹ Dokumente të falsifikuara për toka dhe pasuri të tjera vërtetoheshin dhe vazhdojnë të vërtetohen si autentike (origjinale) nga gjykatat e Kosovës (UNMIK-ut, tash edhe të EULEX-it),³² pa asnjë problem! Mjafton të kesh para, mbështetje politike ose rrjetë, bandë të organizuar kriminale! Të gjitha këto transaksione kriminale të pronës në fund i “vulosin” komunat, duke i regjistruar në kadastër si prona të iksit apo ypsilanit! Për këto transaksione mafioze dhe kriminale pajtohej dhe vazhdon të pajtohet edhe AKM-AKP-ja! Mos e bënë zot që Komuna të marrë ndonjë pronë “shoqërore” për nevojat e saj, që edhe është pronë e saj, për interesa publike a qytetare! Do të ngrihet në këmbë gjithë rrjeti kriminal i Komunës së caktuar, gjykata, AKM-AKP-ja, UNMIK-EULEX-i e kush jo tjetër! Prandaj, do të duhej që përfaqësuesit e Kosovës të këmbëngulnin dhe ta detyronin Beogradin ta kthente dokumentacionin e grabitur kadastral menjëherë pas Lufte. Kjo çështje e madhe për normalitetin në Kosovë dhe në çdo shoqëri do të duhej të shtrohej në bisedime me Serbinë para çështjes së “decentralizimit” të Kosovës. Por, qarqe të caktuara në botë dhe në vend nuk ishin të interesuara për zgjidhje të qëndrueshme dhe për vendosjen e një rendi demokratik dhe të drejtë në Kosovë.³³ Toka nuk u “privatizua” dhe as u administrua nga AKM-AKP-ja, por nga krimi i organizuar dhe rrjeti mafioz me anë të dokumenteve të falsifikuara, të cilat bëheshin “origjinale” nga gjykata dhe

²⁷ Besnik Boletini dhe Besa Kalaja, „Partia e Punës: Fizionomia e patronazhit politik në Kosovë“, (Preport, Nr. 10, Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, dhjetor 2014).

²⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, „Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2015 në Kosovë“ (Prishtinë, qershor 2016).

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty,

³² Po aty.

³³ Cana, Zekeria, *Apeli 215 intelektualëve shqiptarë*, (Rilindja, Prishtinë, 2001).

nga kadastrai i komunës së caktuar! Me mijëra punëtorë kanë mbetur pa punë si pasojë e privatizimit, të cilët jetojnë në kushte dhe varfëri të skajshme. Në këtë fushë ka pasur reagime të shumta dhe kritika të arsyeshme në adresë të privatizimit (AKM-së), sepse AKM-ja ka bërë privatizimin e fabrikave dhe sipërmarjeve të ndryshme pa një analizë dhe kriter të duhur, pa një kujdes për fatin e mijëra punëtorëve që tani si pasojë e privatizimit dhe mbylljes së fabrikave kanë mbetur pa punë, në kushte ekstreme të jetës, sidomos pensionistët të cilët nuk e kanë të zgjidhur statusin e pensionistit. Askush nuk u dënua dhe nuk po dënohet për këtë trafikim kriminal të tokës dhe të pasurive të Kosovës, askush nuk u dënua dhe nuk po dënohet për korrupsion dhe shpërdorime të tjera. Përkundrazi. Krimi i organizuar dhe korrupsioni po ushqehen dhe inkurajohen nga “drejtësia” e organizuar, e ndërtuar, e mbikëqyrur, e kontrolluar dhe e zbatuar nga UNMIK-EULEX-i. Korrupsioni dhe krimi i organizuar vazhdonin të fuqizoheshin dhe ta bënin “ligjin” e ta ndanin “drejtësinë”.³⁴

Kosova, e cila ishte me një mision civil dhe me një përfaqësues special, pas shpalljes së Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, u bë me dy misione civile ndërkombëtare dhe me dy përfaqësues special! Edhe pse Kosova ishte shpallur “shtet i pavarur dhe sovran”, UNMIK-u dhe përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, vazhdojnë të qëndrojnë në Kosovë për t’i “mbrojtur” interesat e pakicës serbe (të Serbisë) në Kosovë! Pas mendimit të kërkuar nga GJND-ja³⁵ për Pavarësinë e Kosovës, e cila është instrumenti kryesor për të ndarë drejtësi në emër të OKB-së, që kishte vendosur se shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte në përputhshmëri dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe se Pavarësia e Kosovës nuk ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244, UNMIK do të duhej t’i bënte gati valixhet e tij dhe të largohej nga Kosova, duke e deklaruar misionin e OKB-së në Kosovë të përfunduar. Largimi i tërësishëm i OKB-së-UNMIK-ut nga Kosova do të lehtësonte shumë edhe marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Domethënës ishte edhe fakti i zhvendosjes së Kosovës nga OKB-ja në BE, pasi Asambleja e Përgjithshme e OKB, më 9 shtator 2010, miratoi një rezolutë, e cila bënte thirrje për bisedime të drejtpërdrejta midis Kosovës dhe Serbisë. Këto bisedime nuk do të ndërmjetësoheshin nga UNMIK-u, siç dëshironte dhe këmbëngulte Serbia me miqtë e saj, por nga Bashkimi Evropian. Pengesë e Kosovës në rrugën e saj të shtet-ndërtimit u bënë edhe disa vende të BE-së që nuk e njohën pavarësinë e Kosovës.³⁶

- **Njohja e shtetit të Kosovës dhe vendet e BE-së që nuk e njohën atë**

Njëra prej krahinave më të mëdha të Shqipërisë – Kosova – e çliruar me luftë të armatosur të UÇK-së, NATO-s dhe kombit shqiptar, në qershor të vitit 1999, Shpalli Pavarësinë e saj më 17 Shkurt 2008. Rrethanat në rajon, Evropë dhe botë, si dhe raporti i forcave nuk lejuan që Kosova shqiptare t’i bashkohej trungut-shtetit të saj, Republikës së Shqipërisë. Pavarësia ishte kompromisi më i madh dhe më i dhimbshëm që po bënin shqiptarët. Sidoqoftë, shteti i dytë shqiptar në Iliri-Ballkan, ishte një fitore e kombit shqiptar.³⁷ Njëri prej akademikëve tanë të njohur, Esat Stavileci, me të drejtë shkruante se “nëse shekulli i kaluar ishte shekull i padrejtësive ndaj shqiptarëve, ky shekull do të duhej të ishte shekull i vetë shqiptarëve,

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

³⁶ Po aty.

³⁷ Cross, William P. dhe Richard S. Katz (ed.), *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press, 2013).

sepse pasqyra e shqiptarëve sot flet për: Shqipërinë, kombëtarisht të cunguar, Kosovën shtet, me sovranitet të kufizuar, Shqiptarët në Maqedoni, nga një numër lirishë dhe të drejtash kolektive kombëtare të privuar, Shqiptarët në Kosovën Lindore, nga të huajt të sunduar, Shqiptarët në Mal të Zi, në pikëpamje etnike të pakonsoliduar, Çamëria, pothuajse e harruar, Shqiptarët në Turqi, gati të asimiluar, Mërgata shqiptare, partiakisht e shpartalluar, Diplomacia shqiptare e paunifikuar, Politika kombëtare e pa formësuar”. Meqë, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës u bë në marrëveshje dhe bashkërendim me miqtë tanë, sidomos me SHBA-në, nuk munguan edhe njohjet për shtetin e Kosovës.³⁸ Të nesërmen, më 18 shkurt 2008, erdhi edhe njohja e parë për Republikën e Kosovës nga Afganistani. Ndërsa qeveritari i parë që vizitoi shtetin e Kosovës, më 8 mars 2008, ishte Ministri i Jashtëm i Suedisë, Karl Bilt. Por, mbështetja kryesore edhe për njohjet ishte SHBA-ja dhe Kryetari i saj, Bush. “Ka shumë rëndësi që t’u ndihmohet kombeve që të dalin nga situatat e vështira dhe të bëhen demokratike. Për këtë shkak jam i kujdesshëm kur bëhet fjalë për afate kohore, mirëpo jam i bindur se Kosova do ta arrijë këtë gjë”, deklaronte Kryetari i SHBA-së, Bush. Për palën shqiptare, mendimet dhe komentet për themelin e çështjes i paraqiti profesori i shquar gjerman Jochen Froëin, Drejtor Emeritus i Institutit Max – Planck për të Drejtën Kushtetuese dhe Ndërkombëtare në Heidelberg të Gjermanisë, si dhe prof. Terry Gill i Universitetit të Amsterdemit. Është interesant të theksohet se në seancën gojore morën pjesë të gjithë gjyqtarët e GJND-së (15 gjyqtarë), por më pas, më 28 maj 2010, gjyqtari Shi dha dorëheqjen nga gjykata. Për këtë arsye, në vendimmarrjen përfundimtare të gjykatës ishin 14 gjyqtarë. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e dha mendimin e saj më 22 korrik 2010, duke deklaruar me 10 vota për dhe 4 kundër se “Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008, nuk cenon normat e së drejtës ndërkombëtare” dhe as Rezolutën 1244. Në dokumentin për Kosovën, të paraqitur nga euro-deputetja,³⁹ Urlike Lunaçek, para komitetit për Politikë të Jashtme të BE-së, thuhej se Bashkimi Evropian mund të lidhë Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Kosovën, edhe pse pesë vende të BE-së nuk e kanë njohur Pavarësinë e saj. Euro-deputetja deklaroi se “nuk mund të pranohet ndarja e Kosovës”.⁴⁰ Projekt-rezoluta po ashtu u bën thirrje pesë anëtareve evropiane që të pranojnë shtetin e ri. Ndërkaq, dokumenti për Serbinë kërkon që këtij shteti t’i jepet sa më parë data e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me kusht që Beogradi të plotësojë kushtet themelore dhe të vazhdojë procesin e reformave. Njëri nga kushtet e BE-së për Serbinë, është edhe Kosova. Autoritetet evropiane u kanë vënë kusht atyre serbe normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, nëse duan të avancojnë në procesin e integritimit.

• Zbatimi i Paketës së Ahtisarit dhe Veriu i Kosovës

Menjeherë pas shpalljes së Pavarësisë institucionet e Republikës intensifikuan angazhimin dhe punën për përgatitjen dhe miratimin e Kushtetutës dhe të ligjeve që parashikoheshin (ishin të detyrueshme) me Paketën ose Planin e Ahtisarit. Në nenin 1.11 të këtij Plani thuhet se Komuniteti ndërkombëtar do të kontrollojë, mbikëqyrë dhe do të ketë tërë pushtetin e

³⁸ Po aty.

³⁹ Doyle, Michael W., *Ways of War and Peace: Realism, Liberalism and Socialism* (New York: W. W. Norton, 1997).

⁴⁰ Po aty.

domosdoshëm për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të kësaj zgjidhjeje, sipas përkufizimeve të ofruara në Anekset IX, X, XI.⁴¹ Kosova gjithashtu do të ftojë bashkësinë ndërkombëtare që t'i ndihmojë Kosovës në përmbushjen e suksesshme të obligimeve të saja. Me Planin e Ahtisarit ishte paraparë dhe parathënë çdo gjë dhe me saktësi. Në pajtim të plotë me këtë Plan ose propozim gjithëpërfshirës do të hartohej edhe Kushtetuta e Kosovës, e cila është produkt i këtij Plani, që kishte paraparë edhe detyrat që duhet të përmbushte Kuvendi i Kosovës, i cili duhet t'i miratonte zyrtarisht ligjet e nevojshme për zbatimin e kushteve të kësaj zgjidhjeje gjatë periudhës së tranzicionit prej 120 ditëve, të cilat duhet të konsiderohen si të miratuara nga Kuvendi dhe do të vihen në zbatim menjëherë ditën e parë pas përfundimit të periudhës së tranzicionit.⁴² Legjislacioni i tillë do të përfshijë ligjet vijuese ose ndryshimet në to, por nuk do të kufizohet vetëm në ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale, ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, ligjin mbi kufijtë komunalë dhe ligjin mbi themelimin e zonave të mbrojtura.⁴³ Me këtë Plan ishin paraparë edhe ligje të tjera për mbrojtjen e pakicave, sidomos të asaj serbe, të trashëgimisë kulturore dhe të kishës ortodokse, etj., e që Kuvendi i Kosovës detyrohej t'i miratonte. Plani i Ahtisarit ishte përgjithësisht një dokument i ekuilibruar për shumicën e vendeve dhe qeverive evropiane e botërore me ndikim në botë, ishte një dokument që i "kënaqte" të dyja palët dhe që të dyja palët mund ta shpjegonin në interesin e tyre dhe sipas nevojave të tyre të brendshme. Ajo që nuk u pranua dhe nuk po pranohet nga Serbia dhe mikja e saj e madhe, Rusia, ishte dhe mbeti propozimi dhe përfundimi i Ahtisarit se "Pavarësia ishte opcioni i vetëm për një Kosovë politikisht stabile dhe ekonomikisht të qëndrueshme". Është e rëndësishme të nënvizohet se edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Kimun, në letrën e tij të 26 marsit 2007, që ia dërgonte Këshillit të Sigurimit në mënyrë të hapur dhe qartë përkrahte propozimin e Ahtisarit për Pavarësinë e Kosovës⁴⁴ kur thoshte se "unë plotësisht përkrah rekomandimet e të Dërguarit tim të Posaçëm në raportin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës"⁴⁵ si dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen mbi Statusin e Kosovës". Megjithatë, presioni dhe angazhimi diplomatik i Serbisë, i mbështetur nga Rusia dhe miqtë e saj, pamundësoi zbatimin e plotë të Planit të Ahtisarit. Veriu i Kosovës mbeti edhe më tej nën kontrollin e Serbisë dhe të institucioneve të saj paralele ose, më saktë, ato ishin të vetmet institucione në atë pjesë të Kosovës.⁴⁶

Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera republikane, të ndodhura nën presionin e fuqishëm të pranisë ndërkombëtare, pranuan që zbatimin e Planit të Ahtisarit ta fillonin nga komuna e Vitisë në vend se ta fillonin nga Veriu. Procesi i komunave të reja "serbe" nisi në Viti me krijimin e komunës së Klllokotit në zemër të komunës së Vitisë! Komuna e Vitisë, partitë politike dhe qytetarët e saj bënë qëndresë të fuqishme për ta penguar dhe pamundësuar krijimin e komunës së Klllokotit. Në Viti, sikur në gjithë Anamoravën, u organizuan protesta, iu dërguan letra dhe ankesa institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Në Viti u organizua edhe një peticion, të cilin e nënshkruan mbi 11.000 qytetarë. Një kopje e këtij peticioni iu dorëzua në dorë vetë Kryetarit të Kosovës, Fatmir Sejdiut në sallën e Këshillit komunal nga këshilltari komunal dhe Kryetari i Degës së PDK-së, Daut Xhemajli. Qytetarët e Anamoravës me të drejtë ishin të indinjuar me Planin e Ahtisarit, i cili parashikonte krijimin e katër

⁴¹ D4D, "Busolla ideologjike në Kosovë: Hartë e orientimit të partive politike", Seria: Partitë Politike, Nr 8, Prishtinë, 2014.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo.

komunave serbe në Anamoravë! Vitia me të drejtë kërkonte që krijimi i komunave të reja të fillonte në Veri, të fillonte atje ku ishte problemi më i madh i Kosovës e jo në Viti. Procesi dhe plani për ricopëtimin e brendshëm të Kosovës nuk ishte punë e lehtë. Nuk ishte e lehtë veç hedhja e idesë për “decentralizim” (copëtim) në “tregun” shqiptar. Ideatorët e planit për ndarjen e Kosovës, midis shqiptarëve që përbëjnë mbi 90 % të popullsisë dhe pakicës serbe që përbën rreth 5% të popullsisë, e kishin të vështirë dhe gati nuk e besonin se mund të kalonte një Plan i tillë, në thelb shovinist. “Pala shqiptare, porosiste akademiku Esat Stavileci, duhet të jetë këmbëngulëse dhe të kundërshtojë të gjitha orekset e Serbisë për procesin e decentralizimit. Qeveria serbe nuk është shumë e interesuar për popullatën serbe në Kosovë, sa është për territoret serbe, prandaj ky është defekti më i madh që mund t’i bëhet negociimit dhe procesit negociator”. Në Kosovë me Planin e Ahtisarit u krijuan edhe shumë zona të mbrojtura dhe ex-territore të kishave dhe monumenteve “serbe”. Me këtë Plan Serbia bëhej ortake në tokën e Kosovës dhe në të gjitha çështjet që lidhen me të. Komunitet dhe rajonet serbe që do të krijoheshin do të kishin lidhje speciale me Serbinë!! Ose, thënë më saktë, Serbia do të ishte e pranishme në tokën e Kosovës nëpërmjet komunave serbe, kishave ortodokse dhe zonave të mbrojtura!! Ajo do të “kontrollonte” mbi 30 % të territorit të Kosovës!⁴⁷

- **Katër komuna serbe në Anamoravë**

Të rrallë ishin shqiptarët që mund ta miratonin dhe pranonin realizimin e kësaj ideje dhe të këtyre planeve me formë dhe me përmbajtje kundërshtqiptare, kundërnjerëzore, kundërhistorike dhe tepër të rrezikshme për të ardhmen e qetë dhe të sigurtë të Kosovës dhe rajonit. Madje, qarqet që kishin marrë këtë nismë nuk besonin se mund të gjenin të tillë shqiptarë në Kosovë. Kjo ishte edhe arsyeja pse kjo ide dhe ky Projekt mori gati një dekatë deri sa u “realizua”. U dasht të shpenzoheshin miliona për të bërë fushatë, të mbështjellur me ambalazhin e “decentralizimit”, që t’i mbushej mendja “miletit”.⁴⁸ “Edhe më herët kam tërhequr vërejtjen, shkruante akademiku, Esat Stavileci, se shtizat do “të thyhen” në çështjen e decentralizimit, sepse ai po vendoset mbi parimin territorial dhe etnik; në çështjen e zonave të mbrojtura, sepse ato do të gëzojnë të drejta pronësore që mund të kufizohen në mënyra të veçanta dhe në çështjen e kompetencave shtesë të komunave serbe ose me shumicë serbe, sepse ato do të krijojnë një asimetri e cila vështirë se do të mund të rregullohej me një sistem unik ligjor”. Fillimisht bajrakun e mori, më i merituari dhe më i besuari, Lutfi Haziri, politikan-ministër nga Anamorava. Nga dorë e tij bajraku kaloi në shumë duar, në “Grupin negociator”, dhe kështu u formua “GRUSHTI” që goditi rëndë homogjenitetin kombëtar, kulturor, tokësor dhe historik të krahinës shqiptare, Kosovës. Sipas Akademik Hivzi Islamit, “decentralizimi, i cili nisi si reformim i pushtetit lokal dhe si ofrim i shërbimeve afër qytetarit, përfundoi me një ndarje të Kosovës sui generis”. Për përkushtimin dhe dëgjueshmërinë e tyre, anëtarët e këtij “Grupi” nuk mbetën pa gjë! Kush më shumë e kush më pak, secili sipas meritave, u shpërblyen me poste dhe forma të tjera të shpërblimeve! Vetëm Kosova dhe populli i saj pati dhe do të ketë pasoja afatgjate nga thika e pamëshirshme e këtij “Grupi” dhe e Ahtisarit! Në fakt plani ishte propozuar nga Serbia, por ajo nuk e pranoi deri më sot këtë Plan, sepse, është bindur se mund të fitohet diçka më shumë se ky Plan. Thika e këtij plani çau dhe përlau më së rëndi qytetin e Mitrovicës me Veri dhe Anamoravën.

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Raporti i Progresit 2013 për Kosovën⁴. Bruksel, 16. 10.2013. SËD (20130 416).

Vetëm në këtë rajon (Anamoravë) u krijuan katër komuna serbe, të cilat përbëjnë një rajon më vete përgjatë kufirit shtetëror me Serbinë. Vetë kufiri shtetëror ndodhet mospërmas tokës shqiptare. Me këto komuna serbe ose me këtë rajon (rripë) tentohet të bëhet edhe ndarja përfundimtare e kësaj hapësire unike shqiptare, këndeje dhe andej kufirit!⁴⁹

⁵⁰Me gjithë premtimet e institucioneve vendore dhe të pranisë ndërkombëtare, ⁵¹Plani i Ahtisarit nuk u zbatua në Veri të Kosovës. Edhe ZCN dhe përfaqësuesi ndërkombëtar civil, Piter Feit, ikën pa e zbatuar, siç ishin mandatuar, Planin e Ahtisarit në Veri të Kosovës. Serbia, e mbështetur nga miqtë e saj dhe e favorizuar nga politikat e buta të Kosovës, ia doli që ta ulte Kosovën në bisedime të reja-shtesë për Veriun dhe Kosovën!⁵²

• Veriu i Kosovës dhe bisedimet me Serbinë

Pozita strategjike dhe sidomos ajo gjeografike në mes dy lumenjve të rëndësishëm, Ibrit e Sitnicës, ka bërë që territori i Mitrovicës të popullzohet qysh në parahistori. Albaniku (Monte Argentarum), i pasur me argjend e plumb prej kohës antike deri në Mesjetë, pastaj Trepça si vendburim i madh i plumbit, klima e përshtatshme, kushtet e mira për t'u marrë me bujqësi, blegtori, tregti etj., kanë ndikuar në koncentrimin e popullsisë në këtë mjedis. Motive ekonomike për themelimin e vendbanimeve dhe për përqendrimin e popullsisë në këtë trevë, para së gjithash, kanë qenë blegtorja, bujqësia, gjuetia e më pas edhe xehetaria në fillim e zhvilluar në masë modeste për t'u bërë më vonë një ndër shkaqet kryesore të depërtimit romak dhe pushtuesve sllavë, osmanë etj, në këtë anë. Kjo trevë, sikurse pjesët tjera të Siujdhesës Ilirike, në lashtësi ka qenë e banuar me banorë ilirë të fisit dardan. Në gjysmën e dytë të shek. XIX Mitrovica u bë një qendër e rëndësishme ushtarake, ekonomike, tregtare e kulturore. Në afërsi të Mitrovicës, në fshatin Boletin, prodhoheshin gurë mulliri. Si stacion i fundit hekurudhor, Mitrovica u bë stacion importues dhe eksportues. Në vitin 1931 u vazhdua hekurudha deri në Kralevë për ta lidhur këtë qytet me Serbinë dhe për të mundësuar dhe lehtësuar transportimin e pasurive të nëntokës shqiptare brenda Serbisë. Përkaj rrugëve të shtruara me kalldrëm u hapën dyqane të ndryshme zejtare e tregtare.⁵³

Por, ajo që ne na intereson shumë pas këtij vështrimi historik, është ndarja e Mitrovicës pas Luftës së UÇK-së dhe gjendja në atë pjesë të Kosovës (në Veri). Për arsye territoriale, politike, shtetërore dhe ekonomike, Serbia u nxitua shumë që në kaosin e ditëve të para të pasluftës, t'i koncentrojë forcat e saj të sigurisë dhe ato paramilitare në pjesën veriore të qytetit, duke bërë ndarje fizike të qytetit në mes urës së Ibrit. Kjo situatë në Mitrovicë dhe Veri u krijua edhe për fajin e NATO-s dhe të shteteve të caktuara (edhe të SHBA-së) që ngurrnin dhe nuk pranuan të vendoseshin në Veri të Kosovës. Këtë zonë e mori përsipër vullnetarisht Franca. Tanku i parë francez u vendos mbi urën që bashkonte qytetin dhe ushtarët francezë nuk lejonin kthimin e shqiptarëve në shtëpitë e tyre në atë pjesë të qytetit dhe të Kosovës. ⁵⁴Ndërkohë, u dha kushttrimi nga Serbia që të gjithë serbët e "rrezikuar" (vrasësit) në Kosovë të vijnë dhe të vendosen në Veri të Kosovës.⁵⁵ "Vendosja e kontingjenteve të KFOR-it francez në veri të Kosovës ipso facto bëri që të ndalej hovi i

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

⁵² Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

dëbimit të forcave ushtarake dhe atyre policore serbe.⁵⁶ Këto të fundit të shpenguara do të tokëzohen në veri, atje ku forcat franceze kishin ndërprerë çfarëdo veprimi. Po në këtë kohë në mesin e aleatëve kryesor të NATO-s ngriti krye një apati e sertë ndaj UÇK-së. Zyrtarë të NATO-s, të molepsur nga propaganda anti-shqiptare e kohës, më shumë i druheshin përhapjes së kryengritjes shqiptare në Maqedoni e Kosovë Lindore, sesa forcave paramilitare serbe të cilat po forcoheshin në veri dhe në enklavat e shpërndara në jug të lumit Ibër. Madje, vetë gjenerali Klark përmend sesi KFOR-i bënte çmos që të parandalonte UÇK-në nga marrja e legjitimitetit politik në terren. Sipas autorit, G. O'Neil, "shqiptarët nuk lejoheshin të kalonin në Mitrovicën veriore ose në veri të vendit si pasojë e ngritjes së një pike kontrolli në lumin Ibër. Si rrjedhim, francezët ndanë Mitrovicën, e cila u bë një qytet i ndarë sikur Mostari në Bosnjë".⁵⁷

Këto barrikada janë edhe sot e kësaj dite (po bëhen më shumë se dy vite) dhe qëndrojnë si monumente të turpër për praninë ndërkombëtare dhe për institucionet e Kosovës. Komandanti i KFOR-it, Uolker Halbauer, ka theksuar se "KFOR-i nuk do ta urdhërojë largimin e dhunshëm të barrikadës në urën mbi lumin Ibër, e cila, sipas tij, është simbol politik dhe paraqet frikën dhe dëshirat e popullit në Veri". Ndryshe nga Halbauer pati deklaruar paraardhësi i tij, Erhard Dreves, i cili e pati quajtur barrikadën mbi Ibër "turp dhe simbol të ndarjes". "Natyrisht, që e ndjej edhe si turp këtë barrikadë. Jo që e pengon lirinë e lëvizjes, por ajo barrikadë e paraqet simbolin e ndarjes së një qyteti, i cili në fakt nuk është i ndarë dhe mund të bashkëjetojë", pati thënë gjenerali Erhard Dreves, gjatë vizitës që i pati bërë Mitrovicës. Gjatë komandës së tij, KFOR-i pati hequr shumicën e barrikadave, të cilat serbët i kishin vendosur në rrugët magjistrale. Për këtë gjendje hiq më pak nuk është e pafajshme edhe limontia e qeverisjes dhe e qeveritarëve të saj në Kosovë, pavarësisht se cili krah udhëhiqte që nga momenti i dëbimit të pushtuesit serb. As KFOR-i, as UNMIK-u dhe as EULEX-i nuk arritën apo nuk dashtën për këto 14 vite të garantonin, sic kishin mandatin, lëvizje të lirë për qytetarët dhe mallrat edhe në Veri. Madje nuk arritën as t'i mbrojnë qytetarët shqiptarë nga presioni, dhuna, vrasjet dhe spastrimi etnik sistematik që impononin strukturat e Serbisë në Veri të Kosovës para syve të forcave ndërkombëtare të sigurisë dhe administrimit. Shumica e shqiptarëve u detyruan të shpërnguleheshin nga tokat dhe shëtpitë e tyre.⁵⁸

Prapa këmbënguljes së pakicës serbe në Veri për t'u mos integruar në institucionet e Republikës së Kosovës qëndron me tërë fuqinë e tij Beogradi. Kët mendim e mbështet edhe simboli i qëndresës kombëtare, Adem Demaçi, i cili thotë se "regjimi çetnik i Beogradit po i organizon ata ashtu që ata të mos integrohen në institucionet e Kosovës, por që edhe në Kosovë, dalëngadalë, të lindë edhe një "Republika Sërpska" bashkë me një Dodik, sikurse që ndodhi në Bosnje e Hercegovinën e nakatosur".⁵⁹

- **Papunësia, varfëria , migrimi i popullsisë**

Kosova është vendi me BPV më të vogël për kokë banori dhe ka një normë të projektuar të rritjes ekonomike prej 4.8% për vitin 2012. Për më shumë ajo ka normën më të lartë të

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Deutsch, Karl, *The Analysis of International Relations* (Prentice Hall College, 1988).

⁵⁸ Memorandumi i Zyrës së BE-së në Kosovë dërguar liderëve politikë në Kosovë, _Memo to Party Leaders on Kosovo's Electoral Reform

⁵⁹ Po aty.

varfërisë- vlerësimet e fundit të varfërisë të vitit 2009 tregojnë se 34% e popullsisë jeton nën pragun e varfërisë absolute ndërsa 12% nën pragun e varfërisë ekstreme .⁶⁰ Kosova* ka popullsinë më të re në Evropë dhe poashtu është vend me përqindjen më të lartë të remitencave në raport me BPV (13% e BPV në vitin 2009) e që është rezultat i numrit të madh të Disaporës dhe lidhjes së fortë të Diasporës me familjet e tyre në Kosovë. Migracioni ka qenë një strategji e rëndësishme e mbijetesës për një pjesë të madhe të popullsisë së Kosovës* dhe ka mundësi që të mbetet e rëndësishme edhe në të ardhmen. Kosova ka normën më të lartë të emigrimit në mesin e vendeve të Evropës Lindore. Emigrimi masiv ka ndodhur sidomos gjatë luftës, dhe përkundër faktit që gjatë periudhës në mes të viteve 1999 and 2010 rreth 200,000 Kosovarë u kthyen në Kosovë* numri i atyre që jetojnë jashtë Kosovës është ende mjaft i lartë. Afër 63% e tyre janë të koncentruar në Gjermani dhe Zvicër. Në vitet e fundit, përqindja e madhe e popullsisë së re dhe kushtet e vështira ekonomike konsiderohen si faktorë që kanë ndikuar që një pjesë e madhe e popullsisë të synoj të migroj: 27% e emigrantëve kanë emigruar në mes viteve 2005 dhe 2009. Përderisa emigrimi dhe migrimi rural urban në Kosovë* ka kontribuar në masë të konsiderueshme në zvogëlimin e varfërisë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin individual dhe atë të Kosovës ka pasur poashtu edhe efekte sociale në popullsinë e mbetur pas, posaqërisht në grupet e marginalizuara si femrat, të moshuarit dhe fëmijët. Emigrimi pritet të jetë karakteristikë në Kosovë së paku në të ardhmen e afërt, andaj sfidë mbetet si të minimizohen efektet negative socio-ekonomike në Kosovë* dhe në të njëjtën kohë të mbështeten migrantët e ardhshëm në përpjekjet e tyre për të fituar dije për gjuhën dhe kulturën e vendit ku do të qëndrojnë si dhe për të fituar aftësi të cilat kërkohen nga tregu i BE-së.⁶¹ Politikat e shtrënguara të imigrimit në BE do të ndikojnë në vazhdimësinë dhe madhësinë e remitencave të dërguara në Kosovë. ⁶²Pasiqë emigrimi mbetet një nga mekanizmat më efektiv për zbutjen e varfërisë në Kosovë*, rënia e migracionit do të ndikoj direkt në rritjen e shkallës së varfërisë, posaqërisht në zonat rurale. Andaj çdo përpjekje që shpie tek rënia drastike e migrimit aktual do të përkeqësoj jetën e popullsisë së Kosovës dhe do të zgjeroj dallimet rurale-urbane që tashmë egzistojnë në Kosovë. ⁶³Autoritetet Kosovare duhet të punojnë në identifikimin e vendeve partnere në fushat e ndryshme me të cilat do të mund të nënshkruheshin marrëveshje për migrim afashkurtër për punësim. Për më shumë, marrëveshjet duhet të monitorohen nga afër me qëllim që të dërgohen sinjale të mira tek vendet e tjera potenciale se migrantët e dërguar i respektojnë kushtet e përcaktuara në marrëveshje.⁶⁴

⁶⁵Në mesim e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (RAE), 14.7% e fëmijëve të moshës 0 deri 6 vjeçare nuk janë të regjistruar. Rrjedhimisht ata janë në situatën më të vështirë nga gjithë të rinjët që kthehen. Sipas një studimi të UNICEF-it tre nga katër fëmijët e kthyer nuk vijnë shkollimin.⁶⁶ RAE kryesisht janë të ekspozuar kushteve të vështira: 20% e familjeve RAE marrin të ardhura mesatare mujore prej 50 Euro në krahasim me

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Duverger, Maurice, *Political Parties: Their Organization and Activity in the Modern State* (London: Methuen, 1954).

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Golosov V., Grigorri, „Party system classification: A methodological inquiry”, *Party Politics* 2011, 17:539.

⁶⁶ Po aty.

mesataren e të ardhurave në Kosovë* prej 262 Euro.⁶⁷ Shumica e agjensioneve për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut pajtohen se qeveritë e vendeve të BE-së dhe Evropës Perëndimore duhet të shtyejnë afatin e kthimit të detyruar deri në përmirësimin e kushteve të pranimit. Secili kthim duhet të bëhet duke respektuar udhëzimet e UNHCR-it. Qeveria e Kosovës duhet të implementoj me sukses Strategjinë për të Kthyerit dhe Re-integrimin dhe duhet të alokoj fonde të nevojshme për të siguruar implementimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe duhet të themeloj bordin koordinues ndër-ministror për të përcjellur dhe monitoruar implementimin e Strategjisë. Për më tepër, kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda Kosovës⁶⁸ dhe refugjatëve paraqet një presion dhe sfidë shtesë për institucionet Kosovare. Në përgjithësi personat e zhvendosur brenda Kosovës dhe refugjatët që duan të kthehen ende hasin në disa rreze, posaqërisht mungesa e dokumenteve identifikuese personale dhe dokumenteve pronësore, kushtet e vështira ekonomike dhe mungesa e çasjes në të drejtat elementare socio-ekonomike. Sulmet në të kthyerit janë të rralla. Sfidat kryesore janë problemet socioekonomike, shkollimi, çështjet pronësore, mungesa e fondeve, tensionet ndër-etnike në disa vende dhe mungesa e përkushtimit nga ana e institucioneve.

Pa sigurinë që e ofrojnë emigrantët dhe paratë nga diaspora, mirëqenia e një pjese të madhe të popullsisë do të ishte shumë më e keqe. Megjithatë, është gjë pozitive fakti se varfëria është e ‘butë’ sepse shumë njerëz janë ose pak mbi kufirin e varfërisë apo pak nën të. Niveli i varfërisë së ‘butë’ nënkupton se një ndryshim i vogël pozitiv në të hyra, përmes zhvillimit që krijon vende të punës, mund të nxjerr shumë persona nga varfëria.⁶⁹ Vlerësohet se rreth 15 për qind e popullsisë jeton në varfëri të skajshme, do të thotë janë njerëz që e kanë të vështirë të plotësojnë nevojat e tyre themelore për ushqim. (Ilustrimi i.). Rreth 45 për qind (që është pak mbi 2 në 5 kosovarë) raportojnë një nivel të konsumit nën kufirin e varfërisë, e cila sipas çmimeve të vitit 2002 është caktuar të jetë baras me 43 euro për një person të rritur në muaj. Këto nivele të varfërisë janë shumë të larta në krahasim me vendet fqinje dhe ndryshe nga shumë vende të rajonit, nuk kanë pësuar ndryshime për shumë kohë. Vetëm njëzet për qind e popullsisë në gjendje më të mirë kanë pasur një zhvillim të vogël pozitiv në konsum, mes të viteve 2003 dhe 2005, përderisa pjesa tjetër ka pasur zhvillim negativ. Sa i përket grupeve më të varfra, humbjet kanë qenë të konsiderueshme. Pesë përqindëshi më i varfër i popullsisë ka pësuar rënie në konsum prej rreth 10 për qind. Duke shikuar ndryshimet në konsum për rajonet urbane dhe rurale veç e veç, shihet se shkalla e konsumit ka rënë pothuaj për tërë popullsinë rurale, përderisa në rajonet urbane vetëm pesë përqindëshi i fundit i popullsisë ka raportuar rënie të konsumit.⁷⁰

Përveç varfërisë së mbetur në këtë nivel, një pjesë e madhe e popullsisë rrezikohet nga varfëria. Një tronditje që zvogëlon të hyrat për 25 për qind mund të shtyjë një numër prej 18 për qind shtesë të popullsisë nën kufirin e varfërisë. Një rritje e ngjashme pozitive në të hyrat e popullsisë mund të largojë shumë njerëz nga varfëria. Kjo pasqyron fenomenin se përderisa varfëria është mjaft e përhapur, ajo është e ‘butë’ në kuptimin se një pjesë e

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ King, Iain dhe Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në Kosovë* (KOHA: Prishtinë).

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ European Union Election Expert Mission to Kosovo, ‘Final Report’, 25 January 2011.

madhe e popullsisë është afër kufirit të varfërisë. Rreth 40 për qind e grupeve të rrezikuara vlerësohet se jetojnë në Prishtinë dhe Prizren.⁷¹ Aktualisht, rreth 1 në 5 kosovarë kanë raportuar të kenë të paktën një anëtar të familjes i cili është emigrant. Po aq kanë raportuar të kenë pranuar para nga diaspora. Sa për krahasim vetëm 13 për qind e popullsisë përfitojnë ndihmën sociale, që është drejtuar vetëm për grupet më të varfra. Ato familje që kanë emigrantë gjithashtu raportojnë nivel më të lartë të konsumit dhe është vlerësuar se janë më pak të varfra. Dëshmitë nga anketat e ekonomive familjare tregojnë se ata që kanë 10% prirje më të madhe për emigrim raportojnë 2 për qind më shumë konsum. Një krahasim i ekonomive familjare me emigrantë jashtë vendit dhe atyre me karakteristika të ngjashme, por pa emigrantë, tregon se këta të fundit paraqesin rreth 25 % të shpenzimit të përgjithshëm të atyre që janë në kufi të varfërisë së skajshme. Manifestimi i varfërisë në mesin e familjeve me emigrantë gjithashtu është më e vogël, për rreth 7 për qind krahasuar me popullsinë e përgjithshme.⁷² Niveli më i lartë i konsumit dhe shkalla më e ulët e manifestimit të varfërisë për ekonomitë familjare me emigrantë janë edhe më të theksuara në zonat rurale. Për shembull, paraqitja e varfërisë për ekonomitë familjare me emigrantë është rreth 20 për qind më e ulët se te ekonomitë familjare të ngjashme në zonat rurale që nuk kanë emigrantë. Në pajtim me aspiratat evropiane, objektivat zhvillimore të Kosovës synojnë të krijojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse me standarde më të mira të jetës. Kjo nënkupton përparim në një varg fushash, si qeverisja demokratike, decentralizimi efektiv dhe strategji gjithëpërfshirëse sektoriale.⁷³ Megjithatë kjo nuk do të jetë e lehtë sepse Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida me të cilat ballafaqohen të gjitha shtetet e dobëta: me mungesë të madhe të investimeve për plotësimin e nevojave dhe me burime të kufizuara të qeverisë për të përmbushur ato, marrëdhënie të ndara shoqërore dhe me nivel të dobët të sigurisë.⁷⁴ Do të jetë e nevojshme që të caktohen veprimet me prioritet që do të sillnin përmirësime të shpejta të mirëqenies së popullsisë me qëllim të forcimit të kohezionit social dhe të sigurimit të paqes së qëndrueshme. Përderisa e gjithë kjo është pjesë e negociatave për statusin përfundimtar, analizat në këtë raport theksojnë katër aspekte me të cilat mund të përmirësohet mirëqenia. Siç është theksuar më lartë, varfëria është e mjaft e përhapur dhe një numër shumë i madh të njerëzve preken edhe nga tronditjet e vogla. Kur një pjesë e madhe e popullsisë jeton në kufi të varfërisë dhe pabarazia është e ulët, natyrisht që është e kuptueshme se ndjeshmëria e varfërisë ndaj zhvillimit (elasticiteti i zhvillimit të varfërisë) është shumë i lartë.⁷⁵ Në Ballkanin perëndimor, Shqipëria paraqet shembullin më të qartë se si zhvillimi i madh dhe i qëndrueshëm mund të zvogëlojë varfërinë në shkallë të madhe. Në fillim të vitit 2000, rreth një e katërta e popullsisë së Shqipërisë ishte e varfër, dhe niveli i pabarazisë ishte i ulët. Megjithatë, me një nivel të zhvillimit vjetor prej 6 për qind në mes të viteve 2002 dhe 2005, varfëria ka rënë nga 25 për qind sa ishte në vitin 2002, në rreth 18.5 për qind në vitin 2005, duke nënkuptuar një elasticitet mes zhvillimit dhe varfërisë prej -1.5. Përveç Shqipërisë, shumë vende të tjera të botës me kushte jetësore të ngjashme me ato në Kosovë – varfëria e përhapur por jo e thellë dhe pabarazia e ulët, kanë mundur që të

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty.

⁷³ European Union Election Expert Mission to Kosovo, „Final Report“, 25 January 2011.

⁷⁴ Komisioni Evropian, „Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015“, Bruksel, 10.11, 2015, SĚD (2015) 215 final.

⁷⁵ Po aty.

mundësojnë një zhvillim të lartë dhe gjithëpërfshirës. (Ilustrimi vii paraqet disa prej të këtyre vendeve). Për të mundësuar zhvillimin e perspektivave Kosovës për reduktimin e varfërisë, vëreni se 5 për qind e zhvillimit të BPV-së gjatë 5 viteve të ardhshme, e kombinuar me elasticitetin mes zhvillimit dhe varfërisë ngjashëm me atë të Shqipërisë, do të thotë ulje të varfërisë prej 38 për qind, ose rënie e varfërisë absolute nga 45 në 28 për qind. Me një nivel të tillë të zhvillimit dhe me një elasticitet të tillë mes zhvillimit dhe varfërisë për vendet e BSHP-së me të hyra te mesme prej -3.1, varfëria do të binte për 75 për qind ose nga 45 në 11 për qind në këto 5 vite.⁷⁶

- **Ngërçet politike pozitë-opozitë**

Ngërçet politike janë produkt i regjimeve politike të vetë politikanëve. Në vendet e vogla kesi ngërçesh gjenerohen kohë pas kohe dhe përbëjnë modelin më evident të periudhave tranzicioniste. Në historinë politike të Shqipërisë së 24 viteve të postkomunizmit ata janë ricikluar kohë pas kohe. Zgjidhja e tyre gjendet po mes politikanëve dhe realizohet vetëm prej protagonizmit të tyre. Kështu ka për të ngjarë edhe me ngërçin aktual politik në Kosovë. Zgjidhja nuk është larg, sikundër edhe nuk vjen prej jashtë. Kasta politike po paralizon zgjidhjen. Janë vetëm në kohën për realizimin e këtij pazari. Mos prisni të jenë racionalë apo të mendojnë se kenë brengë kualitetin e ri qeverisës. Nuk ngjet kjo me elitën politike të shqiptarëve në asnjë prej pjesëve administrative ku jetojmë ne shqiptarët. Vonesa ka lidhje së pari me faktin që pala që formuloi shumicën parlamentare post-zgjedhjeve gjendet në rolin e së kompozuarës pas zgjedhjeve. Ndërsa pala tjetër që “e lodhi pushteti” vuan pasojën e megalomanisë së humbur. Në këtë gjendje të dy palëve, janë faktorë dhe pjesë vepruese, aktorët brenda palëve të saponara si pozitë dhe opozitë e re e vendit. Zgjidhja ka nisur, qysh kur Hashim Thaçi nuk ka më asnjë gjasë për të qenë qeverisës vijues dhe që kur koalicioni LDK-AAK-Nisma dhe VV ka formuluar skemën për të mos e lënë qeverisjen te tjetri. Koha e mbetur, të cilën ju e përcaktoni si “ngërç” është vetëm kapitulli hyrës i një pushteti të ndarë jo dhe aq në mënyrë të qëndrueshme për kohën pasuese.⁷⁷

Demokracia dhe demokratizimi i brendshëm i partive politike të Kosovës është një nga çështjet më të rëndësishme për demokratizimin e tërësishëm të Kosovës. Në kapitullin për demokracinë e brendshme partiake është theksuar që demokracia, si pluralizëm i alternativave politike është një përvojë e re për Kosovën, si dhe ajo që funksionimi i brendshëm i subjekteve politike është i përcaktuar nga forca të jashtme, të tilla si sistemi zgjedhor, kultura politike, rregullat e zgjedhjes, etj.⁷⁸ Nga ky këndvështrim, kapitulli i përshkruan strukturat organizative dhe proceset e vendimmarrjes së brendshme të subjekteve politike të Kosovës, dhe analiza bazohet në katër subjektet kryesore: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këtu analizohet korniza ligjore që ka të bëjë me proceset e demokracisë së brendshme, organizimi i brendshëm i subjekteve politike, të drejtat dhe kufizimet e anëtarëve të partive politike,

⁷⁶ Council of Europe, ‘Parliamentary Assembly Doc.11465 Procedural guidelines on the rights and responsibilities of the opposition in a democratic parliament’. 3 January 2008.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Knoll, Bernhard, ‘Fuzzy Statehood: An International Legal Perspective on Kosovo’s Declaration of Independence’, *Review of Central and East European Law* 34 (2009) 361-402.

funksionimi i subjekteve në nivelin lokal, roli dhe ndikimi i grave, të rinjve dhe i komuniteteve, etj. Njësoj si dhe gjatë të tërë periudhës së pasluftës, edhe në skenën e sotme politike të Kosovës kemi dominim të dy subjekteve politike, të PDK-së dhe LDK-së, që e kanë përqindjen më të lartë të votuesve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Edhe pse këto dy subjekte njëkohësisht i përfaqësojnë edhe dy krahët e ndryshëm konceptual politik – PDK-ja krahun e luftës, dhe LDK-ja atë ‘paqësor’ – këto që të dyjat ideologjikisht thirren në të djathtën. Ideologjia e subjekteve të tjera me baza elektorale më të mëdha, që janë të përfaqësuara në Kuvendin aktual të Kosovës, si LVV dhe Nisma për Kosovën është e deklaruar si e qendrës së majtë, ndërsa subjekti tjetër relevant, AAK-ja, është i deklaruar si i qendrës së djathtë. (Malazogu dhe Gautam, 2014:). Më poshtë është e dhënë përbërja e plotë e Kuvendit sipas të dhënave nga KQZ-ja, ku në bazë të numrit të votave është bërë përllogaritja proporcionale e përqindjeve të fituara në zgjedhje dhe e numrit të ulëseve në Kuvend (KQZ, 2014: 2-3). Vlen të theksohet që përpos subjekteve që zyrtarisht ishin kandiduar në zgjedhje, ka patur edhe lëvizje të deputetëve nga njëri grup parlamentar në tjetrin, mirëpo kjo nuk e ka ndikuar koalicionin qeverisës (PDK me 35 vende, LDK me 33 vende, LVV me 16 vende, Lista Serbe me 10 vende, AAK me 9 vende, Nisma për Kosovën me 6 vende, Grupi 6+ me 6 vende, dhe Pa grup me 5 vende). qeverisës. Pastaj kemi grupin e dytë, që mund të quhet si ‘i ndërmjetëm’, që ka mangësi të resurseve dhe të fuqisë së mjaftueshme politike për të fituar, por që ka resurse të mjaftueshme si elektorat dhe ulëse në Kuvend për të patur rëndësinë e vet të vendosjes. Në fund kemi edhe grupin e tretë që përfaqëson interesa të klasave të ndryshme (apo të ngushta) shoqërore, dhe që lëviz në krahe të ndryshme politike ashtu sikurse edhe grupi i dytë. Si parti kryesore në Kosovë me bazën më të madhe votuese janë LDK dhe PDK. Në Kosovë, përpos këtyre dy partive politike nuk ka patur ndonjë parti tjetër që t’i ketë fituar zgjedhjet parlamentare (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015). Me këtë nënkuptohet që këto dy parti kanë edhe bazën elektorale më të madhe në vend. Ndërkaq, si parti të ndërmjetme kemi LVV-në dhe, posaçërisht AAK-në, që vazhdimisht kanë ndryshim të madhësisë elektorale, dhe që kanë rol domethënës në formimin e koalicioneve qeveritare. Si grup të tretë kemi partitë e vogla që kryesisht janë organizata jo-efikase në mundësitë e tyre për të qeverisur, për shkak të numrit të vogël të votuesve që është i pamjaftueshëm në sistemin zgjedhor në Kosovë. Qëllimi final i këtyre partive të vogla është që objektivat e tyre t’i realizojnë përmes futjes në qeverisje me partitë tjera të mëdha, ku në të njëjtën kohë kjo lëvizje e tyre politike është e mjaftueshme për akomodimin e ndonjë grupi të vogël të njerëzve të afërt të tyre. Si arsye kryesore për lëvizjet e tilla nga partitë e vogla është pragu zgjedhor prej 5%, që për to është vështirë i kalueshëm (Zgjedhjet e Përgjithshme - KQZ, 2015). Në historinë politike të Kosovës së pasluftës që ka zgjatur pak më shumë se një dekadë, me përjashtim të LDK-së që në fillim kishte përqindje të lartë votuesish, nuk ka pasur dominim absolut të subjekteve politike. Si rrjedhojë, brenda mundësive të tyre në sistemin politik të Kosovës, subjektet politike gjithnjë kanë qenë të detyruara të lidhin koalicione me subjekte të tjera për t’i arritur numrat për një qeverisjeje stabile. Subjektet relevante politike të sipërpërmendura janë marrë si shembull për shkak të primatit të tyre në skenën politike të Kosovës në zgjedhjet e fundit. Po ashtu, këto parti, statutet e tyre partiake i kanë harmonizuar me sistemin aktual zgjedhor, ku ndër të tjera rregullohen edhe lidhja e koalicioneve për qeverisje, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal (këtu bën përjashtim partia Nisma për Kosovën, që ende nuk posedon statut, dhe Lista

Serbe që nuk është e regjistruar si parti politike). Sipas gjetjeve, kompetenca për lidhje të koalicioneve ndryshon (ose, është e shpërndarë) në dy organe të partive në fjalë; në Këshillet Drejtuese dhe në Kryesitë e partive (rregullimi i lidhjes së koalicioneve sipas statuteve të partive politike në Kosovë është e trajtuar më gjerësisht në kapitullin 6. Demokracia Brendapartiake).⁷⁹

- **Bisedat Kosovë –Serbi**

Akademik Esat Stavileci, në një intervistë të gjatë, deklaronte se “me të drejtë thuhet se duhet të bisedohet, qoftë dhe me armikun, me kusht që palët të jenë të barabarta në bisedime. Të mos qenët të barabartë në bisedime, në të mëparshmet dhe në këto të tashmet në Bruksel, më kanë mbajtur të rezervuar, derisa vetë ato i kam quajtur një “investim i gabueshëm i bashkësisë ndërkombëtare”. Kam thënë se po qe se bisedohet me Serbinë, qoftë edhe për të ashtuquajturat “çështje teknike”, pa u bërë një përlllogaritje e pasojave të luftës së tmerrshme në Kosovë, do të legjitimohet gjithë ajo që Serbia shkaktoi në Kosovë, me politikën shfarosëse ndaj shqiptarëve, të cilën e zhvilloi në mënyrë sistematike, të planifikuar dhe të vazhdueshme.⁸⁰ Prandaj, ndeshja nuk duhej të fillonte nga “rezultati zero”, sikur asgjë të mos kishte ndodhur në Kosovë. Serbia nuk u kushtëzua me asgjë. Bashkësia ndërkombëtare nuk duhej ta fuste Kosovën në një rrugë, skaji i së cilës nuk shihet edhe sot. Ajo nuk duhej ta favorizonte Serbinë dhe, nga ana tjetër, të kërkonte koncesione prej Kosovës. Bisedimet në Bruksel kanë rëndësinë e vet, por në radhë të parë ato e favorizojnë Serbinë, ndërkohë që Kosovës i premtohet një “shpërblim” për koncesionet e bëra. Serbët nuk janë të njohur për marrëveshje. Ata janë të njohur më shumë për mosmarrëveshje. Prandaj, me serbët asgjë nuk është e besueshme, qoftë edhe atëherë kur “ka marrëveshje”.⁸¹ Kërkesat e tyre nuk kanë të ndalur. Ata duan “hisen e vet” në Kosovë dhe nga ajo nuk heqin dorë lehtë. Nëse “kanë dalur nga Kosova” nëpër një “derë të madhe”, kërcënon rreziku që të “rikthehen” në të nëpër “disa dyer më të vogla” dhe të involvohen në jetën dhe ngjarjet në Kosovë. Në Kosovë ende ka “ndërhyrje” të Qeverisë së Serbisë, veçanërisht në pjesën veriore të saj. Kosova ende nuk ka kompetenca të plota në territor, në kontroll, në ligj dhe në zbatimin e tij, ku gjithandej Kosovës i thonë Kosovë në Kushtetutën e saj”. Edhe pas bisedimeve të Vjenës, të cilat ishin bërë me mbështetjen dhe ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare, Kosova u “detyrua” të pranonte bisedime të reja politike me Serbinë. Grupi negociator, që përfaqësonte Kosovën dhe shqiptarët në bisedimet e Vjenës, pati bërë lëshime të mëdha dhe me pasoja afatgjate, duke besuar se po “jepnin të dhimbshmen për të fituar të këndshmen”. Ky grup naivisht besonte se me këto lëshime Serbia do të ngopej dhe nuk do të ndërhynte më në punët e Kosovës! Por, kishin harruar atë thënien se “oreksi rritet duke ngrënë”. Serbisë me këto lëshime të pakuptimta dhe të rrezikshme për funksionimin normal të Kosovës iu rritë oreksi për ndërhyrje dhe lëshime të reja. Veriu i Kosovës po duket se ishte lënë nën kontrollin e Serbisë (de fakto) enkas dhe vetëm me qëllim që të shantazhohej liria e Kosovës dhe shpëputja e saj nga Serbia. Por, edhe nëse ndodhë që Kosova ta shpallë pavarësinë e saj, ajo të mos mundet të shpëputet plotësisht nga Serbia. Me një fjalë, Veriu i Kosovës, enklavat (komunat), kishat dhe monumentet “serbe” me zonat e tyre të mbrojtura dhe me

⁷⁹ Council of Europe, ‘Code of Good Practice in the Field of Political Parties’, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Study No. 414/2006.

⁸⁰ Komisioni Evropian, ‘Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015’, Bruksel, 10.11.2015, SĚD (2015) 215 final

⁸¹ Po aty.

exterritorialitete garantonin praninë e Serbisë në Kosovë dhe të interesave të saj shovinistekspansioniste. “*Ngutja e një pjese të bashkësisë ndërkombëtare dhe qeverisë për të përfunduar misionin e Zyrës Ndërkombëtare Civile, deklaronte Shpend Ahmeti nga Lëvizja Vetëvendosje, është për të filluar një mision të ri të dialogut politik dhe koncesioneve të reja për Serbinë në veri. Bashkësia Ndërkombëtare tashmë e ka pranuar se oferta Ahtisari për Serbinë është refuzuar nga vetë Serbia, dhe tani ka nevojë për një ofertë të re. Për të bërë ofertën e re me një pako të re duhet të përmbyllet ajo e vjetra. Koncesionet nga pakaja e Ahtisarit neve na mbeten, ndërsa tani na presin të reja duke e bërë Kosovën shtet tërësisht jofunksional. Kështu edhe ndodhi. Trysnia e bashkësisë ndërkombëtare për bisedime të reja-shtesë me Serbinë ishte e papërballueshme për politikanët dhe qeveritarët e kapur të Kosovës. Bisedimet e reja midis Prishtinës dhe Beogradit nisën më 8 mars 2013. Me këtë marrëveshje Serbisë i lejohej të financojë komunat serbe në Kosovë, arsimin, shëndetësinë, etj. Sipas kësaj marrëveshjeje Forca e Sigurisë (Ushtria e Kosovës) nuk mund të zbarkojë në Veri edhe për disa vjet! Për bisedimet e reja me Serbinë, Kuvendi i Kosovës miratoi edhe një rezolutë.⁸² Bisedimet e reja me Serbinë vazhdoi t’i kundërshtonte Lëvizja Vetëvendosje, e cila organizoi edhe protesta e demonstrata kundër këtyre bisedimeve. Bisedimet Kosovë-Serbi kësaj radhe u ndërmjetësuan nga BE-ja dhe me ndihmën e pakursyer të SHBA-së. “Ndërmjetësimi ose negociatat, edhe sipas Jonuz Avdullait, janë formë e zgjidhjes së konflikteve nëpërmjet të inkudrimin të palës së tretë”. Bashkimi Evropian thotë se në këtë dialog është vetëm lehtësues dhe se ndaj statusit të Kosovës mban qëndrimin e tij neutral. Sidoqoftë me marrëveshjen e 19 prillit dhe me bisedimet midis Thaçit e Daçiçit, që po vazhdojnë, në Veri të Kosovës janë krijuar rrethana të reja. Krijimi i një asociacioni-bashkësie komunash serbe në Kosovë ka qenë mjaft joshës për Beogradin dhe pakicën serbe në Kosovë. Ashtu si Plani i Ahtisarit, edhe marrëveshja për themelimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë, hapi debat të madh midis atyre që ishin “për”, pa u hamendur fare, dhe atyre që ishin “kundër”. Derisa Beogradi zyrtar dhe Kisha Ortodokse Serbe kanë pranuar themelimin e bashkësisë së komunave serbe si zgjidhje politike të favorshme për serbët e Kosovës, atëherë politika zyrtare e qeverisë, e parlamentit dhe e presidencës së Kosovës, fare nuk e kanë të vështirë, që ta kuptojnë esencën e zhvillimit të dialogut Thaçi-Daçiç në Bruksel nën patronatin e shefës së politikës së jashtme të BE-së, Catherine Ashton. “Fjala është për decentralizimin e sistemit të pushtetit shtetëror dhe për rajonizimin gjeopolitik dhe territorial të Republikës së Kosovës, jo për kurrfarë organizate joqeveritare a humanitare, por thjesht për një Organizatë-Bashkësi të gjerë politike me kompetenca dhe me autorizime ekzekutive dhe legjislativ si pandan i sistemit ekzistues të Republikës së Kosovës”.⁸³ Këtë zgjidhje dhe këto lëshime të mëdha që po bënte Kosova vazhdonin të refuzoheshin nga serbët e Veriut, të cilët në fakt udhëhiqen nga Beogradi. “Populli serb në⁸⁴ Në pikën e parë të marrëveshjes së 19 prillit, të nënshkruar në Bruksel thuhet se do të ketë një Asociacioni/Bashkësi me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësia do të jetë e hapur për secilën komunë tjetër nëse anëtarët aktualë pajtohen, që do të thotë se pa pëlqimin e komunave me shumicë serbe (anëtare) nuk mund të anëtarësohet një komunë tjetër (shqiptare) edhe po që se shpreh dëshirën për të qenë anëtare e asaj bashkësie. Kjo*

⁸² Rugova, Ibrahim, *Çështja e Kosovës: Biseda me Marie-Francoise Allain dhe Xavier Galmiche* (Dugagjini, Pejë, 1995).

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Memorandumi i Zyrës së BE-së në Kosovë dërguar liderëve politikë në Kosovë, ‘Memo to Party Leaders on Kosovo’s Electoral Reform Process from the EUSR/Head of European Union Office and EU Member States represented in Pristina’. Shih <http://elibraria.org/assets/General-Principles-for-Electoral-Reform.pdf> (12 janar 2014).

marrëveshje edhe shënon fundin e Kosovës “multietnike” (ahtisariane). Më tej në pikën 2 të kësaj marrëveshjeje saktësohet se Bashkësia/Asociacioni do të krijohet me statut. Shpërbërja e saj do të ndodhë vetëm me një vendim të komunave pjesëmarrëse. Garancionet ligjore do të jepen me ligjin e aplikueshëm dhe ligjin kushtetues (duke përfshirë shumicën prej 2/3). Me këtë pikë të marrëveshjes garantohej paprekshmëria e kësaj bashkësie, të cilën nuk ka fuqi që do të mund ta shpërndante, pos nëse vetëshpërndahet! Marrëveshja garanton edhe përfshirjen pa kushte të strukturave të sigurisë, të ngritura nga Serbia në Veri, në strukturat e sigurisë së Kosovës. E papranueshme, e dëmshme dhe me rreziqe për zingjirin komandues, strukturën unike të policisë së Kosovës është edhe pika 9 e kësaj marrëveshjeje, e cila bënë koncesione të papranueshme për katër komunat e Veriut.⁸⁵ Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat me shumicë serbe (Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviç), thuhet në pikën 9 të marrëveshjes. Komandanti i këtij rajoni duhet të jetë serb, shtetas i Kosovës, i nominuar nga Ministria e Brendshme nga një listë e dhënë nga 4 kryetarët e këtyre komunave në emër të Asociacionit. Përbërja e Policisë së Kosovës në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullsisë së katër komunave.⁸⁶ (Do të jetë një tjetër Komandant Regjional për komunat e Mitrovicës Jugore, Skenderajt dhe Vushtrisë). Komandanti regjional i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantët e tjerë regjionalë. Marrëveshja cenon edhe sistemin e drejtësisë me pikat 10 dhe 11. Marrëveshja e Brukselit, e 19 prillit ka gjithsejtë 15 pika. Njëra nga ato pika ka parashikuar edhe organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve në Veri. Përpjekjet për mbajtjen e zgjedhjeve të 3 nëntorit edhe në Veri rezultuan me konfrontime dhe me dështim në tri qendra të votimit në Veri. Megjithatë, po të mos ishte Serbia në kufi me Kosovën edhe kjo pozitë dhe këto super të drejta të pakicës serbe do të mund të administroheshin nga shteti i Kosovës. Por, Serbia me pretendimet e saj territoriale dhe me ekspansionizmin e saj do të vazhdojë të bëjë trysni e ta shantazhojë Republikën e Kosovës dhe varësisht nga konjunkturat rajonale e ndërkombëtare do të angazhohet edhe për destabilizimin dhe ndarjen e Kosovës.⁸⁷ Vetëm përgatitja dhe fuqizimi ekonomik e ushtarak i Republikës së Kosovës dhe i Republikës së Shqipërisë dhe zotësia e përballjes edhe me luftë me Serbinë do ta frenonte atë dhe do ta bënte të “arsyeshme”. Është interesant se edhe pas kësaj marrëveshjeje, UNMIK-u vazhdon të mbetet në Veri të Kosovës në rolin e ndërmjetësit midis komuniteteve, ndërlidhjes dhe koordinimit të organizatave dhe mekanizmave ndërkombëtarë, ndërlidhjes dhe rritjes së komunikimit mes zyrtarëve komunalë legalë dhe atyre jolegalë! Por, i gjithë anagzhimi i UNMIK-ut në këto fusha mund të thuhet se ishte i dështuar, për ne, por plotësisht i suksesshëm për interesat serbe. Gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tij në Veri të Kosovës UNMIK-u ka dëshmuar njëanshmërinë e tij të skajshme, duke favorizuar, toleruar dhe mbështetur institucionet dhe strukturat e Serbisë në atë pjesë të Kosovës. Prandaj, institucionet e Kosovës do të duhej të ishin më të vendosura dhe më të angazhuara për largimin përfundimtar të këtij misioni moti të padëshiruar. Bazë e fuqishme dhe e padiskutueshme për largimin e UNMIK-ut është edhe mendimi i GJND-së, e cila ka thënë se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244. Largimi ose dëbimi i UNMIK-ut nga Kosova është i domosdoshëm për një ecje dhe zhvillim më të sigurtë dhe më normal të Republikës së Kosovës. Sipas të gjitha gjasave, pas mbajtjes së zgjedhjeve në Veri të Kosovës dhe pasi atje fitoi lista e Serbisë dhe kandidatët e saj, UNMIK-u (nëse konsideron se e ka përmbushur

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Po aty.

⁸⁷ Po aty.

misionin e tij) do ta shpallë të përfunduar me sukses misionin e tij edhe në Veri të Republikës së Kosovës.⁸⁸

“Në rrugën e gjatë drejt lirisë vjen një kohë që bisedimet janë të domosdoshme”. Por puna është kush do ta përfaqësonte dhe si do ta përfaqësonte Kosovën dhe popullin shqiptar në këto bisedime. Korniza e këtyre bisedimeve ishte vendosur që më parë. Ishte vendosur edhe për “llojin” e shqiptarëve që mund të ishin pjesë e këtyre bisedimeve. Takimet në nivel të ministrave të pushtetit lokal dhe në nivel të ministrave të kulturës (Kosovë-Serbi) kishin filluar para raportit të Kai Eides dhe para hapjes së negociatave. Nisja e këtillë e bisedimeve ishte kundërshtuar edhe nga PDK-ja dhe grupi i saj parlamentar. “PDK-ja kërkon nga Kuvendi i Kosovës, fillimisht të distancohet nga forma dhe mënyra se si ministra të caktuar të Qeverisë së Kosovës kanë nisur bisedimet politike me Beogradin për çështje që kryekrejt janë sfida të brendshme të institucioneve të Kosovës”. Megjithatë, parapërgatitjet për bisedime me Serbinë kishin nisur pa u publikuar raporti i Kai Aides dhe pa u dhënë pëlqimi nga Këshilli i Sigurimit për hapjen e bisedimeve. Edhe ata (drejtuesit e partive politike shqiptare në Kosovë, sidomos të partive të pas luftës), që kishin bërë nga një thes me deklaratat kundër bisedimeve dhe kompromiseve me Serbinë po përfshiheshin pak nga pak, por sigurt e me vendosmëri, në përgatitjen dhe pjesëmarrjen në bisedimet me Serbinë. Kryetari fiktiv i Kosovës unmikiane të asaj kohe, Ibrahim Rugova, ishte bërë një deklaratë për krijimin e “grupit të unitetit”, që do të merrte pjesë në bisedime. Ky grup do të përbëhej nga I. Rugova, H. Thaci, B. Kosumi, N. Daci dhe Veton Surroi. Bashkërendues i grupeve të punës u emrua B. Shala. Ky grup u miratua formalisht edhe nga Kuvendi i Kosovës.⁸⁹

Të gjithë jemi dëshmitarë se si filluan, si vazhduan bisedimet dhe se si u krijua Grupi negociator. Dihet se si u votua për këtë Grup. Në arkivin e Kuvendit është edhe shiriti filmik. Bisedimet me Serbinë kundërshtoheshin për disa arsye. E para, sepse Kosova hynte në bisedime si një krahinë e përfaqësuar nga një grup politik (shumëpartiak), kurse Serbia hynte në bisedime si shtet. E dyta, Serbia hynte në bisedime me një dokument të miratuar nga Kuvendi i Serbisë më 29 prill 2004, ndërsa Kosova hynte në bisedime pa një dokument të miratuar në Kuvendin e Kosovës. Rezultoi që dokumenti i Serbisë, i miratuar në Kuvendin e Serbisë, u bë (në thelb) plani Atisarit! Kush të doj mund t’i krahasoj këto dy dokumente (atë të Serbisë dhe të Atisarit). Dokumenti i Serbisë është edhe sot i publikuar në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Dukej që Fuqitë e Mëdha, përmes zyrave të tyre në Prishtinë dhe kanaleve tjera të dukshme e të padukshme kishin rritur trysinë ndaj palës shqiptare, e cila po detyrohej të shkonte në bisedime rezultati i të cilave dihej: “decentralizim” (krijim i komunave dhe zonave të mbrojtura serbe), mbrojtje e trashëgimisë kulturore e fetare “serbe” në Kosovë (territori autonom serb) dhe një gjysmë pavarësie.⁹⁰ Këto ishin deklaruar në të gjitha deklaratat, raportet dhe dokumentet e organizmave të ndryshme rajonale dhe botërore. Megjithë krijimin e “grupit të unitetit” Kosova nuk ishte unike për çështjen e bisedimeve me Serbinë. Partia Demokratike e Kosovës, e cila në atë kohë ishte në opozitë, hezitonte të hynte në bisedime pa u shpallur Pavarësia e Kosovës. Ajo kërkonte që “faktori i unifikuar politik i përfaqësuar në Kuvend të bëjë zyrtarizimin e Pavarësisë së shtetit të Kosovës, para se të fillonin bisedimet apo negociimet”. Sepse, në Kosovë tashmë ishte krijuar opinionin se Bashkësia Ndërkombëtare ia kishte me hile Kosovës dhe popullit shqiptar. I vetmi vend i besueshëm mbetej Amerika.

⁸⁸ Raporti i Progresit 2013 për Kosovën. Bruksel, 16. 10.2013. SĚD (20130 416).

⁸⁹ Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo.

⁹⁰ Po aty.

Lëshimet që po bënte pala shqiptare ishin të mëdha dhe me pasoja afatgjate për kombin shqiptar në Iliri-Ballkan. Zgjidhjet që ofroheshin nga Serbia dhe ndërkombëtarët herët a vonë mund ta rrezikonin Kosovën me një “bosnizim”. Edhe Esat Stavileci deklaronte në një intervistë se “është mangësia e këtij procesi të decentralizimit që po pretendon të vendosë harta të reja etnike, sepse krijimi i komunave të reja shpërfaqë atë oreksin e Serbisë, e cila sa unë di, më tepër është e interesuar për territore serbe në Kosovë, sesa për serbët në Kosovë. Krijimi i komunave të reja, qofshin ato të quajtura serbe apo me shumicë serbe dhe po qe se kësaj i shtohet edhe mundësia e lidhjeve zinxhirore, kërkon që të kihet parasysh mundësia për ndarje dhe nënndarje të mëvonshme. Unë, natyrisht, këtë proces të decentralizimit e kam kuptuar si përpjekje të bashkësisë ndërkombëtare për të vendosur një proces të integritetit të pakicës serbe në institucionet e Kosovës, por droja që kam shfaqur dhe vazhdoj ta shfaq është se po qe se të gjitha veprimet që bëhen, dalin jashtë kornizave ligjore të Kosovës, atëherë kërcënohen me rrezikun për nënndarje të mëvonshme”.⁹¹

Për shumë nga shqiptarët “decentralizimi” shihet si i imponuar nga bashkësia ndërkombëtare për të kënaqur Serbinë dhe interesat e serbëve në Kosovë. Në fakt propozimet, zgjidhjet, planet dhe dokumentet ishin të gatshme. “Pala serbe sigurisht që kishte dhënë pëlqimin për këto zgjidhje, ndërsa pala shqiptare nuk mund të kundërshtonte dhe linte përshtypjen se ishte tepër e kënaqur”. Me t’u kthyer nga takimi i parë, Lutfi Haziri deklaroi me një emocion fëmijor në aeroportin e Prishtinës se ia kishin bërë tetë me dy Serbisë! Për ta rritur shkallën e besueshmërisë dhe të rëndësisë së këtyre bisedimeve, më 24 korrik 2006, UNOSEK-u kishte organizuar një takim të nivelit të lartë (takim elefantësh, quhej me pompozitet), i cili u kryesua nga vetë i Dërguari i Posaçëm. Delegacioni i Serbisë kryesohet nga Kryetari Boris Tadiq dhe Kryeministri Vojislav Koshtunica, ndërsa ai i Kosovës nga Fatmir Sejdiu, Kryetar i Kosovës unmikiane. Në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e Grupit të Kontaktit, BE-së dhe NATO-s si vëzhgues. Përveç takimeve të drejtëpërdrejta Kosovë-Serbi gjatë vitit 2006 janë mbajtur edhe shumë takime (26) midis ekspertëve të ndryshëm dhe palëve në Prishtinë e Beograd. Gjatë këtij viti ishte raportuar tri herë në Këshillin e Sigurimit (4 mars, 13 korrik dhe 22 shtator) për ecurinë e bisedimeve. Ishin mbajtur takime edhe me Grupin e Kontaktit, me Ministrat e jashtëm të BE-së, me NATO-n, OSBE-n dhe aktorë tjerë ndërkombëtarë. Krahas këtyre bisedimeve dhe përkundër përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare për të gjetur një zgjidhje për statusin e Kosovës, Serbia më 28 dhe 29 tetor 2006 organizoi referendum në Serbi për kushtetutën e re, e cila u hartua dhe miratua pa debat publik. Sipas kësaj kushtetute Kosova ishte “pjesë e pandarë e Serbisë”. Ndërsa më 21 janar 2007 Serbia organizoi zgjedhjet e përgjithshme.⁹² E gjithë fushata zgjedhore u shqua me propagandën dhe moton: “Kosova është Serbi”. Vetëm politikani serb, Çedomir Jovanović, nga partia Liberale Demokrate, deklaronte publikisht se “do ta nënshkruante pavarësinë e Kosovës”. “Rusia ishte shteti më me ndikim në Grupin e Kontaktit dhe në UNOSEK. Ajo edhe në rastin më të keq për të, kur pavarësia si zgjidhje të jetë e pandalshme, atëherë pozicionet e serbëve të Kosovës në shtetin e ardhshëm të Kosovës të jenë sa më të fuqishme de jure dhe de facto. Kjo do të thotë se këmbëngulja e Beogradit në planin e decentralizimit, sipas të cilit vihet shumë në pikëpyetje sovraniteti i shtetit të Kosovës në tërë territorin e tij dhe favorët e tjera shumë të mëdha që i bëhen minoritetit serb në Kosovë, janë produkt i ndikimit që ka Rusia në zgjidhjen e statusit të Kosovës”. I Dërguari i Posaçëm, Marti Ahtisari, më 25 janar të vitit 2007 u takua me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve

⁹¹ Po aty.

⁹² Po aty.

të Bashkuara, Ban Ki Mun, në Paris, të cilin e kishte njoftuar me zhvillimet e fundit rreth procesit të statusit të Kosovës dhe ia kishte dorëzuar atij propozimin e tij për këtë çështje. Ndërsa, më 26 janar, Ahtisari ishte takuar në Vjenë me anëtarët e Grupit të Kontaktit, të cilët i kishte njoftuar me përmbajtjen e propozimit të tij, si pjesë e konsultimeve të rregullta dhe si pjesë e procesit të bashkëpunimit të ngushtë në mes të UNOSEK-ut dhe të GK-së. Pas takimeve dhe këshillimeve të domosdoshme, më 2 shkurt 2007, Ahtisari ia kishte dorëzuar propozimin-planin e tij për Kosovën Kryetarit serb, Boris Tadicit, në Beograd, pasi Koshtunica (Kryeministër në ikje nuk e kishte pranuar). Ndërsa në Prishtinë, propozimin e Ahtisarit e morën dhe e pritën me ngazëllim Grupi i Unitetit dhe Kryetari Fatmir Sejdiu. "...nuk kam asgjë personale me këtë Grup të ulur para nesh, por mandati i tyre, të tillë çfarë e kishin, ka përfunduar me planin e Ahtisarit. Por, këta, meqë janë të "kapur" dhe nuk mund të japin dorëheqje, propozoj që ky Kuvend, nëse duam t'i japim mesazhe botës dhe Serbisë se Kosova e ka me gjithë mend të ketë pavarësi të plotë nga Serbia, t'i shkarkojë dhe të emrojë një Qeveri të shpëtimit kombëtar. Sot, deri sa të bëhen ato punë, nëse i bënë ky Kuvend, propozoj të miratohet edhe një rezolutë që rikonfirmon vullnetin e paluhatshëm të këtij populli për pavarësi të padiskutueshme, për pavarësi të plotë nga Serbia".⁹³

Lëvizja "Vetëvendosje", më 10 shkurt 2007, kishte organizuar protestë në Prishtinë kundër pakos-planit të Ahtisarit. Dhuna e policisë së UNMIK-ut ndaj protestuesve ishte e egër dhe vrasare. Policia rumune e UNMIK-ut po qëllonte me plumba vrasës. Dy nga protestuesit Arben Xheladini (1972) dhe Mon Bala (1976) kishin vdekur nga plumbat e tyre. Dhjetëra tjerë ishin plagosur. KMLDNJ dënoi dhunën e policisë ndaj protestuesve dhe e quajti krim veprën e policisë së UNMIK-ut. Përgjegjëse për këtë dhunë të shfrenuar të UNMIK-ut ishin edhe institucionet vendore, të cilat e miratuan në heshtje dhunën e UNMIK-ut. Me dhunën, vrasjet, plagosjet dhe arrestimet e shumëta, UNMIK-u dhe institucionet e tyre vazale vendore dëshironin t'i jepnin porosi jo vetëm "Vetëvendosjes", por mbarë popullit shqiptar.⁹⁴

Propozimin e tij gjithpërfshirës për Kosovën, Ahtisari e paraqiti dhe e shpjegoi para Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 3.4.2007. Megjithatë, Këshilli i Sigurimit, për shkak të Rusisë dhe Kinës nuk mundi ta miratonte një rezolutë me të cilën do të "legjitimohej" Plani i Ahtisarit për Kosovën. Vendet mike (sponzorizuese të rezolutës), anëtare të përherëshme të Këshillit të Sigurimit, dolën me një deklaratë me të cilën shprehën keqardhje që nuk u miratua një rezolutë dhe i dhanë përkrahje propozimit të Ahtisarit. Kuvendi i Kosovës, më 5 prill 2007 miratoi një deklaratë për përcaktimin e statusit të Kosovës, me të cilën pranohet dhe përkrahet propozimi i kryenegociatorit, Marti Ahtisari.⁹⁵

Me kërkesë të Rusisë, e cila po shfrytëzonte fuqinë e saj që ia jepte "e drejta e vetos" në KS për ta ndihmuar Serbinë në përpjekjet e saj, Kosovën dhe Serbinë i kishte vizituar një grup ambasadorësh nga 15 vende anëtare të KS. Ky grup kishte për qëllim të mblidhte fakte (grup faktmbledhës) dhe t'i raportonte qendrave të vendosjes për gjendjen e pakicave në Kosovë. Në një debat për marrëdhëniet transatlantike në Bruksel, Ndihmësi i sekretarit amerikan të shtetit, Daniel Frid, u kishte thënë gazetarëve se Kosova do të bëhet e pavarur me rezolutën e Këshillit të sigurimit të KB ose me "proces të pakontrolluar" në të cilin serbët e Kosovës do të ishin "viktimat më të mëdha, meqë kjo do të thoshte më shumë dhunë".⁹⁶

Plani i Ahtisarit për Kosovën në një mënyrë është vazhdimësi e perfeksionuar e mbajtjes peng të Kosovës, duke propozuar një status (zgjidhje) që nuk i linte të pakënaqur as serbët

⁹³ Po aty.

⁹⁴ Po aty.

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Po aty.

dhe Serbinë (“duke ia ruajtur fytyrën Serbisë”). Shihet qartë se kjo Marrëveshje nuk shprehë dhe nuk respekton vullnetin e popullit shqiptar me shumicë prej 90% , për të jetuar i lirë dhe i pavarur me sovranitet sikundër popujt tjerë në Evropë. Më tej duke e lexuar tekstin integral të z. Ahtisari hetojmë se, Kosova nuk njihet si shtet i pavarur dhe sovran i ndërtuar në parimin qytetar dhe demokratik, por me një krenari shqiptaro-serbe të ndërtuar me koncensus. Ana pozitive e Planit të Ahtisarit është hapja e perspektivës për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, e një Pavarësie shumëfish të kushtëzuar dhe të mbikëqyrur.⁹⁷ Edhe Republika e Kosovës dhe Kushtetuta e saj nuk do të mund të dilnin dhe të ishin më të fuqishme se Pakoja e Ahtisarit. Ideja për “kosovarizimin” e shqiptarëve, mjerisht ka rrjedhë dhe është fuqizuar prej disa shqiptarëve, të cilët, në të kaluarën kishin pranuar pa rezervë politikën e dikurshme të bashkim-vëllazërimit dhe përbashkësisë së shqiptarëve me kombet sllave. Sot, kjo ide është moderuar me joshjen e shqiptarëve për integrim në Evropën globaliste. Një ide e tillë për ndërrim të identitetit ishte aplikuar edhe nga ish-Jugosllavia totalitare, e cila në prag të shthurjes kishte shpikur përcaktimin kombëtar “jugosllav”. “Ahtisaria” me siguri se do të ketë sukses, nëse ne pajtohemi me këtë projekt dhe nëse pranojmë konvertimin, të cilin po na ofron pakoja dhe Evropa”. Populli shqiptar i Kosovës, si mbarë kombi ynë, ishte dhe është përjetësisht i lidhur me flamurin e tij kombëtar. Vështirë se mund të ketë diçka më të shenjtë se flamuri, të cilin e konsideron simbolin e të gjitha simboleve të tij. Se ç’është flamuri për një popull (komb) po sjell një sintezë të bërë nga Faik Konica për FLAMURIN: “Flamuri përmbledh kujtimet e shkuara të një kombi në një gjuhë të pashkruar që mund ta kuptojë syri dhe zemra e çdo njeriu me ndjenja. Cilat janë kujtimet që shfaq, duke vlerë, Flamuri ynë? Nuk janë kujtime goditjesh kundra fqinjëve, nuk janë kujtime lakmirash dhe rrëmbimesh: janë kujtime vetëmbrojtjeje me mundime të palodhura dhe me trimëri të gjata e të forta që kanë lënë gjurmë në letërsinë e gjithë popujve të qytetëruar. Nga kjo pikëpamje mund të mburremi se Flamuri ynë, siç është një nga më të vjetrit e botës, është dhe një nga më të drejtët». Nëse është kështu, dhe kështu është edhe për popujt e tjerë të qytetëruar, atëherë çfarë kujtimesh do të përmbledh “flamuri” i Ahtisarit për popullin e Kosovës? Kujtimet për “bashkim-vëllazërimin” e kohës së Titos, kujtimet për “kumbaritë” e kohës së Kralit, kujtimet për “bashkëjetesën”, “mirëkuptimin”, “solidaritetin” dhe “dashurinë” me serbët dhe Serbinë, kujtimet për “vitet e lumtura me “vozhdën”, Milosheviçin...?! Pra, nuk do të jenë kujtime “goditjesh kundëra fqinjëve” (zot mos e bënë!), por nuk do të jenë as “kujtime vetëmbrojtjeje” (larg qoftë), sepse fqinjët tanë kurrë nuk na sulmuan dhe as nuk na goditën. Ata, sipas këtij “flamuri” ahtisarian ishin mbrojtësit dhe shpëtimtarët tanë. Nga kjo pikëpamje Ahtisari dhe grupi negociator (puçist) do të mburren se “flamuri” i tyre do jetë njëri nga më të rinjtë dhe nga më të padrejtë e botës. Ndërsa populli i Kosovës, meqë nuk ka sy që ta “lexojë” dhe zemër që ta ndjejë leckën e Ahtisarit, do të mburret gjithmonë me FLAMURIN e kombit shqiptar, me flamurin e UÇK-së.”⁹⁸

Kosova dhe përfaqësuesit e saj gjatë atyre muajve po përgatiteshin dhe po i bashkërendonin përgatitjet e tyre me miqtë ndërkombëtar për shpalljen e pavarësisë. Më 17 nëntor 2007 u organizuan dhe mbajtën zgjedhjet qendrore dhe ato vendore në Kosovë. Partia Demokratike e Kosovës fitoi 34,3 % të votave dhe u bë partia më e madhe në Kosovë, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës kishte fituar vetëm 22,6 %. Pas këtyre zgjedhjeve Kryeministër i Kosovës u bë H. Thaçi (PDK), Kryetar i Kosovës Fatmir Sejdiu (LDK) dhe Kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi (PDK). Afati i fundit i negociatave shtesë për marrëveshje-

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Po aty.

pajtueshmëri midis Kosovës dhe Serbisë, 10 dhjetori 2007, kishte përfunduar pa asnjë marrëveshje. Serbia nuk e pranonte as planin e Ahtisarit, ndërsa Kosova nuk kishte çfarë të lëshonte më.⁹⁹

Në prag të 17 shkurtit 2008 ishin bërë të gjitha përgatitjet për shpalljen e pavarësisë. “Procesi i pavarësimit të Kosovës ka ndjekur një trajektore shumë specifike, duke përfshirë shumë aktorë (OKB, NATO, BE, SHBA dhe vendet e Grupit të Kontaktit) dhe është përmbyllur vetëm kur janë harmonizuar, në masë të plotë, qëndrimet midis këtyre aktorëve të rëndësishëm në vendimmarjen e sotme politike të botës”. Në orën 10:00 (17 shkurt) Kryeministri Thaçi kishte kërkuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, të thirrej një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës. Në orën 12:00 ishte mbajtur mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, ndërsa në orën 15:00 ishte hapur mbledhja e Kuvendit dhe Shpallja e Pavarësisë. Deklaratën e Pavarësisë e lexoi para deputetëve Kryeministri, Hashim Thaçi. E gjithë Kosova ishte në këmbë duke pritur dhe festuar shpalljen e Pavarësisë. Interesim dhe festë në Tiranë, Shkup, Ulqin e kudo në trojet shqiptare dhe kudo që kishte shqiptarë. Shpallja e Pavarësisë përshëndetet nga shumë vende të botës dhe shumë shtete tregojnë se janë të gatshme ta njohin. Më 18 shkurt 2008, Kryetari amerikan, Bush, gjatë një vizite në Tanzani deklaroi se “Kosova tashmë është e pavarur”. Reagimet dhe kundërshtimet e Serbisë dhe të Rusisë, siç pritej, ishin të ashpra. Shpallja e pavarësisë së Kosovës pati jehonë të gjërë në rajon dhe në botë. “Kryeministri serb Vojislav Koshtunica e quajti shtetin e pavarur të Kosovës si një shtet fallco dhe kritikoi qeverinë amerikane për përkrahjen e pavarësisë së Kosovës. Presidenti serb, Boris Tadiç, kishte shkuar në Nju-Jork për të marrë pjesë në një takim të jashtëzakonshëm të KS të OKB, i cili organizohej me kërkesë të Rusisë. Moska i ka kërkuar OKB-së ta anulojë pavarësinë e Kosovës, por SHBA, Franca, Anglia dhe Belgjika kanë kundërshtuar këtë kërkesë të Rusisë. Në kreun e tretë ecëm rrugës që kishte ecur Kosova pas Luftës Kundërpushtuese-Çlirimtare të UÇK-së dhe të mbarë kombit shqiptar. Populli shqiptar dhe përpjekjet e tij për çlirimin e njërës prej krahinave të mëdha të Shqipërisë për herë të parë kishte fituar simpatinë, respektin dhe përkrahjen konkrete të botës së zhvilluar demokratike dhe posaçërisht të SHBA-së. Mirëpo, kombi shqiptar në Iliri-Ballkan dhe shteti i tij ishin ende të pafuqishëm për ta çliruar tërësisht dhe si duhet Kosovën. Në botë kishte edhe një shtet (fuqi botërore) që quhej Rusi. Ky shtet, pas Serbisë, ishte i angazhuar dhe i interesuar që Kosova të mos shkëputej tërësisht nga Serbia. Përveç Rusisë, ishte edhe Kina, gjithashtu fuqi botërore, e cila u bë krah i Rusisë në Këshillin e Sigurimit (OKB). Kishte edhe vende dhe qeveri tjera anëtare të Bashkimit Evropian që ngurronin ta përkrahnin pavarësimin e plotë të Kosovës nga vrasarja e saj, Serbia.¹⁰⁰ Rusia, përveç Abkazisë dhe Osetisë, kishte edhe një arsye të madhe, mbase më të madhen, për ta kundërshtuar shkëputjen e plotë të Kosovës nga bija e saj, Serbia: frikën nga fuqizimi i kombit shqiptar në Iliri (këtë frikë kishin dhe kanë edhe shumë vende tjera), nga njëra anë, dhe praninë afatgjatë të SHBA-së në këtë rajon, nga ana tjetër.

- **Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkrimi i Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015**

⁹⁹ Po aty.

¹⁰⁰ Po aty.

Procesi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ka filluar atëherë kur Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së kishte miratuar propozimin e Komisionit për fillimin negociatave më 12 dhjetor 2012. Bazuar në këtë raport, më 28 qershor 2013, Këshilli i BE-së mori vendimin për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Negociatat kishin filluar më 28 tetor 2013, me takimin e parë të Kryenegociatorëve. Pas hapjes së negociatave, me fokus në kapitujt IV, V dhe VI, raundi i dytë i tyre, i mbajtur më 27 nëntor 2013, u fokusua në përmbylljen e këtyre tre kapitujve, me ç'rast gjithashtu u hapën negociatat për kapitujt I, III, VII, VIII, IX dhe X. Raundi i tretë dhe i katërt u zhvilluan në dhjetor 2013, respektivisht në shkurt 2014, kurse në raundi i pestë (më 24 mars 2014) u fokusua në kapitullin e fundit të mbetur, Kapitullin II, mbi dialogun politik. Pas pesë raundesh të negociatave, takimi përfundimtar i Kryenegociatorëve u mbajt më 2 maj 2014, në Prishtinë, me ç'rast MSA ishte miratuar prej tyre, me vendosjen e inicialeve në korrik 2014.¹⁰¹

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015, përmes *Vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër*, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e *Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër*.¹⁰²

MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes.

Ajo përmban dhjetë 'tituj' (kapituj kryesorë, ose krerë), si dhe shtatë shtojca, pesë protokolle dhe një deklaratë të përbashkët:

- Kreu I: Parimet e përgjithshme;
- Kreu II: Dialogu politik;
- Kreu III: Bashkëpunimi rajonal;
- Kreu IV: Lëvizja e lirë e mallrave;
- Kreu V: Themelimi, ofrimi i shërbimeve dhe kapitali;
- Kreu VI: Përafrimi i ligjeve të Kosovës me *acquis*, zbatimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës;
- Kreu VII: Liria, siguria dhe drejtësia;
- Kreu VIII: Politika e bashkëpunimit;
- Kreu IX: Bashkëpunimi financiar; dhe
- Kreu X: Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe ato përfundimtare.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² D4D, „Trendet zgjedhore 2000- 2014: Analizë numerike e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit“, (Seria: Zgjedhjet dhe partitë politike, Nr. 9, Prishtinë, 2015).

Pjesa dërrmuese e MSA-së bazohet në acquis-n e BE-së, përkatësisht tërësinë e normave juridike të zbatueshme brenda territorit të saj dhe nga të gjitha shtetet anëtare si subjekte juridike, dhe mbulon të gjitha fushat e politikave. Prandaj, Kosova, si shtet që synon anëtarësimin në BE, duhet që gjatë procesit deri te anëtarësimi të miratojnë tërë acquis-në dhe ta bëjë atë pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm. Sipas MSA-së, gjatë vitit 2016, do të krijohen struktura të përbashkta Kosovë – BE për procesin e stabilizim asociimit të cilat do të marrin vendime politike dhe vendime tjera për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e MSA-së. Keto struktura që pritet të themelohen janë:

- Këshilli për Stabilizim Asociim (Niveli më i lartë politik);
- Komiteti për Stabilizim Asociim;
- Nën-komitetet për Stabilizim Asociim;
- Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociim (strukturë e përbashkët mes Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës).

Programi Kombëtar¹⁰³ për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2019 – 2023 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 19 mars 2019. Ai është dokument ligjërësht i detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore, të cilat obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra nën përgjegjësinë e tyre, siç janë planifikuar, dhe të monitorojnë zbatimin e tyre. Qeveria, si mekanizmi qendror nacional përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, mbikëqyr zbatimin e PKZMSA-së përmes institucionit të mandatuar ligjërësht për koordinimin e procesit të integritimit në BE – Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE). MIE monitoron zbatimin e PKZMSA-së, respektivisht të masave afatshkurtra, në baza tremujore, përmes raporteve të rregullta. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe përmirësuar zbatimin e PKZMSA-së, dhe për qëllim të llogaridhënies e transparencës brenda institucioneve dhe ndaj palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë. Gjetjet, mes tjerash, diskutohen nga kabineti i Qeverisë dhe nga organet e stabilizim-asociimit BE – Kosovë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së. Ky është raporti i dytë për vitin 2019, dhe mbulon periudhën 1 prill – 30 qershor. Të dhënat janë raportuar nga secili institucion përgjegjës përmes Platformës Online për Monitorim dhe Raportim për Integritim Evropian, sipas matricës së masave afatshkurtra dhe bazuar në udhëzuesin për këtë qëllim. Në kapitujt ku të dhënat janë raportuar me vonesë ose në mënyrë joadekuate, ato nuk janë përfshirë në raport, dhe masat përkatëse janë vlerësuar si të pazbatuara, përkatësisht që përballen me vonesa serioze. Zbatimi i programit është vlerësuar sipas statusit të ecurisë (paraqitur në diagrame) për masat e planifikuara për t’u zbatuar brenda periudhës raportuese – tremujorit të dytë (prill – qershor), dhe atë si në vijim: Masat e zbatuara (ato të cilat janë zbatuar plotësisht) – me të kaltër; dhe Masat e pazbatuara (ato të cilat nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht, pra që përballen me vonesa serioze) – me të kuqe. Ky raport, që përmban katër kapituj, ndahet në dy pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi dhe ajo mbi secilin bllok. Kapitulli 0 jep një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin e Programit gjatë periudhës raportuese. Ky kapitull përbëhet nga pesë pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi, pjesa mbi kriteret politike, pjesa mbi kriteret ekonomike, pjesa mbi standardet evropiane, dhe pjesa sipas institucioneve. Secila pjesë e këtij kapitulli përmban diagramin dhe

¹⁰³ Komisioni Evropian, „Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2015“, Bruksel, 10.11. 2015, SĚD (2015)215 final.

tekstin narrativ (shpjegimin e gjetjeve). Teksti narrativ për secilin bllok përmbillet me një vlerësim cilësor të gjendjes, ku përmbledhen sfidat kryesore në bllokun përkatës, me theks të veçantë në masat që nuk kanë arritur të përmbushen brenda afatit dhe ato që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit. Kapitujt 1, 2 dhe 3 janë uniformë – secili përmban nga dy pjesë për secilin kapitull të Programit: diagramin dhe tekstin narrativ. Diagramet paraqesin gjetjet mbi nivelin e zbatimit të kapitullit përkatës gjatë periudhës raportuese – në raport me masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të dytë (prill – qershor). Teksti narrativ i secilit diagram jep një përmbledhje sasiore të këtyre gjetjeve, pra numrin dhe përqindjen e masave të zbatuara nga masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda kësaj periudhe. Teksti narrativ gjithashtu jep një vlerësim të shkurtër cilësor të gjendjes së përgjithshme në fushën përkatëse. Raporti gjithashtu përmban dy shtojca. Shtojca 1 paraqet gjendjen e zbatimit të të gjitha masave të Programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të dytë. Shtojca 2 paraqet listën e masave të zbatuara deri në fund të kësaj periudhe para afateve të parapara. Të dhënat tregojnë se gjatë tremujorit të dytë 2019 Programi është zbatuar në nivel prej 35.37%: 29 nga 82 masa të planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar plotësisht, ndërsa 53 prej tyre (64.63%) akoma nuk janë zbatuar plotësisht (shihni diagramin 0.2., fq. 6). Për më tepër, 14 masa janë zbatuar para afateve të parapara.¹⁰⁴

- **Marëveshja sot dhe si më tutje?**

Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA),¹⁰⁵ janë iniciuar bazuar në konfirmimin e perspektivës evropiane të Kosovës në kudër të Studimit të Fizibilitetit, i cili kishte konstatuar se Kosova ishte e gatshme për t'i filluar ato. Bazuar në këtë, më 12 dhjetor 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së kishte miratuar propozimin e Komisionit për fillimin e këtyre negociatave dhe qëllimin e tij për të propozuar direktivat përkatëse, pas përmbushjes nga ana e Kosovës të prioritetëve afatshkurtra të dala nga ky studim (të cilat kishin të bënin me katër fusha: sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe tregtinë). Menjëherë pas publikimit të këtij studimi, institucionet e Republikës së Kosovës kishin filluar zbatimin e kriterëve afatshkurtra, i cili proces kishte përfunduar brenda disa muajsh.¹⁰⁶

Për pasojë, në prill 2013, Komisioni kishte publikuar raportin monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurtra të dala nga Studimi i Fizibilitetit, përmes të cilit kishte konfirmuar se Kosova kishte përmbushur të gjitha këto kriterë për nisjen e negociatave për MSA. Bazuar në këtë raport, më 28 qershor 2013, Këshilli i BE-së mori vendimin për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Negociatat kishin filluar më 28 tetor 2013, me takimin e parë të Kryenegociatorëve. Pas hapjes së negociatave, me fokus në kapitujt IV, V dhe VI, raundi i dytë i tyre, i mbajtur më 27 nëntor 2013, u fokusua në përmbjlljen e këtyre tre kapitujve, me ç'rast gjithashtu u hapën negociatat për kapitujt I, III, VII, VIII, IX dhe X. Raundi i tretë dhe i katërt u zhvilluan në dhjetor 2013, respektivisht në shkurt 2014, kurse në raundi i pestë (më 24 mars 2014) u fokusua në kapitullin e fundit të mbetur, Kapitullin II, mbi dialogun politik. Pas pesë raundesh të negociatave, takimi përfundimtar i Kryenegociatorëve u mbajt më 2 maj 2014, në

¹⁰⁴ European Union Election Expert Mission to Kosovo, 'Final Report', 25

January 2011.

¹⁰⁵ Po aty.

¹⁰⁶ Po aty.

Prishtinë, me ç'rast MSA ishte miratuar prej tyre, me vendosjen e inicialeve. Me këtë është përmbyllur procesi i negociatave, kurse MSA tani gjendet në procedura të shqyrtimit dhe miratimit nga Shtetet Anëtare dhe institucionet e BE-së. Ky proces pritet të përfundojë kah mesi i vitit 2015, dhe MSA pritet të hyjë në fuqi nga janari 2015.

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015, përmes Vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.¹⁰⁷

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është marrëveshja e parë kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së dhe si e tille, MSA, paraqet një fazë të re të marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Si marrëveshje ndërkombëtare, ajo përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Për më tepër, MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. - See more at: <https://www.mei-ks.net/sq/msa#sthash.LX2o9BPL.dpuf>

- **Realizimi i Marrëveshjes të Brukselit**

Dialogu në Bruksel¹⁰⁸ në mes të dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian ka prodhuar rezultate të rëndësishme gjatë gati katër viteve. I filluar si një dialog teknik në vitin 2011, dialogu në Bruksel është avancuar në fushëveprim dhe rëndësi me qëllimin e normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve që nga vjeshta e vitit 2012. Unë besoj se qëllimet kryesore të këtij dialogu të tilla si përmirësimi i jetës së qytetarëve, vendosja e marrëdhënieve paqësore ndër fqinjësore midis të dy shteteve, duke siguruar integritimin evropian për të dyja vendet, si dhe duke ndihmuar forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon janë në rrugë të mirë për t'u arritur. Pas gati katër viteve të këtij procesi intensiv paqësorë, si dhe duke iu falënderuar lehtësimit konsekuent nga ana e BE-së dhe mbështetjes së plotë nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve me një të kaluar armiqësore janë duke u transformuar në një model evropian të bashkëpunimit. Në të njëjtën kohë, normalizimi i gjendjes në pjesën veriore të Kosovës po ecën përpara përmes procesit të integritimit të qytetarëve serbë në institucionet e Kosovës dhe shpërbërjes së strukturave paralele serbe, duke i dhënë fund përzierjes së Serbisë në punët e brendshme të Kosovës. Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, i zhvilluar midis të kryeministrave të të dyja shteteve dhe i lehtësuar nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për

¹⁰⁷ Po aty.

¹⁰⁸ UNMIK/Reg/2000/16 _Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë, 21 mars 2000.

Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë Catherine Ashton, që nga tetori i vitit 2012 rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve mes dy shteteve më 19 prill 2013. Në fakt, marrëveshjet e para të arritura dhe të nënshkruara ndonjëherë në mes të Kosovës dhe Serbisë rezultuan nga ky dialogu teknik dhe çështjet e zgjidhura përfshijnë: lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, tregtinë e lirë, menaxhimin e integruar të kufirit ndërshtetëror, eliminimin e pengesave për bashkëpunim rajonal, kthimin në Kosovë të dokumenteve kadastrale dhe të gjendjes civile të marra nga Serbia gjatë luftës, dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave universitare.¹⁰⁹ Dialogu teknik, ndërsa prodhoi marrëveshjet e para konkrete mbi çështjet e përmendura më lart, ai gjithashtu ndihmoi në hapjen e rrugës për bisedime politike mbi normalizimin e marrëdhënieve. Të dy dialogët, teknik dhe politik, janë ballafaquar me skepticizëm dhe refuzim të madh nga ana e qytetarëve. Për qytetarët e Kosovës nuk ishte e pranueshme që të bisedohet me ish-armikun, Serbinë, para kërkim faljes për gjenocid dhe para njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Ishte mjaft interesante se njerëzit kundërshtonin më shumë dialogun teknik se sa dialogun e normalizimit, ndoshta për shkak se ishte hera e parë që diskutohej me Serbinë pas pavarësisë së Kosovës dhe duke pasur parasysh se në dy proceset e mëparshme të paqes, në Rambuje dhe Vjenë,¹¹⁰ Serbia refuzoi marrëveshjet. Megjithatë, qëndrimi ynë si udhëheqje ishte i qartë se derisa e kaluara nuk mund të harrohet, ajo nuk duhet të jetë pengesë në rrugën tonë për të çuar përpara vizionin tonë për Kosovën si një shtet euro-atlantik. Ne mbesim të përkushtuar në vizionin tonë për Kosovën si një shtet sovran dhe i pavarur i bazuar në vlerat themelore të demokracisë, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut - një shtet i respektuar dhe i njohur ndërkombëtarisht dhe një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon - i realizuar mes tjerash përmes marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal.¹¹¹ Ne besojmë fuqimisht se reformat euro-atlantike në vazhdimësi të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës dhe një qasje shumë e matur dhe konstruktive në dialogun e Brukselit janë duke e sjellë Kosovën më afër BE-së, NATO-s, OKB-së dhe institucioneve të tjera të rëndësishme, derisa Kosova tashmë e ka parafuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE-në.¹¹² Duke qenë Kryenegociatore e Republikës së Kosovës në dialogun teknik me Serbinë për gati dy vjet, pastaj anëtare e Delegacionit të Republikës së Kosovës në Dialogun për Normalizim i kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi, për të vazhduar më tej si udhëheqëse e Delegacionit të Kosovës në Dialogun e Brukselit për zbatim, mund të them se kjo nuk ishte aspak një punë e lehtë, përkundër përvojës sime nga e kaluara, veçanërisht në Konferencën e Paqes së Rambujesë. Megjithatë, kam besuar se ishte gjëja e drejtë për të bërë. E dija se ky nuk ishte një mision i popullarizuar, por në thelb ishte mision paqësor dhe largpamës; prandaj unë isha e sigurt se kur të fillojë zbatimi konkret i marrëveshjeve, njerëzit ngadalë do të kuptojnë se kjo ishte për të mirën e tyre. Për më tepër, rezultatet e dialogut të Brukselit avancuan rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe integritit euro-atlantik dhe kjo është një trashëgimi tjetër që ne po e lëmë për gjeneratat e ardhshme të Kosovës. Këtë parathënie e kam shkruar si një përmbledhje e të gjithë procesit të dialogut të Brukselit sepse kam dashur të nxjerrë në pah rëndësinë unike të dialogut paqësor të Brukselit. Ky dialog është i rëndësishëm jo vetëm për perspektivat evropiane të dy shteteve dhe paqes dhe stabilitetit në rajon, por edhe për

¹⁰⁹ Po aty.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² UNMIK/Rreg/2000/01 _Mbi Strukturën e Përbashkët të Përkohshme Administrative të Kosovës_, 14 janar 2000.

përprjekjet e ardhshme të Bashkimit Evropian për paqe në rajon që duket se janë të domosdoshme në angazhimet për përshejtimin e integritetit evropian për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Po e shfrytëzoj këtë rast që të shprehë vlerësimet e mia të larta për përprjekjet e jashtëzakonshme të PL-së Catherine Ashton e cila pati sukses që ti hap rrugë marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes Kosovës dhe Serbisë. Falënderimi im i veçantë i shkon të gjithë ekipit të saj të cilët punuan palodhshëm dhe me durim dhe do të punojnë për këtë projekt të rëndësishëm të paqes. Dua ta theksoj angazhimin e shquar të Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha institucioneve të tjera të Kosovës, kryeministrin Hashim Thaçi dhe të gjithë kolegët e mi ministra për misionin sfidues në dialogun e Brukselit. Mirënjohja ime e veçantë shkon për të gjithë ekipin tim që ka qenë i përkushtuar dhe kompetent në gjithë punën e bërë gjatë këtyre viteve në Dialogun e Brukselit. Si përfundim më lejoni të them se Marrëveshja për Normalizimin e marrëdhënieve është një hap historik për arsye të rëndësishme që ka dhe të cilën u përpoqa ta elaboroj shkurtimisht më lartë. Megjithatë, unë besoj fuqishëm se marrëveshja e vërtetë historike do të jetë ajo që do të përfundojë me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, përkatësisht njohjen e realitetit të ri politik në Ballkan pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë dhe lindjes së shtatë shteteve të reja.¹¹³

- **Roli i diplomacisë perëndimore në biseda**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës,¹¹⁴ Serbia në vazhdimësi është angazhuar në mënyrë aktive për të penguar forcimin e brendshëm dhe konsolidimin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një angazhim i tillë ishte edhe përprjekja e saj për kontestim të shpalljes së pavarësisë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, gjë e cila u hodh poshtë. Megjithatë, opinionin e GjND-së hapi rrugë për nisjen e një procesi të ri të dialogimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që për qëllim kishte zgjidhjen e kontesteve bilaterale, gjë që do të qonte në normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Qëllim i këtij punimi është të vlerësojë nëse dialogu me Serbinë i ka arritur objektivat e tij për shtrirjen e sovranitetit në të gjithë territorin e tij, forcimin e shtetësisë në arenën ndërkombëtare, si dhe integritetin e komunitetit serb në institucionet dhe jetën shoqërore të Kosovës. Poashtu, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe opinionit publik, ky punim ofron një sërë rekomandimesh për spektrin politik se si të veprohet më tutje. I gjithë procesi i dialogut ka qenë i mbyllur duke e dëmtuar kështu kredibilitetin e tij.¹¹⁵ Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies kanë ndikuar edhe në zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Në të njëjtën kohë, për shkak të mungesë së informacionit lidhur me rrjedhën e procesit, pakënaqësitë dhe kundërshtimet ndaj dialogut janë rritur me kalimin e kohës. Për më tepër, shtatë vite nga fillimi i dialogut, progresi i shënuar në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është i vogël. Janë arritur një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve, por zbatimi i tyre ka qenë jo i kënaqshëm. Arsyet e moszbatimit të marrëveshjeve kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga mungesa e vullnetit politik, e deri te konflikti i përmbajtjes së tyre me rendin kushtetues e juridik të Republikës së Kosovës. Në të njëjtën kohë, Serbia ka vazhduar të llobojë dhe pengojë konsolidimin e Kosovës në

¹¹³ Nations peacekeeping operations, S/2001/394, 20 prill 2001. UNMIK Rreg/2001/9, „Constitutional Framework for Provisional Self-Government in Kosovo“, 15 maj 2001.

¹¹⁴ UNMIK, „Standards for Kosovo“, Pristina, 10 dhjetor 2003. Qasur në <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B6BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf> (26 korrik 2016).

¹¹⁵ Po aty.

arenën ndërkombëtare. Pavarësisht kësaj, dialogu me Serbinë tashmë është duke hyrë në fazën përfundimtare të tij. Shumë gjëra janë ende të paqarta, duke filluar nga përfaqësimi, formati, temat që do të diskutohen apo edhe epilogu i dialogut. Megjithatë, Bashkimi European e ka bërë të qartë se në një afat të shkurtër kohorë, pret arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme ndërmjet palëve, në mënyrë që tu hapet rrugë për avancim drejt anëtarësimit në BE.¹¹⁶

Rezoluta e OKB-së i dha fillësë procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe më 10 mars 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Rezolutën përmes së cilës mbështeste “dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin”.⁵ Kjo Rezolutë gjithashtu e obligoi Qeverinë e Kosovës që t’ia paraqiste Kuvendit dokumentin themelor për dialogun brenda afateve ligjore dhe rikonfirmoi të drejtën e Kuvendit për të ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare.⁶ Takimi i parë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u mbajtë me 9 mars 2011 në të cilin Republika e Kosovës përfaqësohej nga znj. Edita Tahiri, zëvendës kryeministre dhe ministre për dialogun në qeverinë e atëhershme të Republikës së Kosovës, ndërsa delegacioni serb udhëhiqej nga z.Borko Stefanovic. Edhe kjo Rezolutë thekson që marrëveshjet duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm rendin unik kushtetues të Kosovës.¹⁰ Më 19 tetor 2012, z. Hashim Thaçi në cilësinë e Kryeministrit të Kosovës u takua në Bruksel me Kryeministrin e Serbisë z. Ivica Daçiç. Kështu dhe filloi dialogu politik i cili u quajt dialogu për normalizim, i udhëhequr nga krerët e ekzekutivit të të dyjave shteteve dhe i lehtësuar nga BE. Deklarata e lëshuar nga znj. Ashton, pas takimit të parë, nuk ofroi shumë detaje por vetëm u tha se takimi ishte mbajtur në frymë të mirë dhe konstruktive. Pas 10 roundesh të takimeve në mes kryeministrave, më 19 prill 2013 znj. Ashton në një deklaratë njoftoi se të dy kryeministrat ishin dakorduar mbi tekstin e marrëveshjes së parë mbi parimet e përgjithshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e njohur ndryshe edhe si ‘marrëveshja e Brukselit’.¹¹⁷ Ajo i uroi kryeministrat për kurajon e tyre duke e konsideruar këtë të arritur si një hap më afër Evropës. Edhe Presidenti i Këshillit Evropian i asaj kohe z. Herman Van Rompuy uroi të dy kryeministrat duke e konsideruar këtë marrëveshje si historike dhe duke rikonfirmuar perspektivën evropiane për të dy vendet. Një ditë më pas, pas kthimit nga Brukseli, Kryeministri Thaçi mbajti një konferencë për medie në të cilën deklaroi se të gjitha palët kishin fituar dhe se me këtë marrëveshje do të normalizohej veriu, si dhe do të shtrihej sistemi kushtetues dhe ligjor i Kosovës në tërë vendin. Thaçi poashtu siguroi se kjo marrëveshje ishte në përputhje të plotë me kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e vendit. Ndërsa për asociacionin e komunave me shumicë serbe tha se do të kishte të njëjtat kompetenca si asociacioni aktual i komunave në Kosovë.¹¹⁸ Ai e përmbylli adresimin e tij duke shtuar se Kosova po hynte në epokën e normalitetit. Në fakt këto pritshmëri të pritura nga procesi i dialogut nuk arritën të përmbusheshin as pas 7 vite negociatash. Më 22 prill 2013, Kuvendi i Kosovës kaloi një Rezolutë me anë të së cilës shprehu pëlqimin dhe përkrahjen për nënshkrimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë

¹¹⁶ Po aty.

¹¹⁷ Po aty.

¹¹⁸ Po aty.

normalizimin e marrëdhënieve, si dhe mbështetjen për zotimet e dala nga kjo marrëveshje.

- **Liberalizmi i vizave: një premtim i parealizuar**

Pas një bllokade disa vjeçare, Kosova po bën hapa të rëndësishëm drejt marrëveshjes për liberalizim të vizave me Bashkimin Evropian ¹¹⁹(BE). Liberalizimi i vizave është bërë prioritet kryesor për politikën dhe qytetarët e vendit. Këtë pranverë, Parlamenti ratifikoi marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe BE-ja dërgoi një mision ekspertësh për të vlerësuar përparimin e bërë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Komisioni së shpejti pritet të dalë me një qëndrim për të rikonfirmuar propozimin e mëhershëm pozitiv. Megjithatë, ekziston një procedurë e gjatë dhe një proces politik kompleks i vendim-marrjes në BE derisa kosovarëve t'iu lejohet udhëtimi pa viza në vendet e zonës Shengen. Në vitin 2016, Kosova humbi mundësinë për t'iu bashkuar Ukrainës dhe Gjeorgjisë në rrugëtimin drejt liberalizimit të vizave, shtete këto që ia arritën qëllimit në mars dhe qershor 2017 - respektivisht. Qeveria filloi dialogun për viza në vitin 2012, dhe deri më 2016 zbatoi 93 prej 95 kritereve të paracaktuara. Në maj të vitit 2016, Komisioni Evropian miratoi raportin e katërt dhe të fundit, i cili rekomandoi liberalizimin e vizave për Kosovën me kushtin e implementimit të dy kritereve të mbetura, ratifikimin emarrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe krijimin e një regjistri të hetimeve dhe vendimeve përfundimtare gjyqësore, dhe konfiskimeve në rastet e profilit të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Raporti vuri në dukje se Kosova kishte "përmbushur të dhjetë kriteret" në fushën e menaxhimit të migracionit. Parlamenti i Kosovës arriti të ratifikojë marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi në mars 2018, pas gati tri vitesh vonesë, duke shënuar kështu fundin e një prej çështjeve më kontraktore.¹²⁰ Marrëveshja kufitare u nënshkrua në gusht të 2015-ës. Vëmendja menjëherë u zhvendos tek kriteri i mbetur - lufta kundër korrupsionit. Për dallim nga kriteri i parë që kërkonte votimin e Parlamentit të Kosovës, ky i fundit kërkon miratimin e burokratëve dhe politikanëve të BE-së në institucionet përkatëse. Procesi është kompleks dhe nuk ka datë të saktë kur mund të përfundoj, shumëçka do të varet nga rrethanat politike brenda BE-së dhe shteteve anëtare. Gjykatat e Kosovës kanë bërë progres në përmbylljen e 43 rasteve në regjistr.

Ish-qeveria e Madridit bëri maksimumin për të dëmtuar Kosovën dhe Samitin e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Sofje. Disa sugjerojnë se Madridi mund të kërkojë largimin e Spanjës nga lista e vendeve të Shengenit, zonë ku bartësit e pasaportave të Kosovës mund të udhëtojnë. Burokratët e BE-së këmbëngulin se kjo është e pamundur dhe e panevojshme. Kosova duhet të jetë e gatshme të udhëheqë një fushatë informuese mbi obligimet e udhëtimit pa viza, të ndërmarrë veprime për forcimin e kontrollit të kufirit dhe të marrë masa lidhur me procesin e ripranimit. Procesi i vendim-marrjes në Bashkimin Evropian, shpeshherë është i paqartë, kompleks dhe i lodhshëm. Vendim-marrja për liberalizmin e vizave kërkon përfshirjen e tri institucioneve të BE-së: Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Ministrave. Komisioni i propozon Parlamentit dhe Këshillit ndryshimin e Rregullores 539/2001 e cila liston

¹¹⁹ Reeve, Andrew dhe Alan Ware, *Electoral Systems: A comparative and theoretical introduction* (Routledge, 2011).

¹²⁰ Po aty.

shtetet, qytetarët e të cilave janë të obliguar të posedojnë vizë në rast të udhëtimit drejt vendeve të BE-së, dhe shtetet, qytetarët e të cilave janë të liruara nga ky obligim. Në maj të vitit 2016, Komisioni kishte propozuar heqjen e vizave pasi Kosova të ketë përmbushur edhe dy kushte të tjera. Kosova arriti të zbatojë përmbushjen e kushteve vetëm dy vite më vonë. Me këtë rast, në fillim të muajit maj 2018, BE-ja dërgoi një grup ekspertësh për të vlerësuar progresin e institucioneve të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Bazuar në raportin e grupit vlerësues, Komisioni planifikon të ri-përtërijë propozimin në fund të qershorit ose në fillim të korrikut 2018. Komisioni më pas i dërgon Parlamentit dhe Këshillit propozimin për ndryshim të rregullores. Shqyrtimi bëhet fillimisht nga Parlamenti.¹²¹ Procesi i shqyrtimit të propozimit të Komisionit brenda Parlamentit Evropian përfshinë Komisionin për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (LIBE) dhe Komisionin për Çështje të Jashtme (AFET). LIBE emëron një raportues për përgatitjen e një raporti që pritet të mbështesë propozimin e Komisionit, që në rastin e Kosovës është Tanja Fajon. Sipas procedurës, AFET zakonisht jep opinion për këtë çështje. Mirëpo, në rastin e Kosovës, AFET opinionin e ka dhënë në korrik të vitit 2017. Pas diskutimeve fillestare, me shumicën e thjeshtë të votave LIBE miraton raportin për ndryshim të rregullores 539/2001. Në të njëjtën kohë, LIBE miraton pozicionin e saj për të hyrë në negociata ndër-institucionale me Komisionin dhe Këshillin. Konsultimet paraprahe me Grupet Parlamentare mundësojnë miratim në heshtje nga ana e Parlamentit Evropian, në këtë fazë të procedurës.¹²² Procesi në Parlament është më i thjeshtë. Në Këshill, ku kërkohet miratimi i Ministrave të shteteve anëtare për të vazhduar, procesi mund të ketë sukses apo të ngecë. Këshilli fillon punën e tij përgatitore pas marrjes së propozimit nga Komisioni Evropian.¹²³ Grupi Punues për Vizat shqyrton propozimin brenda Këshillit. Ndërsa, Grupi Punues për Rajonin e Ballkanit Perëndimor - COWEB jo-zyrtarisht mund të testojë disponimin për përkrahjen e rastit të Kosovës. Ekspertët e COWEB përfshihen në dosjen legjislativë. Pas shqyrtimit në grupin punues, propozimi kalon tek Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm – COREPER, i përbërë nga përfaqësuesit e lartë diplomatik, ku miratohet pozicioni negociues i Këshillit. Megjithatë nuk ka kërkesa formale për mandatin e negociatave në nivelin e COREPER apo të Këshillit, pozicioni përgjithësisht miratohet nga COREPER, me shumicë të kualifikuar, edhe pse praktikisht nuk votohet. Zakonisht, COREPER kërkon konsensus para miratimit. Sidoqoftë, përpara se të miratojnë qëndrimin e tyre për të hyrë në negociata ndër-institucionale, Këshilli mund të kërkojë sqarime shtesë, gjë e cila mund të ngadalëson procesin. Këshilli ka takime të planifikuara në tetor dhe dhjetor 2018. Sipas praktikës standarde, bashkë-ligjvënësit në secilën fazë të procesit përpiqen të dakordohen rreth tekstit për secilin lexim, dhe kështu të përfundojnë procedurën. Marrëveshjet e tilla shpeshherë arrihen gjatë negociatave ndër-institucionale (të ashtuquajtura trilogje) që përfshijnë tri institucionet evropiane. Qëllimi i këtyre takimeve dhe konsultimeve joformale është arritja e një marrëveshjeje rreth një pakoje të pranueshme sikurse për Këshillin ashtu edhe për Parlamentin. Pas përfundimit të negociatave, Parlamenti voton propozimin për ndryshimin e Rregullores 539/2001, duke e zhvendosur Kosovën nga lista e vendeve të treta që kanë nevojë të marrin viza, në subjekt të liruar nga regjimi i vizave. Pas votimit në Parlament, Këshilli

¹²¹ Po aty.

¹²² Po aty.

¹²³ Po aty.

pastaj mund të vendosë të pranojë qëndrimin e Parlamentit, përmes votim me shumicë të kualifikuar, formë e cila aplikohet për votimin e procedurave të zakonshme legislative të Këshillit. Akti ligjor i miratuar më pastaj nënshkruhet nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Parlamentit dhe Presidenti i Këshillit. Pas nënshkrimit, Kosova do të lëvizë në shtojcën e subjekteve pa viza dhe autoritete territoriale që nuk njihen si shtete nga të paktën një shtet anëtar i BE-së, duke lejuar udhëtimin pa viza për qytetarët e territorit të Kosovës të cilët posedojnë pasaportë biometrike, për një periudhë qëndrimi prej 90 ditësh, në çdo periudhë 180 ditore. Akti ligjor hyn në fuqi 20 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare. Është vështirë të parashikohet sa do të zgjasë i gjithë procesi; potencialisht mund të përfundojë deri në fund të vitit nëse vendimmarrja në Këshill kalon pa probleme. Megjithatë, periudha kohore e gjithë procesit ndryshon për vende të ndryshme. Në rastin e Moldavisë, procesi ka zgjatur rreth pesë muaj, Gjeorgjisë dymbëdhjetë muaj dhe Ukrainës trembëdhjetë muaj. Gjenerali më poshtë grafikonin që shpjegon sistemin e votimit në Këshillin e Ministrave dhe kornizën krahasuese të procesit për liberalizimin e vizave për Kosovën, Gjeorgjinë dhe Ukrainën.¹²⁴

- **Bashkëpunimi me SHBA**

Shtetet e Bashkuara¹²⁵ së pari hapën Zyrën e Shërbimit Informativ të Shteteve të Bashkuara në Kosovë në vitin 1996. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2008, Zyra e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë ka vepruar në cilësi të misionit diplomatik të Shteteve të Bashkuara në Kosovë. Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Shtetet e Bashkuara vendosën zyrtarisht marrëdhëniet diplomatike me Kosovën dhe Zyrën u bë Ambasada. Në shtator të vitit 2012, Shtetet e Bashkuara iu bashkuan partnerëve në Grupin Drejtues Ndërkombëtar në njohjen e progresit enorm që kishte arritur Kosova, duke përfshirë mbështetjen e zotimeve të saj për zbatimin e dispozitave që përmban plani i të dërguarit të posaçëm Ahtisaari dhe mishërimin e këtyre në ligjet e Kosovës, duke deklaruar kështu fundin e pavarësisë së mbikëqyrur dhe shpërbërjen e Zyrës Civile Ndërkombëtare.¹²⁶

Që nga viti 1999, Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar me trupa në Forcën e Kosovës (KFOR) të prirë nga NATO, e ngarkuar me ruajtjen e një mjedisi të qetë dhe të sigurt dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës. Shtetet e Bashkuara gjithashtu kontribuuan me staf për Misionin e BE-së për Sundim të së Drejtës (EULEX) që nga vendosja e tij më 2008, duke shënuar herën e parë që Shtetet e Bashkuara morën pjesë në një mision të BE-së për Politikën e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje.

Që nga viti 1999, qeveria e SHBA-ve ka investuar në Kosovë rreth \$2 miliardë, dhe më 4 korrik 2019 përuroi dhe më vonë u zhvendos në ndërtesën shumëmilionëshe të Ambasadës, të ndërtuar rishtas, e vendosur në 12.4 hektarë, në lagjen Arberi të Prishtinës, e rrethuar nga një miks i ndërtesave duke filluar nga lartësia, materialet dhe përdorimet.

Ndërtesa e Ambasadës Amerikane jo vetëm që paraqet platformën diplomatike të Qeverisë së Sh.B.A-së, por edhe përmirëson misionin e saj duke siguruar një shembull të sigurt, të qëndrueshëm dhe teknologjikisht të përparuar të arkitekturës, inxhinierisë dhe dizajnit urban.

¹²⁴ Po aty.

¹²⁵ Weller, Marc, *The Kosovo conflict* (Cambridge: Documents and Analysis Publishing, 2001).

¹²⁶ Zaum, Dominik, *Sovereignty Paradox: Norms and the Politics of International Statebuilding* (Oxford, New York: Oxford University Press, 2007).

KAPITULLI III

EU, Amerika dhe Maqedonia e Veriut

- Analiza teorike e problemit

Marrëveshja paqësore e Ohrit¹²⁷ dhe amendamentet kushtetuese në masë të konsiderueshme e ndryshuan kornizën demokratike të sistemit të mëparshëm të vendit tonë. Tanimë është hequr dorë nga e ashtuquajtura demokraci Vesministere e vendosur me kushtetutën e vitit 1991, e cila në fakt e favorizonte shumicën. Si pasojë e konfliktit luftarak të vitit 2001 dhe nën presion të bashkësisë ndërkombëtare, u rivendos modeli i cili në teorinë politike përcaktohet si "shkëmbimi i pushtetit" (power-sharing), i cili në fakt duhet të krijojë paqe ndëretnike, më tepër stabilitet dhe siguri në vend. Vallë, a e dha provimin e yij ky model në këto vite dhe çka mund të pritet në të ardhmen? Në dhjetë vitet e fundit, madje edhe më gjatë, ndodhitë në rajon dhe në vendin tonë u zhvilluan me një dinamikë me shpejtësi të paparë. Teoria shoqërore te ne nuk arriti ta mbajë hapin me kohën, andaj dështoi plotësisht në sqarimin e fenomeneve.¹²⁸ Përkaj arsimimit të dobët, pjesa më e madhe e fajit ishte për shkak të euforisë nacionaliste e cila e kaploi regjionin duke nxitur në disa pika edhe pasoja tragjike. Te ne as Universiteti, si një mjedis që duhej të hapëronte me objektivitet dhe paanshmëri, nuk arriti që të ndërtohej jashtë politikës së nacionalizmit e cila dominonte në të kaluarën. Kështu, numri më i madh i intelektualëve të Universitetit e favorizonte modelin "e shoqërisë qytetare", në të cilën të gjithë janë të barabartë dhe në të cilën nuk ka vend për të drejtat kolektive dhe të drejtat e pakicave, si dhe për kurrfarë aranzhmanesh, përveç për demokracinë e shumicës. Në të vërtetë rreth këtij modeli u tubuan të gjitha forcat intelektuale politike të cilat synonin ruajtjen status quo-së, respektivisht mbajtjen e sistemit ekzistues të diskriminimit. Si kundrohet në teorinë politike i ashtuquajturit sistemi "i shkëmbimit të pushtetit" (power-sharing) dhe a është zbatuar ai në mesin tonë?¹²⁹ A shfaq ai përparësi ndaj modelit të shumicës? "Shkëmbimi i pushtetit" ose sistemi power-sharing definohet si praktikë në të cilën institucionet rezultojnë me koalicionet qeveritare të zgjeruara të cilat marrë në përgjithësi janë inkluzive për të gjitha grupet më të mëdha etnike në shoqëri. Ky është sistem që duhet t'i promovojë parimet të cilat shpesh edhe kundërshtohen, siç është e drejta vetëvendosjes nacionale, nga njëra anë, dhe demokracia e cila e vë theksin në të drejtat dhe liritë

¹²⁷ Intervistë me z. Artan Mustafa, politolog dhe gazetar, 5 prill 2016.

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Po aty.

individuale dhe kolektive, nga ana tjetër.¹³⁰ Thënë ndryshe, shtetet jodemokratike mbrohen nga orvatjet nga secesioni me metoda të dhunshme, ndërsa demokracitë nuk e kanë një mbrojtje të tillë. Atje vërtet është problem i madh që të respektohen parimet demokratike dhe në të njëjtën kohë të pamundësohet secesioni. Profesori amerikan nga Harvardi që njëherazi është edhe senator,¹³¹ Patrik Mojnien, në "Pandemonium ose etnicitetet në politikën ndërkombëtare" duke shkruar për se e drejta vetëvendosjes deri në ndarje ka kufij në politikën ndërkombëtare. Kjo në esencë është e përkufizuar një parim të rëndësishëm për mosndryshimin e kufijve me forcë. Këtë botëkuptim e vërteton praktika në marrëdhëniet ndërkombëtare. Edhe përkaj proklimit të shteteve të reja të pavarura të cilat u krijuan pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, është më se e besueshme se të drejtën për vetëvendosje deri në ndarje nuk do ta realizojë secili grup etnik¹³². Sa i përket Ballkanit, nga seria e luftërave brutale qytetare dhe e intervenimeve të tjera, SHBA-të dhe UE janë të kujdesshme kur bëhet fjalë për të drejtën e vetëvendosjes dhe qëndrojnë në parimin e mosndryshueshmërisë së kufijve me forcë. Si "lojtarë" të rëndësishëm ndërkombëtarë, ata ndaj konflikteve të dhunshme etnike në shoqëritë të cilat janë etnikisht të ndara (Bosnja, Kosova, Maqedonia), përgjigjen me modelin e "shkëmbimit të pushtetit". Nuk do të ishte asgjë e re nëse thuhet se demokracia është proces i vështirë në shoqëritë e ndara etnike. Si të sigurohet lojaliteti te të gjitha grupet që jetojnë në vend në momentet e shpërndarjes së shteteve të ndërlukuara dhe kur ndodh formimi i shteteve më të vogla nacionale?¹³³ Si të sigurohet legjitimiteti i sistemit dhe njëherazi edhe efikasiteti i tij? Liritë politike, ashtu siç ndodhi në hapësirat e Jugosllavisë së dikurshme, në vend të demokracisë dhe tolerancës mund të krijojnë nacionalizëm dhe dezintegrim. Ky proces nuk ndalet vetëm në kufijtë e shteteve nacionale, por ka prirje të shpërndahet edhe te fqinjët, sepse kufijtë shtetërorë, veçmas në Ballkan, nuk i ndjekin "kufijtë" etnikë. Ai në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX e ndezi mbarë regionin. Për fat të mirë, atëherë Maqedonia iu shmang konfliktit etnik. Ai u paraqit më vonë kur nacionalizmi në Ballkan tani në masë të madhe ishte në rënie. Në vitin 1999 intervenimi i NATO-s në Kosovë kishte një efekt të rëndësishëm. Për shkak të sigurisë së dobët në kufirin ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës konflikti u shpërnda edhe në Maqedoni. Kësaj duhet t'ia shtojmë edhe pakënaqësinë e bashkësisë nacionale shqiptare në Maqedoni, përfaqësuesit politiko-kë të së cilës në Prizren i dhanë legjitimitet rezistencës së armatosur (UÇK-së), duke e nënshkruar Deklaratën e Prizrenit. Demokracia ekskluzive e shumicës u ndryshua me aranzhmane politike të reja kushtetuese të quajtura shkëmbim i pushtetit, që u vendos me 13 gusht në Ohër, ndërsa u implementua përmes procedurës së amendamenteve. Kështu u hap një faqe e re e historisë politike kushtetuese të vendit. Njëzet vjet para se të gufonin konfliktet e përgjakshme etnike në Ballkan, politologu amerikan Liphard në librin "Demokracia në shoqëritë plurale" shkruante se demokracia e shumicës në shoqëritë e ndara etnike jo vetëm që është jo e drejtë, por edhe rrezikshme, sepse në të çdoherë përjashtohen grupet më të vogla etnike që të kenë qasje në pushtet. Liphardi, si amerikan me prejardhje holandeze, ishte i inspiruar nga konfliktet

¹³⁰ Po aty.

¹³¹ Smirnov-Brkiq, Aleksandra. *Istoria 5*. Beograd: Zavod za udžbenike, 2011.

¹³² Schmitt, Carl, *The Concept of the Political* (University of Chicago Press, Expanded edition, 2007).

¹³³ *Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* (2013), Vol.41, Issue 6, 953-970

e katolikëve dhe protestantëve në atdheun tij të lindjes në Holandë, si dhe nga historia e luftës dhe paqes në Belgjikë dhe Zvicër. Ai i studioi sistemet politike të këtyre vendeve dhe mënyrat se si u ballafaquan ato me konfliktet religjioze dhe me ndërtimin e modelit konsicional ose të demokracisë me marrëveshje (kontraktuar). Modeli "i shkëmbimit të pushtetit", të cilin e kemi edhe ne sot, në masë të madhe mbështetet në modelin e krijuar nga Liphardi. Kuptohet, ky model nuk është ilaç i çudirave (panacea) për çdo situatë. Megjithatë është pranuar ideja e tij nismëtare se është jodemokratike, madje edhe rrezik, që bashkësitë e pakicave etnike çdoherë të jenë të përjashtuara nga pjesëmarrja e tyre në instrumentet e pushtetit. Për këtë Liphardi si shembull i propozon disa elemente të demokracisë konsicionale të cilat e kufizojnë sundimin e shumicës: 1. Koalicioni i zgjeruar ose multi-etnik që parasheh që të gjitha partitë politike relevante ta ndajnë pushtetin; 2. Përfaqësimi proporcional, respektivisht modeli proporcional zgjedhor; 3. Raporti më i balancuar ndërmjet trupit të ekzekutivit dhe legjislativit. 4. Vetoja për pakicat në lidhje me çështje të caktuara që kanë të bëjnë me identitetin, kulturën dhe arsimin e pakicave etj. Autorë të tjerë të njohur në këtë lëmi, si për shembull D. Horovic, po ashtu mendojnë se sundimi i shumicës në shoqëritë multi-etnike duhet të jets i kufizuar që mos të nxiten konflikte etnike. Ai si shembull i propozon disa instrumente politike për reduktimin e konfliktit etnik, si: kryesia lëvizëse; formimi i koalicionit të zgjeruar; sistemi proporcional zgjedhor i cili shkon në drejtim të një politike më të matur; krijimi i koalicioneve të cilat në paraqitjet e tyre para votuesit me përkatësi të ndryshme etnike janë më të matur në politikën e tyre; kushtëzimi i koalicioneve me votat e zgjedhësve, si dhe përkushtimi i tyre për ndërtimin e shoqërisë multi-etnike; sjellja e preferencave politike, si për shembull, kuotat, përfaqësimi i drejtë i bashkësive në organet e pushtetit etj. Përsëri kësaj, propozohet të përforcohen të gjitha ato interesa specifike që i kanë grupet në shtetin e përbashkët si: mirëqenia, prosperiteti ekonomik, kultivimi i veçorive nacionale, kujdesi shtesë i shtetit për zhvillim më të shpejtë të këtyre territoreve etj. Nëse analizohet sistemi "i shkëmbimit të ndikimit" të cilin e fituam me Marrëveshjen paqësore të Ohrit dhe me amendamentet kushtetuese, lirisht mund të konstatojmë se në masë të madhe janë aprovuar parimet, institucionet dhe politikat të cilat i propozonin Liphardi dhe Horovici. Tanimë ekziston shembulli tradicional si pëlqim joformal, se Qeveritë në Maqedoni janë politike, por edhe me koalicione etnike; sistemi partiak është multipartiak dhe multidimensional; sistemi zgjedhor i shumicës dhe i kombinuar (i shumicës dhe proporcional) tanimë ka kaluar në përfaqësimin e pastër proporcional (përfshirë bëjnë prefektet e komunave të cilët zgjidhen sipas sistemit zgjedhor të shumicës); ekziston e drejta për veton e pakicave në Kuvendin e Maqedonisë, si dhe këshillat e komunave; pushteti është i shpërndarë; në vijim e sipër është edhe procesi për decentralizimin e tij me të cilin do të vendoset ndikim më i madh i bashkësisë etnike shqiptare; udhëhiqen politika preferenciale për përfaqësim të drejtë të bashkësive në administratë, ushtri, polici, gjyqësi etj.; janë formuar fakultete në gjuhën shqipe, janë miratuar kuota për qasje më të drejtë në shkollimin sipëror për pakicat në gjuhën maqedonase; atje ku është e koncentruar popullata e bashkësive etnike që janë pakicë ekziston politika për zhvillimin e komunave më pak të zhvilluara, edhe pse ndoshta jo mjaft efikase, etj. Kuptohet, ky nuk është proces i kryer, por drejtimi është i mirë. Vallë këto parime dhe politika mbi të cilat bazohet sistemi ynë politik i shkëmbimit të pushtetit a prodhuan më tepër stabilitet dhe siguri? Krijohet përshtypje se është ashtu. Viteve të fundit nuk kishte ndonjë krizë

më të madhe në baza ndëretnike. Madje, edhe referendumi që e kundërshtonte ndikimin më të madh të bashkësisë etnike shqiptare në nivelin lokal, përfundoi pa sukses.¹³⁴

- **Autorë të ndryshëm për Diplomacinë me Maqedoninë e veriut**

Prania, presioni, aktiviteti diplomatik e mekanizma të tjera të bashkësisë ndërkombëtare si duket kishin rol vendimtar. Historia nga e kaluara tregon se shtetet ballkanike kanë lidhur shumë marrëveshje të ndërsjella, por asnjërën nuk e kanë respektuar. Vetëm forca më e madhe se forca e tyre ka mundur t'i detyrojë këto kombe t'i respektojnë marrëveshjet e ndërsjella. Sot kjo gjendje është ndryshuar në drejtim pozitiv. Intervenimet e NATO-s në Ballkan (Bosnjë, Kosovë, Maqedoni), si dhe iniciativat e UE-së krijuan kushte për paqe dhe zhvillim të marrëdhënieve ndërfqinjësore. Angazhimi afatgjatë i bashkësisë ndërkombëtare edhe më tutje do jetë kusht për suksesin e projekteve për "Shkëmbimin e pushtetit", siç është ai në Maqedoni. 2. Njëra ndër kritikantet themelore e cila i drejtohet modelit konsocional është se ai redukton tejmasë demokracinë duke u mbështetur vetëm në marrëveshjet në mes elitave. Vallë, çka nëse haptas ose në vazhdimësi elitat nuk dëshirojnë kompromis ose marrëveshje? Çka nëse ato në vazhdimësi punojnë në shkatërrimin e shtetit? Si ky model, nga marrëveshja në mes elitave, të bëhet projekt për të gjithë qytetarët e vendit? Politika në këto 3-4 vite i dha disa përgjigje. Nëse elitat politike janë të matura në veprimet dhe paraqitjet e tyre, ky projekt ka gjasa të bëhet projekt i të gjithë qytetarëve në vend. Në të kundërtën nuk është i mundur, sepse vet modeli në vetvete e ka ndërtuar krizën dhe vendimet për kriza. Si ashtu? 3. Modeli i "shkëmbimit të pushtetit", i cili buroi nga kriza luftarake dhe marrëveshja paqësore me çka përfundoi konflikti luftarak, në fakt e pranoi ndarjen e shoqërisë në baza të vijave etnike. Në të njëjtën kohë bëhen orvatje që me modelin e ri të tejkalohet ndarja etnike. Modeli "i shkëmbimit të pushtetit" përmban në vete elemente si të dezintegritimit, ashtu edhe të integritimit. Gjithë kjo varet nga maturia e qytetarëve dhe politikanëve, si dhe nga vendosmëria se jeta e përbashkët është e mundur me vendime të dëshiruara. Për shembull, e drejta e vetos, e cila është paraparë haptazi me kushtetutë jo vetëm për çështjet e zhvillimit kulturor dhe për identitetin e bashkësive etnike, por edhe për çështjet territoriale, si për shembull për kufijtë e komunave etj. Kjo është e drejtë e cila mund të keqpërdoret dhe të nxisë bllokada në procesin e vendosjes, me këtë edhe krizë, si në nivel nacional, ashtu edhe në nivel komunal, ku tani këtë të drejtë e kanë bashkësitë që mbetën pakicë. Rreziku qëndron në atë se vetoja e pakicës mund të keqpërdoret nëse përdoret shpesh edhe si instrument për realizimin e ndonjë politike nacionale. Në anën tjetër është e mundur që shumica haptazi ose heshtazi t'i injorojë nevojat e pakicave dhe me këtë ta pengojë procesin e integritetit të tyre në shoqëri, veçmas për atë se shumica llogarit se modeli "i shkëmbimit të pushtetit" është imponuar me forcë. Keqpërdorimi i vetos nga ana e pakicës dhe opstruksioni ndaj reformave nga shumica, mund të sjellë deri te bllokimi i sistemit të vendosjes dhe deri te krizat e vazhdueshme të mundimshme të cilat do ta kthejnë vendin prapa. Për fat të keq, demokracia në vetvete e ka edhe dobësinë të cilën mund ta shlyejnë atë: në zgjedhje, nëse në pushtet vijnë partitë politike dhe liderët të cilët janë të pamatur dhe ekstrem në

¹³⁴ Baldini, Gianfranco dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009).

sigurinë e interesave nacionale të shumicës; politika në atë rast nuk është asgjë tjetër, përveçse rrugë drejt pushtetit që të sendërtohet një qëllimi i tillë; partitë politike dhe liderët e tyre nuk përmbahen edhe nga keqpërdorimi i ndjenjave nacionale të qytetarëve, siç treguan edhe zgjedhjet e fundit lokale. Për fat, forca e nacionalizmit sot është dobësuar dhe asnjëra nga rrethanat ndërkombëtare nuk shkon në llogari të tij. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen të jenë dy hapa përpara e një prapa dhe anasjelltas, nga çka varet tempoja me të cilën ky vend do të inkuadrohet në një familje më të gjerë europiane të shteteve e të popujve. Do të ishte mirë për të gjithë të orvateshim që të kemi sa më pak hapa prapa.¹³⁵

- **Pak histori: qasja e Bashkimit Evropian dhe SHBA ndaj Maqedonisë së Veriut**

Hulumtimet në temën afrimi i Maqedonisë në NATO e kanë rëndësinë e tyre teorike shkencore për formimin e qëndrimit shkencor për arsyetimin e proceseve integruese euroatlantike, të cilat e çojnë vendin në anëtarësimin e plotë në NATO. Në këtë punim janë hulumtuar mundësitë për afrimin e Maqedonisë në NATO, me theks të posaçëm në implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit duke i respektuar normat, vlerat dhe standardet të cilat në masë të madhe e stimulojnë stabilitetin e brendshëm politik dhe ekonomik dhe po aq nxisin projekte për bashkëpunim regional.¹³⁶ Në parashtrimin e këtij fenomeni shoqëror janë marrë në konsideratë botëkuptimet bashkëkohore për politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, proceset demokratike dhe respektimi i të drejtave të njeriut, bashkëpunimi regional dhe stabiliteti i qëndrueshëm i brendshëm dhe regional, si dhe botëkuptimet e qarta për integrimet euroatlantike si projekt real për integrimin e Maqedonisë në NATO.¹³⁷ Është fakt se në proceset integruese euroatlantike janë të pranishme marrëdhëniet konkurruese ndërmjet shteteve për anëtarësimin e tyre që megjithatë janë të detyruara të bashkëpunojnë për ndërtimin e marrëdhënieve ndërshtetërore të mirëbesimit reciprok të bazuar në standardet që ofrohen nga NATO. Në konceptin bashkëkohor për zbatueshmërinë e integritimeve me rëndësi të veçantë është kuptimi për rolin "ndërvarësisë në marrëdhëniet ndërkombëtare" që paraqet ndikim fundamental edhe për NATO-n dhe për proceset integruese. Për jetësimin e interesave strategjike për anëtarësimin e saj në strukturat euroatlantike në NATO dhe BE, Republika e Maqedonisë i definon vlerat për bashkëpunim regional, si dhe për bashkëpunim me fqinjët, kjo si nxitje themelore e bashkëpunimit regional, që mundet të arrihet përmes bashkëpunimit politik, ekonomik, kulturor, arsimor dhe përmes llojeve të tjera të bashkëpunimit, si të atij bilateral dhe regional. Me këtë do të vendosej dialogu në disa nivele dhe do të krijoheshin më tepër mundësi për besimin më të madh në ofrimin e popujve që jetojnë në shtetet e Europës Juglindore. Kjo e nënkupton aktivitetin diplomatik për dialog në përkufizimin e vlerave të përbashkëta të cilat do të krijojnë ambient për stabilitet të brendshëm dhe bashkëpunim regional.¹³⁸

¹³⁵ Po aty.

¹³⁶ Po aty.

¹³⁷ Berge, Benjamin vo dem, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana Pipei, *Measuring Intra-Party Democracy: A Guide for the Content Analysis of Party Statutes with Examples from Hungary, Slovakia and Romania* (Springer, 2013).

¹³⁸ Po aty.

- **Kushtet shoqëroro- politike në Maqedoninë e Veriut**

Për të u kuptuar drejt proceset integruese euroatlantike në kushtet objektive duke u bazuar në kornizat kushtetuese për afrimin e Maqedonisë në NATO, në vazhdimësi duhet të sqarohet edhe rëndësia e integritetit të brendshëm, si dhe roli i organizatave ndërkombëtare paqësore në këto periudha të kaluara të mbështetura në politikën euroatlantike. Në këtë kontekst vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet çështjes sesi ishte bashkëpunimi ndërmejt Republikës së Maqedonisë dhe NATO-s - si bashkëpunim i sëndërtuar përmes mekanizmave vijues: • Plani Aksionar për Anëtarësim (MAP), • Plani Aksionar i Këshillit të Partneritetit Euroatlantik, • Iniciativa e NATO-s për Europën Juglindore, • Procesi për planifikim dhe pasqyrim etj. Meqë Maqedonia është e vendosur me politikën e saj drejt integritetit në NATO, ajo patjetër duhet ta pranojë Marrëveshjen e Uashingtonit dhe të gjitha normat e tjera dhe vendimet që janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje. Republika e Maqedonisë e parasheh ardhmërinë e saj në NATO si një garanci për sigurinë e përgjithshme në Europë dhe për liberalizimin demokratik si fundament të arkitekturës së sigurisë sot në Europë. Kornizat e tilla të sigurisë bëjnë NATO-n më të dëshiruar të jetë më e zgjeruar me më shumë vende anëtare, përmes partneritetit për paqe dhe të transformuar përmes Këshillit të Partneritetit Euroatlantik. Në kornizat e bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë me NATO-n janë të rëndësishëm pesë lëmenj në korniza të cilëve përgatitet Plani Aksionar për Anëtarësim dhe rekomandohen çështjet të cilat mund të shërbejnë gjatë përgatitjeve për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.¹³⁹ Këto janë: • Çështjet politike dhe ekonomike; • Bashkëpunimi regional; • Çështjet që kanë të bëjnë me forcat e armatosura /ARM; • Çështjet që kanë të bëjnë me resurset; • Çështjet e sigurisë dhe stabilitetit dhe • Çështjet juridike. Prej sjelljes të Vendimit nga ana Parlamentit të Maqedonisë për anëtarësim të Maqedonisë, në NATO vijnë aktivitetet e vazhdueshme të Maqedonisë me NATO-n, siç janë: pranimi në Partneritetin për Paqe (nëntor 1995), pranimi në Këshillin Verior-Atlantik për Bashkëpunim (mars 1996), ndërsa në qershor të vitit 1996 me SHBA u nënshkrua Marrëveshja SOFA; nga qershori i vitit 1996 Maqedonia prezantohet edhe me oficerët e vet - përfaqësues në selinë e NATO-s në Bruksel dhe në selinë koordinuese në Mons; në janar të vitit 1997 inkuadrohet në Procesin për Analizë dhe Planifikim të NATO-s (PARP), në qershor të vitit 1997 Republika e Maqedonisë bëhet anëtare e Këshillit VeriorAtlantik e kështu me rradhë. Me vendim të Qeverisë së Maqedonisë më 30 qershor 2002 është aprovuar dokumenti Elementet e Strategjisë së Republikës së Maqedonisë për Anëtarësim në NATO, mbi bazë të të cilit do të realizohen reformat dhe përforcimi i kornizës institucionale të përgatitjes së Maqedonisë për anëtarësim në NATO. Në këtë strategji potencohet qëllimi i Republikës së Maqedonisë për anëtarësim në NATO dhe UE. Në plan të jashtëm politik dhe ekonomik, synim permanent duhet të jetë ngritja e marrëdhënieve me SHBA-të, marrëdhëniet me fqinjët dhe përforcimi i bashkëpunimit regional në Ballkan. Plani i punës për anëtarësim përmes programeve vjetore bëhet me qëllim që shtetet kandidatë për anëtarësim në NATO të bëjnë prezantimin për përgatitjet e tyre në aspektin politik, ekonomik, të mbrojtjes, të resurseve, të sigurisë dhe të çështjeve juridike. Programi i tillë tani nga Maqedonia prezantohet në

¹³⁹Organizations', në William R. Cross & Richard S. Katz (ed.) *The Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press (2013).

NATO duke u mbështetur në dinamikën e implementimit të Marrëveshjes së Ohrit duke u plotësuar edhe me përmbajtje nga Koncepti Nacional për Siguri dhe Mbrojtje. Me këtë bëhen orvatje edhe vërtetohet përcaktimi strategjik si "qëllim i Republikës së Maqedonisë që edhe një herë ta vërtetojë ngritjen e bashkëpunimit të Maqedonisë me NATO, duke e vlerësuar një ardhmëri që duhet të sendërtohet si pjesë e familjes europiane, pra si anëtare e NATO-s dhe BE-së." Në vazhdimësinë e bashkëpunimit ndërmjet Maqedonisë dhe NATO-s, për praninë e NATO-s në Maqedoni janë evidente vlerësime pozitive për rolin dhe misionin e NATO-s për kthimin e paqes në Maqedoni gjatë kohës së krizës të vitit 2001, deri në arritjen e Marrëveshjes së Ohrit në gusht të vitit 2001. Për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme ose në përgjithësi për Qeverinë e Maqedonisë, sipas detyrimeve që dalin nga një dokument me peshë ndërkombëtare, siç është Marrëveshja e Ohrit, tani është koha e fundit të kuptohet se, lidhja e fortë e shtetit me ushtrinë dhe me policinë, e forcon sigurinë e të gjithë qytetarëve nëse nuk do të ekzistonte dyshimi se në Maqedoni krijohet një ushtri njënacionale ose një ushtri vetëm me joshqiptarë. Ose, se shqiptarët duhet të paraqesin vetëm një numër, por jo edhe peshën e vendosjes në organet përgjegjëse të ushtrisë dhe policisë. Nëse dyshimet të tilla forcohen, atëherë nuk mund të bisedojmë për një armatë dhe polici e cila do të jetë e të gjithë qytetarëve, andaj ekziston rreziku që si asnjëherë më parë të forcohet lidhshmëria vetëm e një kombi dhe shteti me forcat e sigurimit, që për shtetet shumënacionale është hap shumë i rrezikshëm, i cili e shton mosbesimin dhe pasigurinë e të tjerëve, në këtë rast të shqiptarëve në RM. Është fakt se sot, krahas Marrëveshjes së Ohrit, e sidomos duke u thirrur në Aneksin C, shqiptarët bëjnë orvatje të inkuadrohen në sferat organizimit ushtarak dhe policor, por nëse pengohet implementimi nga Qeveria aktuale, atëherë doemos duhet të pranohet fakti se forcat aktuale politike në Maqedoni vazhdojnë të tregojnë papjekuri politike, e cila mund të quhet edhe papërgjegjësi nacionale. Ky konstatim për fat të keq edhe sot mbetet aktual nëse e kemi parasysh njëfarë renditje të gjërave, me ç'rast kemi të bëjmë me filozofinë e refuzimit në periudhën e implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, aq më tepër kur shqiptarët edhe më tej preokupohen me vështirësitë për prishjen e traditës së deritanishme kur është fjala për emërimin e një shqiptari komandant togu, komandant kompanie, regjimenti ose edhe në vetë strukturën udhëheqëse të Shtabit e Përgjithshëm. Nuk mund të merret si sukses i madh i implementimit të Marrëveshjes së Ohrit vetëm pranimi i një numri të ushtarëve të paguar dhe i një numri të nënoficerëve nga radhët e shqiptarëve.¹⁴⁰

- **Papunësia, varfëria , migrimi i popullsisë**

Pavarësia e Republikës së Maqedonisë, si dhe kalimi prej në ekonomi të planifikuar, në atë tregtare në vitin 1991, e shënoi fillimin e tranzicionit të gjatë dhe socialisht të vështirë. Procesi i tranzicionit u ndoq me privatizim, restrukturim të ndërmarrjeve dhe mbylljen e një numri të madh të kapaciteteve industriale joprofitabile. Si rezultat, një pjesë e madhe e fuqisë punëtore në Republikën e Maqedonisë u transformua në teprice teknologjike, shkalla e papunësisë dhe varfërisë u rrit me ashpërsi, ndërsa standardi jetësor u keqësua. Në një situatë të tillë, varfëria dhe ç'kyçja sociale, si probleme komplekse dhe multidimensionale, u ndoqën me mohimin e të drejtave të njeriut për

¹⁴⁰ Po aty.

shkak të faktit se grupet e prekshme të popullatës nuk kishën mundësi që ti përmbushin as edhe nevojat bazike jetësore. Për seriozitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij problemi tregon edhe shkalla aktuale e varfërisë relative në Maqedoni, e cila ende është shumë e lartë, gjegjësisht është 28.7% . Në kontekstin e tillë shoqëror, sistemi i mbrojtjes sociale në Maqedoni u ballafaqua me sfidën për t’ju përgjigjur numrit më të madh të qytetarëve të varfër dhe socialisht të ç’kyçur. Një nga treguesit relevant për varfërimin e qytetarëve maqedonas është numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para i personave të aftë për punë, materialisht të pasiguruar (ndërsa i jepet amvisërisë). Në dhjetor të vitit 2009, nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Maqedoni (564.296), gati 9.4% (53.105 amvisëri) ishën shfrytëzuese të ndihmës sociale në para . Edhe përpos përpjekjeve të krijuesve të politikave për ulje të shpenzimeve për ndihmë sociale dhe përfshije të grupeve të prekshme të qytetarëve në vijimet shoqërore, numri i shfrytëzuesve nuk u zvoglua shumë në dy dekadat e fundit. Për të arritur përfshirje më të madhe sociale të qytetarëve, në periudhën pas vitit 2003 , fokus më intenziv u vendos mbi decentralizimin e mbrojtjes sociale. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtje sociale të vitit 2004 , të cilat u miratuan në pako me ligjet për decentralizim, komunat fituan mundësia dhe përgjegjësi që ti zhvillojnë funksionet sociale në nivel lokal dhe të krijojnë programe për përmbushjen e nevojave të grupeve në rrezik social. Ligji parashihte mundësi që komunat të krijojnë forma jointitucionale të mbrojtjes, përmes krijimit dhe organizimit të qendrave për kujdes ditor dhe të përkohshëm të qytetarëve në varësi të nevojave të tyre, si dhe të organizojnë dhe të zbatojnë mbrojtje sociale të qytetarëve në territorin e tyre përmes miratimit të programeve të tyre zhvillimore, në pajtim me nevojat specifike.

- **Diplomacia ekonomike**

Politikat ekonomike patjetër duhet të udhëhiqen pavarësisht nga ciklet/çështjet politike dhe me rëndësi është vazhdimësia e tyre sepse çdo “ad hoc” veprim mund të përcillet vetëm nga rezultate afatshkurtra. Udhëheqjet politike në Republikën e Maqedonisë duhet patjetër të kuptojnë se nuk kanë komoditet që ti lënë anësh politikat ekonomike në llogari të agjendave politike. Në atë kuptim, pavarësisht sa do qoftë të jenë të rëndësishme çështjet politike, çështjet ekonomike nuk duhet të lihen anësh.¹⁴¹

Nga viti 2008 e këndej, Republika e Maqedonisë realizoi nëntë zgjedhje politike (parlamentare, presidenciale dhe lokale), kaluan përmes një krize të fuqishme politike dhe turbulencia të panumërta politike (2015-2017), ndërsa vitin e fundit objekti kryesor i interesimit është zgjidhja e çështjes politike për emrin. Ekonomia është gjithmonë temë qendrore në fushatat politike, mirëpo në praktikë, ka shumë pak lëvizje në planin ekonomik. Rritja ekonomike e Republikës së Maqedonisë në periudhën 2008-2017 mesatarisht ka qenë 2 përqind në vjet, dhe atë, kryesisht si rezultat e rritjes në sektorin ndërtimor.¹⁴²

Sipas d-r Vlladimir Gligorov nga Instituti i Vjenës për studime ndërkombëtare ekonomike, nëse Republika e Maqedonisë do të kishte realizuar shkallë mesatare vjetore të rritjes ekonomike prej 4 përqind në 30 vitet e ardhshme, me supozimin se rritja e UE të jetë 2 përqind në vit në atë periudhë, atëherë BPV i Maqedonisë për banor do të kishte arritur rreth 90 përqind nga ai

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² Po aty.

mesatar i UE. Me këtë rast, do të nevojitej që çdo vit 20-25 përqind nga BPV të Maqedonisë të investohet në inovacione dhe zhvillim teknologjik për tu arritur konkurrenca e ekonomisë, ndërsa eksporti të jetë gjeneratori kryesor i rritjes dhe i punësimeve.

Në shikim të parë, ajo është periudhë e gjatë, mirëpo, pothuajse është e njëjtë sipas gjatësisë si ai nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë deri tani (27 vjet). Nëse do të kishte pasur stabilitet politik, politika të mira dhe të vazhdueshme ekonomike, kontest të zgjidhur me Greqinë për emrin dhe para së gjithash, sundim të drejtës, pozita ekonomike e Republikës së Maqedonisë në mënyrë të pritshme do të kishte qenë më ndryshe. Ajo e para e filloi procesin e aderimit ndaj UE (para vendeve të tjera nga rajoni), kështu që, nuk ka dyshim se tanimë do të kishte qenë anëtare e Unionit, pa marrë se faji për atë që ka ndodhur nuk është vetëm për fajin e palës maqedonase. Me këtë rast, pa idealizim dhe të mësuar nga përvojat e vendeve të cilat hynë në UE, procesi i zhvillimit ekonomik me siguri do të kishte pasur edhe mjaft probleme, mirëpo, në mënyrë të argumentuar mund të supozohet se ai do të vazhdohej në mënyrë të vazhdueshme, i ndihmuar me ndihmë financiare dhe profesionale nga UE. Në vend të asaj, konstelacionin real politik gjatë 20 viteve të kaluara kryesisht u karakterizua me “ad hok” politika dhe masa ekonomike pa vizion për zhvillim afatgjatë.¹⁴³

Raporti i konkurrencës globale nëpërmjet përfshirjes së madhe të vendeve siguron tregues krahasues të fituara nga e njëjta metodologji të cilët lejojnë të shihet pozicionimi i vendit në raport me të tjerët. Në kushte kur konkurrenca bie, dhe ajo duhet të jetë rezultati përfundimtar i politikave ekonomike të vendit, analiza e këtij Raporti është e dobishme. Rënia e fundit në renditjen e Republikës së Maqedonisë e pasqyron ndikimin negativ të krizës politike, megjithatë, edhe rezultatet paraprake kryesisht i tregojnë dobësitë në të njëjtat fusha të theksuara edhe në raportin e fundit.¹⁴⁴

Forumi Botëror ekonomik e definon konkurrencën si “shumë të institucioneve, politikave dhe faktorëve që e përcaktojnë nivelin e produktivitetit të vendit” dhe në pajtim me këtë, “ekonomi konkurrenca është ajo që është produktive”. Ky definicion është i shndërruar në indeksin e lartë përmendur të konkurrencës globale i cili paraqet vlerë të përlllogaritur nga 12 indekse komplekse (të cilët përfshijnë gjithsej 98 tregues). Për indikatorët/treguesit e caktuar që komentohen më poshtë është dhënë edhe rangi i Republikës së Maqedonisë nga 140 vendet e përfshira. Të dhënat në bazë të të cilave përlllogariten indikatorët/treguesit merren nga bazat e të dhënave të organizatave të etabluara ndërkombëtare dhe përmes anketës së standardizuar të personave udhëheqës në kompanitë nga ekonomia nacionale. Nga kjo, rezultatet përfshijnë edhe perceptcion të biznes sektorit për ambient afarist dhe konkurrencë të vendit.

Nga 12-të indikatorët, Republika e Maqedonisë është më dobët e pozicionuar në raport me katër indikatorët vijues: madhësia e tregut (109), tregu i prodhimeve (107), aftësi për sjellje të risive (98) dhe institucione (85).

¹⁴³ Constitutionalism, and Ownership’, *Connecticut Law Review* (2004), Vol 37.

¹⁴⁴ Po aty.

Në indikatorin e parë ka dy tregues të përbërë: vlera e BPV sipas paritetit të fuqisë blerëse (115) dhe importi si përqindje nga BPV (18). Këto dy tregues tregojnë se, pavarësisht hapjes së theksuar tregtare të vendit (renditje e lartë në raportin e importit), fuqia blerëse në vend është e ulët, duke e bërë atë jo tërheqëse në një shkallë globale. Nevojitet rritje e fuqishme e BPV për një periudhë më të gjatë kohore për të pasur një progres të caktuar të ky indikator.

Indikatori i dytë ka të bëjë me faktorët të cilët e përcaktojnë konkurrencën në tregun e prodhimeve dhe të shërbimeve. Ai është marrë si rezultat i tetë treguesve, me ç'rast Republika e Maqedonisë ka renditje më të dobët në katër treguesit vijues: efekti i dëmshëm i tatimeve dhe subvencioneve mbi konkurrencën në tregun (109), vëllimi i dominimit të tregut (124), konkurrenca në fushën e shërbimeve (119) dhe barrierat jo-doganore në tregtinë (99).

Indikatori i tretë ka të bëjë me aftësinë për sjellje të risive, i matur përmes dhjetë treguesve. Prej tyre, Republika e Maqedonisë është më e dobët në raport me bashkëpunimin midis palëve të prekura (126), shkalla e sofistikimit të blerësve (119) dhe gjendja e klasterëve në vendin (108). Tregues interesant është sofistikimi i ulët i blerësve, i cili tregon se te blerësit në Maqedoni faktor themelor për blerje është çmimi i ulët, ndërsa karakteristikat teknike dhe të tjerat e prodhimit merren më pak parasysh. Ajo reflektohet në kapacitetin më të vogël të absorbimit të inovacioneve (risive) në tregun, që në mënyrë të tërthortë reflektohet edhe në motivimin/aftësinë për inovim.

Indikatori i katërt janë institucionet. Nga gjithsej njëzet tregues në kuadër të këtij indikator, Republika e Maqedonisë është e renditur më dobët në raport me tetë që vijojnë: mbrojtja e pronësisë intelektuale (133), krimi i organizuar (131), korniza juridike për zgjidhje të kontesteve (129), kornizë juridike për kontestimin e qëndrueshmërisë juridike të aktiviteteve ose vendimeve të qeverisë (nga ana e sektorit privat) (129), pavarësia e gjyqësisë (128), çështje pronësore (126), standarde për revizion dhe raportim (122) dhe orientimi i ardhshëm i qeverisë (120). Komenti për këto tregues nuk është i nevojshëm, duke pasur parasysh se presioni më i madh nga UE ka të bëjë me reformat në sistemin e legjislacionit dhe administratën publike.

Në raport me konkurrencën, Ministria e ekonomisë ka ueb faqe të posaçme e cila e përmban kornizën juridike dhe strategjike për nxitje të konkurrencës, të projekteve dhe instrumenteve në përkrrahje të bizneseve, si dhe të shërbimeve publike që kompanitë i kanë në dispozicion. Në faqen janë vendosur 11 dokumente strategjike/planore (Plan për zhvillim ekonomik 2018, Program për reforma ekonomike 2018-2020, Strategji për konkurrencë 2016-2020, Strategjia për inovacione 2012-2020, e kështu me radhë), gjë e cila konfirmon se ekziston planifikim strategjik në pjesën më të madhe të fushave relevante për konkurrencën. Prapëseprapë, konkurrenca në vend është në rënie e sipër.

Dobësitë e numëruara edhe më tepër theksohen gjatë zgjedhjeve të shpeshta politike. Duke pasur parasysh se krijimi/zbatimi i masave kyç ekonomike më shpesh është i lidhur me koordinimin në nivel politik (ministër, zëvendës ministër ose sekretar shtetëror), çdo cikël zgjedhor politik ose çështje qenësore politike tërheq defokusim të caktuar (ose të plotë nga politikat ekonomike për shkak të angazhimit të politikanëve në procesin zgjedhor, ndërsa shpesh herë edhe shkurtim të

mjeteve për zbatim të politikave. Rrjedhimisht, vazhdimësia në zbatimin e politikave ekonomike priset. Këtu vendimtar është ekzistimi i administratës profesionale publike (me sekretar shtetëror si funksion profesional, e jo politik), e cila do të kishte funksionuar pa pengesa.

Sado qoftë të jenë çështjet politike, politikat ekonomike nuk duhet të lihen anësh. Me këtë rast, çdo qeveri duhet ti definojë prioritetet e veta dhe t'ia japë impulsin e vet zhvillimit, mirëpo shteti patjetër duhet të ketë orientim të qartë dhe afatgjatë zhvillimor të shprehur përmes dokumente dhe politika të zbatueshme dhe të harmonizuara strategjike. Politikat ekonomike duhet të krijohen përmes pjesëmarrjes konstruktive të të gjithë aktorëve shoqëror (partitë politike – posaçërisht kur janë në opozitë, sektori joqeveritar, academia e kështu me radhë) që të mund të sigurohet “pronësi” më të gjerë mbi ata dhe vazhdimësi të zbatimit të tyre. Çështjet politike nuk guxojnë të jenë të jenë justifikim për ngecjen në ekonominë (dhe fushat e tjera), por përkundrazi – rezultatet duhet të jenë matësi më i fuqishëm për vlerësim të suksesit të ushtruesve të funksioneve politike. Ky është thelbi i udhëheqjes aktive të politikave ekonomike që duhet të aplikohet në Republikën e Maqedonisë.¹⁴⁵

- **Ngërcet politike në mes VMRO-së dhe LSDM-së ; ndërmjetësimi i vazhdueshëm i diplomacisë përrëndimore**

Për VMRO-DPMNE-në dhuna politike mbi Kushtetutën, ligjin dhe rregulloren nga ana e LSDM-së shkaktoi acarim, ndërsa provokim shtesë ishte edhe këndimi i himnit shqiptar në Kuvendin maqedonas. Me këtë përfundojë edhe zgjedhja jo e ligjshme e kryetarit të Kuvendit jashtë të gjitha procedurave, por tashmë zyrtarisht seanca ka përfunduar, pa shënim, pa stenogram, pa të drejtë të fjalës së deputetëve, jashtë Rregullores për punë, ligjeve dhe Kushtetutës.

Funksionari Amerikan Hojt Ji udhëtoi në Maqedoni me qëllim që të ndihmojë në gjetjen e paqes dhe zgjidhjes politike të krizës e cila arriti kulmin me dhunën në Kuvend nga grupi i mbështetësve të qëndrimeve të VMRO-DPMNE-së dhe ai bisedoi edhe me liderin e kësaj partie Nikolla Gruevskin, me çka partia kumtoi/dha deklaratë dhe qëndrim, se arsyeja për incidentin ka qenë “dhunë politike e LSDM-së mbi Kushtetutën, ligjet dhe rregulloren...”

Në të gjithë kumtesën ka mjaftë pjesë që janë të pavërteta, por shikuar edhe nga logjika formale-ligjore, është jokonsekuente. Arsyeja thelbësore se përse është e pavërtetë dhe jokonsekuente, për opinionin e gjerë dhe ndërkombëtar tashmë dihet – refuzimi i kalimit të qetë të qeverisë, ndërsa hetimi do të vërtetojë se kush dhe si ka porositur dhe ka nxitur dhunën mbi deputetët, kush dhe si i ka hapur dyert e Kuvendit dhe përse policia, gjegjësisht përgjegjësit e saj kanë shmangur reagimin – me qëllim ose nga vlerësimi i keq profesional.

Por, VMRO-DPMNE, respektivisht lideri i saj Nikolla Gruevski, kur deklaroi këtë, në radhë të parë bëhet fjalë edhe për jokonsekuencë.

Arsyet qëndrojnë pikërisht në Kushtetutën, ligjet dhe Rregullore, të cilat sipas mendimit të partive të tjera në Kuvend, përveç VMRO-DPMNE-së, më pas edhe nga më shumë ekspert ligjor dhe nga pjesa më e madhe e opinionit vendas dhe ndërkombëtar, shfrytëzohen nga ana e Gruevskit dhe presidentit Ivanov, që të mos ketë transferim të qeverisë.

¹⁴⁵ <https://www.bdi.mk/documents/MARREVESHJA-E-OHRIT.pdf>

Sepse shumë herë janë përsëritur qëndrimet e ekspertëve dhe politikanëve se në cilën mënyrë Ivanov shkel Kushtetutën dhe nuk ia mundëson mandatin liderit të grupit të partive politike të cilat kanë shumicë parlamentare, por do të ndalemi në Rregulloren e Kuvendit. Ekzistojnë dy mendime diametralisht kundërthënëse.

Njërin e përfaqëson VMRO-DPMNE. Ata thirren në Rregulloren për punën në Kuvend, më saktë me atë se kush udhëheq seancën dhe se nuk ka qenë e mundur që të kalohet në pikën tjetër të rendit ditor nëse nuk janë kryer të gjithë diskutimet, dhe ai është zgjedhja e kryetarit të Komisionit për zgjedhje dhe emërimet. Argumenti më i madh i tyre është neni 80, paragrafi 2, në të cilin thuhet se “Dëgjimi zgjat derisa sa nuk përfundon lista e deputetëve të cilët janë paraqitur për të marr fjalën”.

Deputetët e shumicës parlamentare, përsëri, thirren në dispozitat e nenit 78, paragrafi 2, i cili thotë se “Përgjatë seancës, me propozim të kryetarit të Kuvendit, propozuesit ose deputetit të cilët mbështetën më së paku nga dhjetë deputet, Kuvendi pa dëgjim vendos pas secilit propozim për ndryshim të orarit të dëgjimit sipas pikave të rendit ditorë, gjegjësisht që të udhëhiqet dëgjimi i vetëm sipas pikave të rendit ditorë që janë të lidhura mes vete”.

Deputetët e VMRO-DPMNE-së, përgjatë 20 vazhdimeve në seancën konstituive filluar para një muaji e gjysmë, me paraqitjen e dhjetëra diskutimeve në pikën e zgjedhjes së Komisionit, bëjnë filibastering klasik, gjegjësisht pengojnë punën e Kuvendit. Ata edhe lajmërojnë se seanca do të zgjatë deri kur të kryhen të gjithë diskutimet, ndërsa për njëzet vazhdimet efektive të seancës, me diskutim përfunduan katër-pesë diskutues, që në perspektiv do të thotë pengesë prej shumë muajve. Në këtë mënyrë nuk lejohet transferimi i qeverisë, gjatë të cilit dispozitat e Rregullores interpretohen vetëm në interes politik të VMRO-DPMNE-së.

• Marrëveshja e Përzhinos

"Marrëveshja e Përzhinos është zbatuar vetëm në disa pika, por ka akoma pika të cilat duhet të përmbushen. Pikat të cilat nuk janë implementuar janë pastrimi i plotë i listës zgjedhore dhe arritjen e marrëveshjes për rregullativën ligjore që ka të bëjë me fushën e medieve. Të gjithë jemi dëshmitarë se kjo listë zgjedhore ka qindra mijëra votues fiktiv. Kjo listë është pasuruar në dëm të elektoratit shqiptarë"; Prof. Dr. Mersim Maksuti.¹⁴⁶

Politika në vend po kalon një nga periudhat më të vështira të tranzicionit të tejzgjatur, kurse propagandat e partive politike kemi filluar prej tani t'i shikojmë dhe t'i dëgjojmë nëpër sheshe dhe tribuna. Zgjedhjet planifikohen të mbahen brenda vitit, populli ka një pritje megalomane, kurse procesi zhvillohet në mënyrë të ngadaltë dhe në disa raste edhe me dështime të padëshiruara.

Gjatë procesit të zbatimit të marrëveshjes së Përzhinos, kohë pas kohe ishim dëshmitarë edhe të një pakënaqësie për shkak të gjërave që i përmbante kjo marrëveshje të cilën e nënshkruan 4 partitë më të mëdha në vend, duke shkuar deri në shkelje të Kushtetutës. Disa javë më parë, me dorëheqjen e kryeministri të qeverisë së deritanishme Nikolla Gruveski, u realizua edhe një pikë shumë e rëndësishme e marrëveshjes së Përzhinos, i cili ishte kusht dhe kërkesë e opozitës

¹⁴⁶ <https://vertetmates.mk/kategorija/marreveshja-e-perzhinos-sq/>

maqedonase LSDM. Mirëpo edhe pse Gruevski dha dorëheqjen me kusht që të jetë e vlefshme vetëm 100 ditë para zgjedhjeve, që sipas llogarive të tij zgjedhjet duhet të mbahen më 24 prill dhe me të cilën VMRO-DPMNE edhe zyrtarisht e filloi fushatën zgjedhore, nga ana tjetër LSDM nuk e pranon këtë datë dhe insiston që të merren vesh për një datë tjetër. Pas dorëheqjes së kryeministrit të “vjetër” që aktualisht është edhe kryetari i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski filluan edhe përleshjet verbale për kampanjën zgjedhore mes tij, opozitës dhe përfaqësuesit të BE-së. Gruevski kritikoi ndërkombëtarët dhe prokuroren speciale për punën e tyre. Menjëherë pas kësaj, prokurorja speciale Katica Janeva kërkoi truproje speciale sepse nuk ndjehej e sigurt. Ndërmjetësuesi Peter Van Houte në prononcimin për mediet doli me mesazh të qartë: ”Nuk kam ndonjë reagim, reagimi i vetëm rreth kësaj është gjithmonë kjo, “Nëse nuk të pëlqen porositja, vrite atë që ta dërgon”. Këto tensione kanë arritur kulmin pasi nuk ka një datë të caktuar për atë se kur do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Në mos zbatimin e marrëveshjes së Përzghinos në tërësi partia opozitare maqedonase shprehet se nuk do të hyj në zgjedhje. Si shpëtimtarë i situatës së krijuar pritet të jetë euro-komisari Johannes Hahn i cili pritet të vijë në muajin Shkurt për ta mbajtur të gjallë marrëveshjen e Përzghinos, ose për ta varrosur atë. Për të gjitha këto detaje dhe se si do të vijoj më tej procesi, arritëm të bisedojmë me profesorin e drejtës Kushtetuese Prof. Dr. Mersim Maksutin, i cili të vetmen shpresë për tejkalimin nga kriza e sheh tek monitorimi më rigoroz i ndërkombëtarëve.

Qeveria teknike si rregull në shtetet demokratike parlamentare vjen si rezultat i zhytjes së vendit në krizë të thellë politike dhe si rezultat i mosfunksionimit të institucioneve të shtetit. Mund të emërohet si qeveri teknike, kalimtare apo qeveri të ekspertëve. Kjo qeveri teknike do të ketë të vetmin mandat që ta stabilizoj vendin, ta nxjerr nga kriza politike si dhe të vendoset funksionimi i sistemit ligjor dhe i demokracisë. Presim që kjo qeveri të luaj rolin objektiv dhe konstruktiv. Mendimi im është se mandati i kësaj qeverie është i shkurtër në krahasim me vendet tjera parlamentare të cilat ballafaqohen me krizë të thellë politike mandati i kësaj qeverie është më i gjatë se 3 muaj. Në praktikën parlamentare qeveria teknike duhet së paku të jetë në funksion 6 muaj dhe të përgatisë terrenin që ta nxjerr shtetin nga kriza. Duhet të presim dhe të shohim se a do të mund të dalin përballë me përgjegjësinë dhe të shihet nëse ekziston vullneti i fuqishëm politik.... Jam tejet skeptik që qeveria do të arrijë gjatë këtij afati të mbyll misionin.

Kemi një situatë të re të krijuar në Republikën e Maqedonisë, me vendimet të cilat i morri parlamenti i vendit para disa ditëve ku brenda disa orëve morri 3 vendime të rëndësishme që në situata normale ato duhet të shkojnë prej 1 deri në 3 muaj. Dy nga vendimet që u ndërmorën ishin vendime që u përmbushën sipas marrëveshjes së Përzghinos, ndërsa njëri vendim i cili i miratuar sipas ligjit duhet të miratohet një muaj më vonë. Rasti i parë kur parlamenti konfirmoi dorëheqjen e kryeministrit në mënyrë konstruktive iu përgjigj implementimit të marrëveshjes së Përzghinos. Hapi tjetër mendoj se ishte i ngutshëm dhe nuk është dashur ta hap këtë vendim pasi parlamenti u shpërbë. Ky akt ishte një akt antikushtetues, fillimisht mori vendim për shpërbërjen e parlamentit dhe pas asaj shkoj në zgjedhje të qeverisë së re. Në këtë rast parlamenti edhe teknikisht nuk i ndoqi hapat konstitucional të cilat duhet ti ndërmarrë. Kushtetuta e sheh shumë qartë se parlamenti i Maqedonisë mund të vet shpërbëhet 90 ditë përpara se ti skadojë mandati edhe atë kur kemi të bëjmë me zgjedhje të rregullta parlamentare. Mirëpo në këto raste parlamenti mund të shpërbëhet vetëm 60 ditë para se të skadon mandati. Në këtë rast kemi një interpretim jo të drejt të Kushtetutës për arsye se praktika parlamentare në vendeve të ndryshme nuk e lejon këtë. Ky rast është pa presedant që bie ndesh me praktikën në vendet tjera dhe kjo është arsyeja se parlamenti morri një veprim të ngutshëm. Situata të këtilla nuk njohim në praktikën parlamentare të vendeve me demokraci të zhvilluar. Situata e re kur

parlamenti u shpërbë në mënyrë të një anshme nga shumica e këtij vendi në kuptimin politik kjo ishte një veprim i ngutshëm për arsye se kjo garniturë qeverisëse kishte edhe 1 muaj kohë që ta shpërbëjë parlamentin. Opozita në këtë rast ka të drejtë që është deklaruar për mos pjesëmarrje në zgjedhje për arsye se duhet t'i referohemi realizimit të marrëveshjes së saj. Marrëveshja e Përzghinos është zbatuar vetëm në disa pika, por ka akoma pika të cilat duhet të përmbushen. Pikat të cilat nuk janë implementuar janë pastrimi i plotë i listës zgjedhore dhe arritjen e marrëveshjes për rregullat-ivën ligjore që ka të bëjë me fushën e medieve. Të gjithë jemi dëshmitarë se kjo listë zgjedhore ka qindra mijëra votues fiktiv.

Presion politik, mbi institucionet e këtij vendi në veçanti ku do të ndihmohet KSHZ-ja dhe t'i ofrojnë të gjitha kapacitetet që vërtetë të mund të garantoj një proces të lirë zgjedhor. Kryetari i KSHZ-së u deklarua edhe vet se ky institucion është i pa aftë që brenda kësaj periudhe të bëjë pastrimin e listave zgjedhore, pra të fshihen të gjithë votuesit fiktiv. Atëherë KSHZ-së duhet t'i ofrohet ndihma institucionale. Të risin bashkëpunimin me institucionet tjera dhe të ndihmohet nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e punëve të Brendshme, Fondi Pensional Invalidor të cilat duhet t'i ofrojnë të gjitha të dhënat për të pastruar listën zgjedhore. Kjo situatë duhet të monitorohet shumë afër dhe sa me të vërtetë ka rritur që kjo listë të pastrohet. Mbikëqyrja e fuqishme e ODHIR-së, pastrimi i listës të monitorohet dhe t'i lihet e drejta opozitës të kontrolloj ecurinë e pastrimit të listës zgjedhore.

Prokuroria speciale si një nga pikat më të rëndësishme që prek realizimin dhe implementimin pa dyshim ka të bëjë me të gjithë bartësit e pushtetit të cilët dyshohen për abuzim dhe keqpërdorim të funksionit. Kjo paraqet sfidën më të madhe në realizimin e marrëveshjes së Përzghinos. Prokurorja speciale të nis procedura para mbajtjes së zgjedhjeve të 24 Prillit ose të ndonjë date tjetër. Ajo duhet të ndihet në funksion të stabilitetit të këtij vendit, në luftën ndaj korrupsionit dhe kriminalitetit. Nëse godet aktorët të cilët kanë abuzuar me pushtetin para se të mbahen zgjedhjet atëherë prokurorja speciale mund të ketë efektin e vet në të kundërtën gjithçka do të jetë sipërfaqësore. Në qoftë se ndodh që prokuroria speciale të ngre si procedurë penale ndonjë rast pasi të shpërbëhet parlamenti nuk do të kishte efektin e duhur. Të gjithë të dyshuarit për krim, korrupsion, duhet të hetohen të ndiqen, dhe atëherë procedura kundrejt tyre nuk mund të ndërpritet, por do të vazhdojë. Ka një rregull e cila thotë që të gjithë të dyshuarit të cilët kanë kryer vepra penale që parashohin burgim mbi 5 vite, ato drejtpërdrejt mund të arrestohen.

Me marrëveshjen e Përzghinos, parashihen ndryshime në përbërjen dhe kompetencat e KSHZ-së. 3 anëtarë të KSHZ-së zgjidhen nga pozita, 3 nga opozita dhe risia në këtë rast është se 3 anëtarët e ri vijnë nga radhët e ekspertëve. Vërejtje e cila ka të bëjë me një kompetencë të re është që KSHZ-ja nuk arriti të bëhet në bazë të Badenterit, pra të parandalohet ndonjë padrejtësi që të vij në shprehje të votës së ndonjë etnikumi në vend. Ky majorizimi nuk u ndalu me rregullativën dhe ndryshimet e reja elektorale që të ndërhyjnë në rastin e kompetencave të KSHZ-së dhe në vend të këtij princi u instalua principi me konsensus. Mendoj se nuk u ofrua zgjidhja e drejtë për arsye se konsensusi nuk e zëvendëson Badenterin.

• **Marrëveshja e Prespës**

Me Marrëveshjen e Prespës fituan edhe Maqedonia edhe Greqia. E pra, kush e humbi atëherë? Humbi ultra-nacionalizmi grek dhe ai maqedonas. Por, te kompromiset mes dy shteteve, të dy palët janë të kënaqura në mënyrë të barabartë apo jo? Tani e di se, megjithatë, në rastin tonë, nuk është ashtu. Të pakënaqur janë të dy ultra-nacionalizmat, kundrejt

kënaqësisë së njerëzve liberalë se është zgjidhur një problem për ekzistencën e të cilit janë më pak fajtorë. Në fakt, nëse pyeten njerëzit liberalë nga të dyja anët e kufirit, problemi nuk do të ekzistojë. Maqedonasit e tillë, në këtë anë të kufirit, pra, asnjëherë nuk kanë pasur problem të kuptojnë se gjuha dhe identiteti ynë bazik janë sllavë, ndërsa grekët me pamje liberale nuk kanë pasur problem ta pranojnë emrin e vendit tonë të plotësuar me një përmbajtje të tillë.¹⁴⁷

Ultra-nacionalizmi nga të dy anët e kufirit, duke refuzuar të pranojnë këtë pikëpamje, ndjek frikën historike të njerëzve, dhe pastaj, duke përdorur propagandën, përhap urrejtje mes dy popujve tanë. Nacionalizmi ekstrem, patriotizmi ekstrem, si doni, kudo në botë, është ai që krijon ksenofobinë, urrejtjen, intolerancën, dhe shkakton dhunë... Të gjitha këto gjëra na ndodhin neve, maqedonasve dhe grekëve. Shikuar në një periudhë më të gjatë, ilaçi për këtë lloj të nacionalizmit malinj, të mbushur me frikë dhe urrejtje, është edukimi më i mirë i popullsisë, sidomos i gjeneratave të reja, i cili do të mbështetet mbi të vërtetën objektive historike. Para asaj, para së vërtetës, bien mitet nacionaliste dhe frika e mbledhur në mendjet e njerëzve.

Në fakt, nëse për një moment lëmë anësh historinë e largët, Maqedonia është provinca e fundit etnikisht e përzier evropiane e Perandorisë Osmane në të cilën kryqëzohen fatet e më shumë popujve. Ajo ka qenë e ndarë gjatë dy Luftërave Ballkanike, pak para se të fillonte Lufta e Parë Botërore. Kur, pas përfundimit të saj janë shkatërruar Perandoria Austro-Hungareze, Turke dhe Ruse, Presidenti amerikan Woodrow Wilson në Konferencën e Paqes të vitit 1919 në Paris ka mbërritur me parimin e ri në marrëdhëniet ndërkombëtare të quajtur “vetëvendosja kombëtare”. Politikanët evropianë kanë ngritur vetullat: Edhe një marrëzi tjetër e një politikani amerikan, i cili nuk e kupton politikën reale të Evropës. Përshkrimet e Walter Lippmann-it se si janë vizatuar kufijtë e shteteve të shumta të reja, si Jugosllavia, Çekosllovakia, Hungaria dhe Austria, për shembull, janë komike.

Ai rrëfen se si në një moment kishte ndodhur një turmë të madhe rreth tryezës mbi të cilën ishin përkulur përfaqësuesit e fuqive të mëdha, kështu që kanë vendosur ta vinin hartën e Evropës në qilim. Por, sepse duke qëndruar rreth saj, nuk kanë mundur të shohin asgjë, janë ulur në gjunjë dhe kanë filluar të zvarriten dhe të shtyhen për të treguar se cili kufi ku duhet të jetë. Në një moment, shkruan Lippman, po ndiej se si koka e Ministrit të punëve të jashtme të Italisë shtyhet në prapanicën time duke u përpjekur t’i afrohet hartës. Dhe duhet të dihet. Këta nuk kanë qenë njerëz mizorë të cilët janë kënaqur duke luajtur me fatin e popujve të vegjël: thjesht, fuqitë e mëdha kanë fuqinë për të rregulluar dhe për të ruajtur kornizën globale të sistemit të shteteve, dhe, deshëm apo jo, ata e bëjnë atë. Në të kundërtën, do të kishim një kaos të përhershëm dhe luftëra të pandërprera. Duke ndjekur interesat e vetë, sipas të cilave udhëhiqen edhe shtetet e vogla, fuqitë e mëdha e kanë bërë atë ndonjëherë më mirë, e ndonjëherë më keq. Pra, narrativit tonë të njohur ballkanik për fuqitë e këqija të mëdha, të cilat gjithmonë na copëtojnë dhe na ndajnë, duhet t’i kundërshtohet një pamje objektive e sistemit anarkik ndërkombëtar të shteteve, në të cilin mungon pushteti qendror. Prandaj, të gjithë i kanë drejtuar sytë tek ata, ndërsa në fillimin e viteve të nëntëdhjeta destinacioni ynë kryesor u bënë Uashingtoni dhe shtetet e fuqishme evropiane. Kështu, në një kontekst të ri historik të një Evrope të bashkuar, me mbështetjen e tyre kemi realizuar politikën tonë të vetëvendosjes paqësore dhe, në mes të zjarreve të luftërave etnike jugosllave, ne fituam pavarësinë në mënyrë paqësore. Sot, njëzet e pesë vjet më vonë, përsëri me mbështetjen e

¹⁴⁷ <http://respublica.edu.mk/blog/marreveshja-e-prespes-si-levizje-gjeostrategjike-amerikane>

tyre, përmes zbatimit të Marrëveshjes së Prespës, ne bëhemi aleatë. Për Greqinë, ky është një sukses i madh. Për Maqedoninë, megjithatë, kjo është një fitore.

- **Roli i diplomacisë perëndimore**

Pas shpalljes së pavarësisë në janar të vitit 1991, Republika e Maqedonisë e shprehu qartë anëtarësimin në Unionin Evropian si një nga interesat e saj strategjike. Duke e realizuar këtë përcaktim, Republika e Maqedonisë u legjitimua si partner i besueshëm dhe aleat i Unionit Evropian, që kaloi nëpër një varg etapash të ndryshme në zhvillimin e marrëdhënieve, të afrimit dhe të integritetit në UE.¹⁴⁸

Më 15 janar të vitit 1992, Unioni Evropian formoi Komisionin e arbitrazhit, i udhëhequr nga kryetari i Gjykatës Kushtetues të Francës, Rober Badinter. Komisioni erdhi në përfundim se Republika e Maqedonisë i plotëson të gjitha kushtet për pranimin ndërkombëtar dhe se emri nuk paraqet kërcënim territorial.

Por, për shkak të kundërshtimit të Greqisë që Republika e Maqedonisë të pranohet me emrin kushtetues, u vonua procesi i pranimin ndërkombëtar dhe i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me UE-në. Marrëdhëniet e plota diplomatike ndërmjet RM-së dhe UE-së janë vendosur në dhjetor të vitit 1995 kur është hapur edhe misioni i RM-së në UE.

Republika e Maqedonisë nga viti 1996 është shfrytëzuese e Programit FARE (PHARE), program i themeluar nga BE për ndihmë reformave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, të drejtuara kah hyrja në BE.

Në prill të vitit 1997 u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Evropiane, si dhe Marrëveshja nga sfera e transportit, e pastaj edhe për tekstin. Pastaj Unioni Evropian hapi përfaqësi, përkatësisht zyre të Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë.

Në prill të vitit 1998 për herë të parë u mbajt dialogu politik ndërmjet RM dhe BE, ndërsa në mars po të njëjtin vit u mbajt mbledhja e parë e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet RM dhe BE. Ai funksiononte me sukses deri në vendosjen e trupit të ri me Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim.

Komisioni Evropian në vitin 1999, formon kornizën e re në të cilën zhvillohet bashkëpunim i BE me shtetet e të ashtuquajtur Ballkani Perëndimor. (Republika e Maqedonisë, Bosnje e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Republika e Kroacisë), të cilin e quajti Proces për stabilizim dhe asociim (PSA).

Zyra e Komisionit Evropian në vitin 2000 u ngrit në nivel të Delegacionit të Komisionit Evropian.

Këshilli i Ministrave i Unionit Evropian në dhjetor të vitit 2000 miratoi Vendim (Normativë) me të cilin u vendos KARDS (CARDS) programi, si program për ndihmë të Unionit Evropian shteteve që i përkasin Procesit për stabilizim dhe asociim.

Republika Maqedonisë është shteti i parë pjesëmarrës në PSA e cila e nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim në prill të vitin 2001.

Më 22 mars të vitit 2004, në Dablin, Republika e Irlandës, Qeveria e RM parashitroi kërkesë për anëtarësim në UE me çka u vërtetua përcaktimi politik i vazhdueshëm dhe i qartë për kyçe në Union.

Në Samitin e Brukselit më 17 dhjetor të viti 2005 Këshilli i Evropës vendosi që Republika e Maqedonisë të marrë statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në UE. Prej atëherë në fund të

¹⁴⁸ <https://www.sobranie.mk/republika-maqedonis-n-rrug-n-p-r-n-be.nspix>

vitit, Komisioni Evropian shpall raporte të rregullta për përparimin e Republikës së Maqedonisë.

Më 15 korrik 2009, Komisioni Evropian, në bazë të reformave të realizuara dhe rezultateve të arritura, ka vendosur të jep propozim për dhënien e liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Sipas raportit të tij të publikuar më 14 tetor 2009, Komisioni Evropian vendosi të propozojë hapjen e negociatave për aderimin e Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian. Vendimi u miratua në bazë të përparimit të bindshëm të arritur dhe punës së konsiderueshme të prioritetit të reformave kryesore, të njohura si përcaktimet 8+1 dhe veçanërisht plotësimi i kriterëve politike të Kopenhagës.

Çdo shtet që do të bëhet anëtar i plotfuqishëm i Unionit Evropian, qëllimin e vet e shpreh me parashtrimin e kërkesës për anëtarësim të cilin ia dorëzon Këshillit të Unionit Evropian. Këshilli e obligon Komisionin Evropian që ta vlerësojë aftësinë për plotësimin e kriterëve dhe të kushteve për qasje të shtetit në UE.

Kriteret të cilat çdo vend doemos duhet t'i plotësojë janë të njohura si Kriteret e Kopenhagës, dhe mund të ndahen në politike, ekonomike dhe administrative. Në lidhje me kriteret politike bëhet fjalë për stabilitetin e institucioneve të cilat do të garantojnë demokraci, sundimin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

Kriteret të cilat i miratoi Këshilli i Evropës në Mbledhjen në Kopenhagë në vitin 1993 përfshijnë edhe ekzistimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut, përkatësisht të ketë mundësi të ballafaqohet me shtypjen e tregut dhe rregullat ekonomike evropiane, përkatësisht të ballafaqohet me shtypjen e konkurrencës dhe fuqive të tregut brenda Unionit. (kriteret ekonomike).

Parakusht i domosdoshëm në procesin e hyrjes është miratimi i strategjisë parahyrese qëllimi i së cilës është ta përgatisë vendin për anëtarësimin e ardhshëm. Strategjia parahyrese përfshin dokumente dhe mekanizma të shumta siç janë marrëveshja për bashkim, marrëveshja për stabilizim dhe hyrje, marrëveshjet ekonomike dhe konventat, partneriteti evropian, ndihma parahyrese, bashkëfinancimi nga institucionet financiare ndërkombëtare, pjesëmarrja në programet e UE, në punën e agjencive të UE, miratimi i programit nacional për miratimin e normativës evropiane dhe raporte për përparim kah dialogu politik.

Hapi i parë në procesin e bisedimeve është i ashtuquajtur screening, përkatësisht shqyrtimi analitik dhe harmonizimi i normativës së vendit kandidat me normativën e UE. Screeningu zbatohet sipas kapitujve tematikë, ndërsa në bazë të raportit pozitiv për përfundimin e screeningut për çdo kapitull më tej hapet procesi i negociatave. Atij i paraprin përcaktimi i pozitave negociuese të vendit kandidat.

Komisioni Evropian në vazhdimësi e informon Këshillin e Unionit Evropian dhe Parlamentin Evropian për përparimet në procesin e negociatave, ndërsa raportet e vendit kandidat i shërbejnë si udhëzim i veçantë për kualitetin e përgatitjes për anëtarësim në UE. Gjatë negociatave vendet candidate fitojnë ndihmë nga UE që t'u mundësojë më lehtë ta arrin nivelin e zhvillimit ekonomik të Unionit.

Kur negociatat për të gjitha kapitujt do të përfundojnë, Këshilli i Unionit Evropian dhe vendet candidate, në bazë të konkluzioneve të negociatave, së bashku formulojnë propozim-marrëveshje për hyrje në Unionin Evropian.

Propozim-marrëveshja doemos duhet të marrë mendim pozitiv nga ana e Komisionit Evropian dhe përkrahje të njëzëshme nga Parlamenti Evropian para se t'u jepet për ratifikim vendeve anëtare të Unionit Evropian. Pas mbarimit të procesit të ratifikimit të marrëveshjes për hyrje në të gjitha vendet anëtare, vendi kandidat bëhet anëtare e plotfuqishme e Unionit Evropian.

• **Diplomacia ekonomike**

Raportet miqësore dhe gatishmëria e Maqedonisë së Veriut për të mirëpritur investimet Kineze është shprehur qartë në vitin 2017 kur ish-presidenti Gjorge Ivanov deklaronte se Maqedonia e Veriut kishte nevojë për Kinën, po aq sa kishte nevojë edhe për BE-në.

Ballkani është udhëkryq dhe pikëtakim ku gjatë historisë janë takuar shtete dhe perandori. Ky rajon ka një pozitë të veçantë përmes së cilit shtete kanë synuar të realizojnë interesat e tyre politike, ekonomike ushtarake apo edhe gjeopolitike. Andaj, çdo herë është synuar që Ballkani të kontrollohet nga superfuqi si Rusia, Perandoria Osmane, Austria, ish BRSS, ShBA apo edhe BE. Por, vitet e fundit, disi heshtur, ndikimin në rajon e ka shtrirë, një superfuqi tjetër botërore. Një ndër to është Kina.

Ndikimi i Kinës në Ballkan është i fokusuar kryesisht në aspektin ekonomik. Kjo qasje është në përputhje të plotë me objektivat e saj strategjike, ku ekspansioni ekonomik identifikohet si prioriteti kryesor. Andaj, objektivë e politikës së jashtme Kineze në të gjithë botën është ajo që njihet si “Diplomacia e Investimeve në Tregti” (Trade Investment Diplomacy). Kjo strategji zbatohet edhe në vendet e Ballkanit.

Në fakt, qasja e Kinës ndaj Ballkanit është dualiste. Nga njëra anë Kina zhvillon politikë unilaterale me shtetet e Ballkanit, përjashtoj Kosovën. Por, nga ana tjetër Pekini ka ndërtuar një platformë regjionale të njohur si “16+1”. Kjo ka si qëllim intensifikimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit me 11 vende anëtarë të BE-së dhe 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Natyra e investimeve është e fokusuar kryesisht në infrastrukturë: ndërtim autostradash, ndërtim urash, ngritje të kapaciteteve energjetike dhe shfrytëzim portesh detare. Vendi me më së shumti investime deri me tani është Serbia. Këtu përfshihen hekurudha e shpejtësisë së lartë me gjatësi 350 km në mes të Budapestit dhe Beogradit, qëllimi i të cilit është lidhja me portin Piraeus i cili nga grekët, që nga kohërat antike, konsiderohet si “metaforë për Greqinë”. Kina gjithashtu është duke investuar në Beograd në ndërtimin e një ure mbi Lumin Danub në vlerë prej 160 milion USD dhe i ka dhënë kredi Serbisë për ndërtimin e kapaciteteve elektrike në vlerë prej 700 milion EUR.

E njëjta qasje, edhe pse në përmasa më të vogla, është përdorur edhe sa i përket Maqedonisë së Veriut. Investimi më i madh është në dy projekte rrugore nga Shkupi-Stip dhe nga Kicovo-Ohër, për realizimin e të cilës Kina i ka dhënë hua Maqedonisë 580 milion EUR. Përveç kësaj, rreth 500 milion EUR janë destinuar për projektin që lidhet me Iniciativa e “Rrugës së Re të Mëndafshit” (New Silk Road Initiative). Raportet miqësore dhe gatishmëria e Maqedonisë së Veriut për të mirëpritur investimet Kineze është shprehur qartë në vitin 2017 kur ish-presidenti Gjorge Ivanov deklaronte se Maqedonia e Veriut kishte nevojë për Kinën, po aq sa kishte nevojë edhe për BE-në.

Raportet më të vjetra me Kinën nga shtete e rajonit i ka Shqipëria. Ato datojnë që nga vitet e 70-ta ku lideri Enver Hoxha, për shkak të afërsisë ideologjike, kishte krijuar “raporte vëllazërore” me Kinën Maoiste. Megjithatë, kjo marrëdhënie “romantike” ishte ndërprerë në vitet e 80-ta ku Hoxha kishte akuzuar udhëheqjen Kinezë se kishte marrë “rrugën revizioniste”.

Bashkimi Evropian është dhe mbetet investuesi dhe donatori kryesor në Ballkanin Perëndimor. Si pjesë e Instrumentit për Ndihmë të Para-Anëtarësimit (IPA), në 2018 për këto vende BE ndau rreth 1.1 miliard dollarë. Në anën tjetër, vullneti i qytetarëve të këtyre vendeve, dhe i politikanëve gjithashtu, është që të përfshihen në procesin integruar. Megjithatë, vitet e fundit në lojë janë futur edhe aktorë tjerë global të cilët janë duke shtrirë ndikimin e tyre në këtë rajon dhe në këtë mënyrë gradualisht janë shndërruar në konkurrent serioz për BE-në në rajon. Por, a është Kina alternativë e BE-së për këto vende? Kjo mbetet të shihet në vitet në vijim. Në fakt, kjo më shumë varet nga qasja që BE-së do ketë ndaj Ballkanit, në këto kohë të turbullta edhe për vetë BE-në.

Në zgjedhjet e fundit që u mbajtën në Bashkimin Evropian, numri i partive të ekstremit të djathtë dhe atyre populiste u rrit dukshëm, edhe pse jo në masë aq të madhe sa ka qenë shqetësimi në disa nga shtetet e BE. Megjithatë, këto forca politike dolën të parat në dy shtete të rëndësishme të BE-së si Franca dhe Italia. Rezultati i këtyre zgjedhjeve për Parlamentin Evropian dhe formimin e institucioneve të reja të BE-së, është jetik për orientin strategjik dhe të ardhmen e organizatës. Aktualisht BE ka mospajtime të thella brenda saj rreth disa nga temat kryesore siç janë: politika e migrimit, politika e zgjerimit, apo ajo fiskale. Në anën tjetër, raportet me partnerin e saj strategjik, ShBA-në, janë komplikuar. Kjo nuk ka ndodhur vetëm për fajin e BE, por edhe për shkak të qasjes jo-konvencionale dhe të paparashikueshme të presidentit Trump. Në të njëjtën kohë, ndikimi i aktorëve të jashtëm si Kina dhe Rusia është rritur ndjeshëm saqë Kancelarja Angela Merkel deklaroi se Evropa duhet të bashkohet për t’i rezistuar ndikimit Kinez, Rus dhe atij Amerikan. Kjo duket se do të ndikoj dukshëm që në të ardhmen vendet kryesore të BE-së të jenë më të fokusuar menaxhimin e çështjeve të brendshme dhe ballafaqimit me sfida globale, se sa në procesin integruar të rajonit.

• **Thirja për antarësim në NATO dhe hapja e bisedave për BE-në**

Kah fundi i gushtit, në organizim të shoqatës „Alumni“ të Qendrës Evropiane për Studime të Sigurisë dhe me mbështetje nga „Qendra Marshall nga Garmish Partenkirhen dhe Komanda e NATO-s nga Brukseli,¹⁴⁹ në Strugë u mbajt punëtorja ndërkombëtare në temë „Roli i NATO-s në Stabilizimin e Vendeve të Ballkanit Perëndimor: smart power approach”. Kjo është arsyeja që edhe njëherë të kthehemi në rolin e NATO-s në dërtimin e sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP), ish Jugosllavi, pa Slloveninë dhe bashkë me Shqipërinë. Lidhur me ndikimin e NATO-s në këtë rajon është shkruar dhe thënë shumë. Ekzistojnë mendime të ndryshme mbi rolin e Aleancës, disa janë pozitive disa të tjera janë kritike. Mirëpo, në një gjë të gjithë dakordohen, NATO akoma ka punë të pambaruar në Ballkan. Nga njëra anë ende ka vende-aspirante të cilat presin të integrohen në Aleancë, ndërsa nga ana tjetër NATO zbaton operacione për mbështetje të paqes në këtë pjesë të Evropës, që nënkupton se rajoni është plotësisht i stabilizuar. Në këtë analizë do të përpiqemi, në stilin e NATO-s, me një qasje të zgjuar drejt

¹⁴⁹ <https://vlada.mk/node/20241?ln=sq>

punëve, të japim përgjigje për disa nga sfidat me të cilat ballafaqohet Aleanca në rajon, i njohur si Ballkani Perëndimor nga BE-ja, term që është pranuar nga Aleanca QASJA RAJONALE E NATO-S DREJT SHTETEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR Me pranimin e programit Partneritet për Paqe (PpP), Aleanca zhvillon marrëdhënie dypalëshe me vendet-pjesëmarrëse. Kjo qasje u u aplikua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor – anëtare të PpP, deri në Samitin e Uashingtonit në vitin 1999. Megjithatë, pas krizës në Kosovë, dimensionin rajonal u shtua në qasjen individuale nëpërmjet lansimit të Nismës së NATO-s për Evropën Juglindore (EJL), e cila inkadroi edhe shtetet-anëtare të cilat në atë kohë nuk ishin anëtare të Partneritetit për Paqe (Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Serbinë dhe Malin e Zi). Krahas kësaj nisme, në Samitin e Uashingtonit Aleanca shpalli edhe Planin Aksional për Anëtarësim (PAA) në të cilin, poashtu, ishin përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë nismë u përfshinë edhe disa shtete të cilat në atë kohë nuk kishin bashkëpunim institucional me NATO-n, BeH dhe Kroacinë. Në këtë mënyrë NATO vendosi bashkëpunim me të gjitha shtetet e rajonit, përveç RFJ-së së atëhershme, e cila u përfshij më vonë në këtë nismë. Ndryshimet demokratike në Serbi dhe Kroaci që ndodhën në vitin 2000 patën ndikim pozitiv për të gjithë rajonit. Ambienti i ndryshuar politik hapi mundësi për aktivitete dhe nisma të reja me qëllim të përmirësimit të sigurisë në rajon. Kjo nënkuptonte p-romovimin e projekteve të reja, apo, ripërtirje të disa nismave të vjetra me programe të reja specifike, duke synuar paqen, bashkëpunimin, stabilitetin dhe sigurinë afatgjate në rajon. Shembull i mirë për këtë lloj bashkëpunimi ishte formimi i SEEGRUP si një instrument për zhvillim të qasjes rajonale në çështjet kyçe dhe për koordinim të projekteve rajonale. Ky grup funksiononte në parimin e marrjes së presidencës me rotacion midis vendeve pjesëmarrëse. Në takimin e ministrave për punë të jashtme të vendeve-anëtare të kësaj nisme, më 29-30 maj 2001, në Budapest, është sjellë Dokumenti për vlerësim të përbashkët të mundësive dhe sfidave rajonale të sigurisë në Evropën Juglindore (SEECAP). Dokumenti është i rëndësishëm për shkak se pjesëmarrësit në proces u dakorduan se „nuk ekziston rrezik i drejtëpërdrejtë nga agrsione ushtarake drejt sovranitetit kombëtar, integritetit territorial apo pavarësisë politike” midis vendeve të EJL-së. Ky dokument ka shërbyer si bazë për përgatitje të vlerësimeve individuale mbi kërcënimet e shteteve të rajonit dhe është bazë për reformat në sektorin e sigurisë në rajon. Kur është promovuar nisma, dimensionin i saj rajonal ka nënkuptuar që të gjitha aktivitetet të realizohen në vendet e rajonit me ndihmë politike dhe eksperte nga NATO. Aktorët e jashtëm dëshironin të sigurohen se ndihma e tyre do të shfrytëzohet për përmirësimin e kapaciteteve të vendeve të rajonit për bashkëpunim të ndërsjellë. Ky qëllim realizohej nëpërmjet mbajtjes së aktiviteteve, si që janë punëtori në tema të cilat janë me interes për vendet e rajonit, me qëllim të avancimit të stabilitetit nëpërmjet bashkëpunimit dhe integritetit rajonal. Përveç kësaj janë zhvilluar edhe nisma dhe projekte tjera: studim krahasues për strategjitë e sigurisë kombëtare në EJL (SEESTADI); për shkëmbim të personelit i cili punon në sigurinë kufitare në EJL (SEESTAF); për shkëmbim të informacioneve ushtarako politike dhe të tjera për paralajmërim të hershëm dhe parandalim të konflikteve (SEECHEING); promovim të bashkëpunimit civilo-ushtarak në menaxhmentin e sigurisë (SEEMAG); për konspekt të masave antiterroriste në EJL etj. Mund të konstatojmë se Nisma e NATO-s për EJL dhe produktet e saja më të rëndësishme SEECAP dhe SEEGRUP, kanë dhënë substanca të reja në formën e bashkëpunimit rajonal dhe, gjithashtu, kanë dhënë kahje të reja në zhvillimin e këtij bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor dhe në këtë mënyrë kanë kontribuar në reformat në sektorin e sigurisë në rajon. Megjithatë, pas

Samitit të NATO-s në Bukuresht, vëmendja e NATO-s u drejtua në rajone tjera krize, (botën arabe dhe Lindjen e Largët), kështu që u krijua përshtypja se ky rajon ngeli jashtë vëmendjes së Aleancës. Në rajon, edhe pse nuk janë aktuale kërcënimet ushtarake ndaj sigurisë, ai akoma është i brishtë dhe delikat dhe meriton vëmendjen e NATO-s, dhe do të ngelë kështu deri në integrimin e plotë në kuadër të institucioneve Euroatlantike. **PLANI AKSIONAL PËR ANËTARËSIM** Instrument i ardhshëm që shfrytëzohet nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, aspirantë për anëtarësim në NATO, është Plani Aksional për Anëtarësim. Kur në vitin 1997 në Samitin e Madridit NATO ftoi tri vendet aspirante (Poloninë, Hungarinë dhe Çekinë) t'i bashkangjiten Aleancës në zgjerimin e parë pas luftës së ftohtë, ajo u ballafaqua me vështirësi të mëdha gjatë përshtatjes me procedurat në organizatën e re. Kjo ishte arsyeja që detyroi Aleancën në Samitin e ardhshëm në Uashington, kur vendet e ftuara edhe formalisht u bënë pjesë e organizatës, për të paraqitur këtë plan. Plani Aksional për Anëtarësim mundëson të gjithë vendet e interesuara për anëtarësim ta bëjnë këtë në bazë të rezultateve të cilat do t'i arrijnë. Elementet kyçe të Planit Aksional për Anëtarësimi janë: programet kombëtare vjetore të cilat do t'i mbulojnë aspektet politike, ekonomike, mbrojtëse, të sigurisë dhe të drejtësisë të përgatitjeve për anëtarësim; mekanizmat kthyesë me të cilat do të konstatohet progresi në përgatitjet, përfshirë këshillimet politike dhe teknike, si dhe vlerësime të cilat i jep Këshilli i Atlantikut të Veriut; Procesi Kliringhaus që koordinon ndihmën nga NATO dhe vendet-anëtare dhe përforsimin e planifikimit të mbrojtjes, që në vete përfshin edhe analizën e realizimit të qëllimeve të planifikuara të dakorduara, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me përgatitjet ushtarake të vendeve aspirante për anëtarësim. Edhe pse ky plan në kohën kur u promovua nuk ishte i menduar vetëm për vendet e Ballkanit Perëndimor, me pranimin e shtatë vendeve nga Grupi Vilnius dhe dy aspirantët nga Grupi i Adriatikut (Kroacia dhe Shqipëria) në anëtarësimin e Aleancës, ai mbeti si manifestim praktik i politikës së dyerve të hapura dhe një instrument nëpërmjet të cilit do të matet shkalla e progresit të shteteve tjera aspirante (Maqedonia, Mali i Zi dhe BeH) në rrugën e tyre për anëtarësim në NATO. Mirëpo, kjo vegël e NATO-s humb rëndësinë e saj për disa arsye. Së pari, R. e Maqedonisë përfundon ciklin e 14-të të Planit Aksional, që shpjen në një lodhje të caktuar të administratës, si në Maqedoni ashtu edhe në NATO, veçanërisht pas Samitit në Bukuresht dhe konstatimit se shteti i përmbush të gjitha kushtet për anëtarësim. Së dyti, pjesëmarrja e BeH në këtë program është kushtëzuar me një progres të caktuar në reformat vendore (shteti ka marrë ftesë të kushtëzuar për anëtarësim). Më tej, Serbia, për shkak të gjendejes së politikës së brendshme akoma nuk ka kërkuar të jetë pjesë e këtij plani, ndërsa Kosova ende nuk është njohur si një shtet i pavarur nga disa anëtare të Aleancës të cilat kërcënohen se do të bllokojnë çdo tentim për përfshirjen e saj. Dhe, kështu, në fund rezulton se vetëm Mali i Zi është pjesëmarrës aktiv në këtë program të NATO-s. Nëse merren parasysh performansat e Malit të Zi si një shtet dhe procedura e ndërlikuar për ratifikim të pranimin në vendet-anëtare, atëherë nuk habit vendimi i NATO-s që në samitin që duhet të mbahet vitin e ardhshëm mos të diskutohet për zgjerim. Marrë parasysh problemet me të cilat ballafaqohen vendet e Ballkanit Perëndimor dhe problemet akoma të pazgjidhura midis disa prej tyre, ka hapësirë të mjaftueshme për NATO-n të intensifikojë dhe të zgjerojë aktivitetet e saja në këtë rajon. Një element i angazhimit të këtillë duhet të jetë mbështetja e përforsuar e bashkëpunimit rajonal. Sfidë për NATO-n do të jetë gjetja e hapësirës politike ku do të mund të zhvillohen organizatat rajonale dhe sigurohet mbështetja politike dhe materiale për të ngritur këtë

bashkëpunim në maksimale. REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE NATO Në raport me Aleancën e Atlantikut të Veriut, Republika e Maqedonisë, fill pas pavarësimit ka shprehur interesin e saj për anëtarësim në NATO. Këtë përcaktim R. e Maqedonisë e manifeston edhe sot. Pra, në këtë mënyrë, gjatë krizës në Kosovë, Maqedonia sillej si „de fakto“ anëtare e NATO-s. Në tetor, 1998, Qeveria e R. së Maqedonisë solli vendim përmes së cilit u krijua Qeilza e NATO-s në RM, e cila shërben fluturaket e NATO-s. Më vonë Aleanca formoi Forca për nxjerrjen e nxjerrjen e verifikuesve të OSBE-së nga Kosova, ndërsa Qeveria e RM, gjithashtu, dha pëlqim për stacionimin e tyre në vend. R. e Maqedonisë formoi Qendër për Mbështetje të Forcave të NATO-s të cilat janë të angazhuar në Kosovë, me çka e lehtëson furnizimin e tyre logjistik. Dhe së fundi, Armata e RM merr pjesë aktive në misionin ISAF në Afganistan, të udhëhequr nga NATO, me çka konkretisht kontribuon drejt sigurisë euroatlantike. Republika e Maqedonisë, gjithashtu, mbështet qasjen rajonale të NATO-s drejt, fillimisht stabilizimit, e më pas integritetit të vendeve nga BP në Aleancë. Ajo është pjesë e Nismës së NATO-s për EJT dhe merr pjesë aktive në përgatitjen e SEECAP dhe të aktiviteteve të SEEGRUP në fushën e pralajmërimit dhe prandalimit të hershëm të konflikteve dhe menaxhimit me kriza. Nga ana tjetër, prania dhe interesi i NATO-s për sigurinë dhe stabilitetin e Maqedonisë është dëshmuar nëpërmjet disa shembujve. Gjatë krizës në Kosovë NATO u detyrua, gjë që nuk është e zakonshme për një vend-anëtar të PpP, se do të ruajë integritetin territorial dhe sovranitetin e RM-së në rast se paraqiten kërcënime për të. Më pas, në konfliktin e vitit 2001 Aleanca u angazhua në zgjidhjen e tij, fillimisht në vendosjen e armëpushimit, dhe më pas përmes disa misionëve të veta („Korja e Domosdoshme“, „Dhëlptra Qelibare“ dhe „Harmonia Aleate“) në grumbullimin e armëve dhe ndërtimin e paqes pas konfliktit. Ky interes i NATO-s për RM stabile dhe të sigurtë shprehet përmes pranisë së Ekipit Këshilldhënës të NATO-s në Ministrinë e Mbrojtjes së RM dhe lidhjeve që kjo ministri i mirëmban me KFOR-in lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kufitare. Pas pesë viteve pritje të pasuksesshme para portave të NATO-s, dhe pas përmbushjes së kushteve për anëtarësim, është logjike të parashtrohet pyetja se a duhet R. e Maqedonisë edhe më tej, me një numër të konsiderueshëm ushtarësh të marrë pjesë në misionet e NATO-s. Pajtohem me ata të cilët thuajnë se duhet të merret pjesë në përpjekjet ndërkombëtare për ndërtim të sigurisë. Por, për ne, pjesëmarrja me një numër të konsiderueshëm të ushtarëve në raport me kapacitetet tona nuk do të na sjellë ftesën e dëshiruar për anëtarësim në NATO. Ftesa do të vijë pasi që do të zgjidhet kontesti i imponuar nga Greqia lidhur me emrin tonë. Nga kjo, me të drejtë disa e shtrojnë pyetjen a duhet shteti edhe më tej të ndajë mjete plotësuese për pjesëmarrje të ARM-së në këto misione të NATO-s. Unë nuk angazhohem për të përfunduar këtë angazhim, por angazhohem të rishqyrtohen mjetet që shteti i ndan për këto qëllime, veçanërisht nëse janë të vërteta spekulimet se për shkak të gjendjes së keqe ekonomike në vend dhe rrogave të ulëta të nëpunësve ka aplikime masive për pjesëmarrje në këto misione, që krijon mundësi për korrupsion në rrethet që i caktojnë pjesëmarrësit në misione. Ndoshta do të ishte më mirë këto para të shfrytëzohen për përmirësimin e standardit të të punësuarëve në ARM dhe për furnizimin e Armatës, ndërsa shteti të përqëndrohet në pjesëmarrjen në misione të OKB-së ku merr kompensim financiar të caktuar për pjesëmarrjen tonë.¹⁵⁰

KAPITULLI IV

- Rezultatet e Anketimit te 50 respondentëve

Pyetësor

I nderuari respondent, jam student në studimet e magjistraturës pranë Universitetit të Evropës Juglindore, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore në programin e studimeve të Diplomacisë Publike.

Qëllimi i këtij pyetësi është që të më ndihmoni për një hulumtim më të saktë rreth punimit tim me temë: **“Analizë Krahimore e Ndikimeve Shoqërore – Politike të Diplomacisë Perëndimore në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”**. Do të jem shumë mirënjohës nëse mund të merrni disa minuta për të plotësuar këtë pyetësor. Përgjigjet e juaja janë shumë të rëndësishme .

Faleminderit paraprakisht për ndihmën tuaj!

Gjinia :

- | | |
|-------------------------|-----|
| ☐ M | 58% |
| ☐ F | 42% |

Mosha :

- | | |
|-----------------------------|-----|
| ☐ 20-30 | 27% |
| ☐ 31-46 | 45% |
| ☐ 47-64 | 28% |

Kombësia :

- | | |
|--------------------------------|------|
| ☐ Shqiptar | 100% |
|--------------------------------|------|

- Maqedonas
- Të tjerë

Niveli I Edukimit :

- I mesëm 41%
- Bachelor 39%
- Master /PhD 20%

Vendbanimi aktual:

- Qytet 58 %
- Fshat 42%

Cili është profesioni juaj ?

Për cilat nga këto arsye ka qenë e angazhuar Diplomacia Perendimore në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut?

- | | |
|---|------|
| ○ Korupcioni | 35% |
| ○ Lufta për pushtet në mes pozitës dhe opozitës | 60% |
| ○ Ngërçet politike në politikat e Jashtme | 05 % |

A mendoni se ndërhyrja ushtarake e NATO-s bëri ndryshimin më të madh ne historin e Ballaknit Perëndimor, konkretisht ne Kosovë gjatë viteve 1999-2000 ?

- Po 90%
- Jo 05 %
- Nuk e di 05%

A mendoni se qëndrimi i UNMIK-ut në veri të Kosovës pas shpalljes së Pavarësisë e ndihmonte shumë Serbia me strukturat e saj shtetërore?

- Po shumë 32%
- Pak 15%
- Aspak 29%
- Nuk e di 24%

A duhet të dënohet gjenocidi i bërë në Kosovë nga forcat Serbe me 1998-99 nga Bashkësia Nderkombëtare ?

- Po 100 %
- Jo
- Nuk e di

Si i vlerësoni bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për njohjen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur ?

- Shumë të rëndësishme 100%
- Pak të rëndësishme
- Aspak të rëndësishëm
- Nuk e di

A mendoni se në Republikën e Mqedonisë së Veriut u zbatua i gjithë dokumentacioni i Marveshjes Korniz të Ohrit ?

- Mendoj se po 42%
- Mendoj se duhet ende të punohet në këtë drejtim 40%
- Mendoj se aspak nuk u zbatua kjo marveshje 8%
- Nuk e di 10%

A ishte Marveshja e Përzhinos ajo që e çoj vendin drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s ?

- Po ishte Marveshje e qëlluar 85%
- Jo nuk duhej te ndodhë kjo marveshje 5%
- Nuk e di 10%

A ishte e kushtëzuar Maqedonia nga Greqia për ndryshimin e emrit të shtetit nga Republika e Maqedonisë në atë Republika e Maqedonisë së Veriut ?

- Po ishte e kushtëzuar 90%
- Jo, ajo ka qenë politikë e kushtëzuar nga shtetet e BE-së 5%
- Nuk kam njohuri 5%

Çfarë mendimi keni për zgjedhjet e 12 prillit , a do të jenë vendimtare që Maqedonia e Veriut të jetë antare e 30 e familjes së madhe Europiane ?

- Shumë besoj se do e çojnë vendin deri BE-së 75%
- Mendoj se pak do kenë rëndësi këto zgjedhje 5%
- Aspak nuk do luajnë rol të rëndësishëm në politikat e Jashtme të vendit 10%
- Nuk kam aspak njohuri rreth kësaj çështje 10%

- Intervista me 3 Diplomate të huaj dhe 2 funksionarë të Minsitrisë të punëve të jashtme dhe 1 ekspert- profesor

Intervista

Intervistë për tezë magjistrature

“Analizë Krahimore e Ndikimeve Shoqërore – Politike të Diplomacisë Perëndimore në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”

1. Si mendoni se pse veproi diplomacia perendimore në Ballkanin Perëndimor duke u nisur nga rasti I Kosovës deri te Maqedonia e Veriut ?

Faktori ndërkombëtarë e ka më se të qartë se procesi i integritit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE është një mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar dhe se në këtë Rajon konfliktesh Paqja afatgjate mund të arrihet vetëm përmes integritit në BE.

Andaj kushti elementar i integritit në BE është stabiliteti i qëndrueshëm nga vet shtetet pretendente dhe politika paqësore koegzistuese e fqinjësisë së mirë. Në të kundërtën do të vazhdojnë pasiguria dhe jostabiliteti rajonal si barrë e rrëndë dhe pikë e zetje e diplomacisë perendimore.

2. Sa e vlerësoni ndikimin e Diplomacisë Perëndimore pas luftës së Kosovës të vitit 1999?

Praktikat e ndjekura në rastin e shpërbërjes së Jugosllavisë treguan se diplomacia ndërkombëtare jo vetëm rezultoi e pasuksesshme në përpjekjen e saj për të prodhuar konsensus midis palëve në konflikt, por ajo pati një ndikim të ndjeshëm, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, në përshkallëzimin e konfliktit midis serbëve dhe shqiptarëve.

Diplomacia perendimore në zgjidhjen e aspektit normativ të shpërbërjes së Jugosllavisë dështuan në zgjidhjen e shumë çështjeve, të cilat më pas iu shtuan shkaqeve të konflikteve në Bosnje, Kosovë dhe Maqedoni. Ajo e kufizoi parimin e vetëvendosjes duke vendosur rregulla që favorizonin vetëm Republikat si shtete pasuese të Jugosllavisë duke i shmangur Krahinat autonome të RSFJ me kushtetutën e 1974.

Meqë faktori politik shqiptar, brenda dhe jashtë Kosovës, për çështje vitale shpesh herë nuk ishte unik dhe në krye të detyrës, Diplomacia perendimore binte nën ndikimin e politikës perfide serbe dhe dorës së fortë Ruse.

3. Si implemntohet në Kosovë Marrëveshja e Rambujesë?

Si Iniciues të konferencës, që zgjati deri më 23 shkurt, ishte Grupi i Kontaktit, ndërsa ndërmjetës ishin Kristofer Hill nga SHBA-të, Boris Majorsri, Rusia dhe Volfgan Petriq nga BE.

Përpyjekja e fundit përpara së të shpërthente lufta ishte Konferenca e Paqes në Rambouillet 1-mars 1999. Diplomacia parandaluese ishte etapa vijuese, e cila përmbylli përpjekjet e diplomacisë ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për çështjen e Kosovës, përpara ndërhyrjes ushtarake të trupave të NATO-s. Delegacioni i Kosovës kishte pranuar parimisht propozim-marrëveshjen për zgjidhjen e krizës në Kosovë, të cilën e kishte propozuar Grupi i Kontaktit, ndërsa Delegacioni serb, sado që parimisht pranoi këtë propozim-marrëveshje, mbrojti qëndrimin që trupave të NATO-s të mos u lejohet kalimi nëpër Serbi dhe forcat ndërkombëtare në Kosovë të jenë në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

Edhe rrethi i dytë i bisedime që filloi më 15 mars në Paris përfundoi pa sukses. Delegacioni kosovar dhe ai serb kishin nënshkruar më 18 mars marrëveshje të ndryshme. “Delegacioni i Kosovës kishte nënshkruar marrëveshjen e ofruar nga bashkëbiseduesit ndërkombëtarë, ndërkohë që delegacioni serb kishte nënshkruar projekt-marrëveshjen politike- marrëveshjen për vetëqeverisjen në Kosovë.”.As tentimi i fundit, më 22 mars 1999 i të dërguarit special të SHBA-ve, Riçard Hollbruk nuk ishte i suksesshëm. Ai nuk ia doli ta bind presidentin e atëhershëm të RSFJ, Slllobodan Millosheviq që të pranoj marrëveshjen për Kosovën dhe vendosjen e trupave ndërkombëtare.

Më 24 mars 1999, NATO filloi bombardimin e trupave ushtarake dhe paramilitare të Serbisë. Bombardimet përfunduan më 6 qershor 1999 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës që parashihte tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova dhe vendosjen e trupave paqësore ndërkombëtare. Më pas, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën 1244 me të cilën u vendos protektorati, prania ndërkombëtare në Kosovë, UNMIK-ut si mision civil dhe KFOR-it, mision ushtarak. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë. Rrjedhimisht për cilën Marrëveshje të Rambujes po pyetni?

4. Cili është roli i NATO dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Kosovë ?

Me krenari dhe knaqësi të veçantë shqiptarët anë e kënd Botës, jo vetëm ata të Kosovës, kujtojnë ditë e 24 marsit historik të kombit dhe të rajonit tonë. Ndërhyrja mund të cilësohet si një qëndrim dhe veprim moral i Bashkësisë Ndërkombëtare dhe aktorëve të saj kryesorë si Shtetet e Bashkuar të Amerikës dhe NATO-s për mbështetjen që iu dha shqiptarëve. Ky akt fillimisht e bëri të lirë Kosovën dhe më pas shtet të pavarur. E drejta ndërkombëtare kërkon diskutime, konsensus dhe kohë të gjatë për të vendosur për ndërhyrje ushtarake. Në Kosovë ndërhyrja e NATO-s u bë në emër të së drejtave njerëzore të mbështetura tek e drejta kombëtare dhe pasi kishin shteruar të gjitha rrugët e tjera diplomatike për zgjidhjen e problemeve të shkeljeve të të drejtave njerëzore. Roli ishte çlirues dhe krijimi i kushteve për vendosjen e bazamentit të shtetit juridik dhe demokratik.

5. Cili është roli i Diplomacisë Perëndimore në ngërçet politike në Maqedoninë e Veriut ?

Nëse mendoni në JO-në negative të Unionit European për fillimin e hapjes së negociatave ajo ishte Jo fatkeqe për vet autoritetin e UE, lindje e mosbesimit të parimet e saja dhe humbja e

vlerave demokratike të qytetërimit Perendimor në veçanti dhe ishte goditje e rëndë dhe dush i ftoftë për të gjithë shtetet e Ballkanit Perendimor. Fatmirsisht muajn mars u ringjallën shpresat për RMV dhe RSH me vendimin për hapjen e fillimit të bisedave me këto dy vende candidate. Ajo njëherit ka luajtur rol shumë të rëndësishëm dhe konstruktiv në tejkalimin e mosmarveshjeve si në planin e mbrendshëm shtetëror por edhe në atë të jashtëm fqinjësor.

6. Qëndrimi i Diplomacisë Perëndimore lidhur me formimin e një partie politike proruse në Maqedoninë e Veriut dhe ndikimit rus në mediat ?

Sipas shumë analistëve politik “Rusia, në betejën globale me Perëndimin për mbizotërimin në Ballkan, duket se i drejton në ndërlikimin e situatave në Ballkan, gjegjësisht në ruajtjen e tensionit politik dhe jo-stabilitetit para së gjithash përmes fuqisë së mbështetjes së forcave nacionaliste në rajon, partive autoritare dhe udhëheqësit që i konsideron për dorën e saj të zgjatur edhe përmes krerëve dhe priftërinjve të kishave pro-ruse.” Është fakt që interesi i Rusisë ishte ta mbajë Maqedoninë sa më larg NATO-s dhe BE-së.

Moska ndoshta nuk mund ta falë Maqedoninë e Veriut për hapin e bërë radikal drejt anëtarësimit në NATO, por me siguri do të bëjë gjithçka për të ndikuar në zgjedhjet e ardhshme në Maqedoni.

Vite me radhë u pa se cila oligarki politike e vendit tonë, me veprimet konkrete anti Perëndimore, e çonte ujin në mullirin e politikës së Moskës, për çka edhe u shpërblyen nga ajo.

7. Roli i Diplomacisë Perëndimore në procesin e fillimit të bisedimeve ndërmjet EU dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut ?

Në procesin e pranimit Euro-Atlantik, bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, veçanërisht nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës Maqedonia e Veriut u ballafaqua me JO-në e BE-së të hidhur dhe "të turpshme". Konsideroj si shumë diplomat perendimor se UE lëviz me hapa shumë të ngadalt integrimin e Ballkanit Perendimor e në veçanti për Republikën e Maqedonisë Veriore e cila e meritonte hapjen e bisedave të pranimit sepse ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj dhe madje ka dhënë më shumë sesa rekomandimet e parashikuara. Edhe komesari Han potencoi se ky vendim nuk i shërben për nder UE. Përfundimisht ajo arriti ta bind në qëndrim konsensual edhe Francën se RMV me plot meritë duhet të i hapë bisedat e aderimit në UE.

8. Gati dy decenje nga Marveshja Korniz e Ohrit si pas mendimit tuaj cilët janë efektet reale të sajë ?

Dokumenti kornizë i Ohrit, që u nënshkruar më 13 gusht të vitit 2001, duhej të zbatohet brenda katër vjetësh. Ky dokument, në bazë kishte avancimin e të drejtave të shqiptarëve, përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe si dhe përfaqësimin e shqiptarëve në institucionet shtetërore.

Që prej nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, Maqedonia e Veriut ka avancuar në masë të theksuar kërkesat e shqiptarëve, por njëkohësisht janë evidentuar edhe ngecje në zbatimin praktik të normave ligjore që burojnë nga ky dokument. E rëndësishme është që të vazhdojë të mbizotërojë fryma e Marrëveshjes së Ohrit edhe në të ardhmen, shteti të funksionojë mbi konceptin shumë etnik.

Marrëveshja e Ohrit, e nënshkruar ndërmjet faktorëve politikë maqedonas dhe shqiptarë, i dha fund konfliktit të armatosur pas ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar. Marrëveshja pretendonte ndërprerjen e armiqësisë, zhvillimin e pushtetit të decentralizuar, mosdiskriminimin, përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, të drejta për arsim të lartë për shqiptarët, përdorimin zyrtar të gjuhëve për etnitet e përfaqësuara mbi 20 për qind, shprehjen e identitetit etj.

9. Efektet e Marrëveshjes së Përzahinos për qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut ?

Efektet e kësaj Marrëveshje ishin konstruktive dhe ndërkombëtarisht të vlersusra si pozitive. Ajo krijoi kushte bazike për zgjedhjet e parakohshme Parlamentare 2016 të cilat nga faktori ndërkombëtar u cilësuan si korerkte, fer dhe demokratike. Ajo i hapi rrugë Marrëveshjes së Prespës me Greqinë si dhe Marrëveshjes së fqinjësisë së mirë me Bullgarinë.

10. A mendoni se Marrëveshja e Prespës ishte zgjedhja e duhur ku Maqedonia e Veriut sot u bë anëtare e 30-të e NATO-s ?

Në vet pyetjen e parashtruar nga Ju keni edhe përgjigjen. Njëherë e përgjithmonë duhet ta kemi të qartë se Marrëveshje ideale nuk ka, meqë nuk mund të arrihet si e tillë por, intenca e saj është shpërqëndrimi i palëve nga pengesat, energjitë negative dhe destruktive dhe përqëndrimi i tyre drejt qëllimeve dhe interesave të përbashkëta. Kushtimisht thënë pa atë do të vazhdonte akoma “armiqësia” me fqinjin jugor dhe nga tjetra anë ajo shërbeu si bazë që një “armik” politik ta shëndrosh në “mik” politik.

11. Liberazimi i vizave për kosovarët një realitet apo një mollë e ndaluar ?

Edhe populli shqiptarë i Kosovës (shumë qarqe përdorin termin populli Kosovar që vetvetiu do të thotë pranim i ndasisë së tërësisë shqipëtare) e meriton lëvizjen e lire dhe të pakushtë. Mendoj që Liberalizimi, nga të gjithë subjektet relevante politike, akademike dhe opinionin e gjërë Kosovar, kërkon një politikë të moderuar dhe koordinuar që në mënyrë unike të arrijë të ndalojë efektet negative të një molle të ndaluar apo të një molle sheri përbrenda Kosovës.

08.04.2020

Ju faleminderit

KAPITULLI V

- Rekomadime dhe përfundime

1. Në Maqedoni u duhej të zgjedhin një altrenativë të përbashkët ,për të ecur të bashkuar drejt një zgjidhje sa më realiste të së ardhmes, larg demagogjisë së luftës për pushtet.
2. Situata e sotme politike ndeshet me një situatë të te paqarte , ku secili faktor i politikës pavarësisht prej demagogjisë mediatike ecën i vendosur në realizimin e egos së vetë
3. Kriza politike që ka përfishrë Maqedoninë në të gjitha sferat e saj është evidente sot në të gjitha mardhëniet institucionale e jo vetëm në mardhëeniet midis opozitës shqiptare dhe qeverisë.
4. HEndikepi i kësaj qeverie është sepse ajo nuk pranon dështimet e saj dhe mundohet tu mbush mendjen njerëzve me parada e me veprime spektakolare të cilat nuk mund ti mbulojnë realitetin dhe krizën e vërtet e cila nuk është vetëm politike por më e gjërë.
5. Të gjithë po vijnë rrotull Marrëveshjes së Ohrit .Udhëheqësit e rinj dhe të vjetër po bëjnë lloj –lloj deklaratah të cilat duken jo realiste , por përçmuese ndaj vetvetes dhe shoqërisë . Kuptohet që secila parti do të ketë diapazonin e vet ku do të punojë dhe propagandojë idetë e saj, por këto ide duhet të përcillen nga mendime që hapin perspektivë dhe jo nga fjalë shpifëse.
6. Është e njohur aksioma diplomatike sipas së cilës, kur aktorët e mëdhenj me ndikim ndërkombëtarë largojnë vëmendjen ndaj zonave të krizave, atëherë aktorët lokalë aktivizohen në mënyrën e tyre.
7. Diplomacia Perëndimore rifilloi aktivizimin e saj kur kambana e ballafaqimit Kosovë-Serbi filloi të dëgjohej në kancelaritë e tyre dhe vetëm kur diplomacisë konspirative Vuçiq – Thaçi dhe mbështetësve të tjerë lokalë u doli boja publikisht.
8. Diplomacia Perëndimore duket se nuk është më e të njëjtës vale. Përqasjet diplomatike midis BE-së dhe ShBA-së, por edhe brenda ShBA-së, lidhur me zgjidhjen e krizës Serbi-Kosovë kane diverguar në mjaft aspekte.
9. Divergimi midis BE-së dhe ShBA-së në përqasjen ndaj zgjidhjes së krizës Kosovë-Serbi ka ardhur nga ndryshimet në politiken e jashtme dhe diplomacinë e ShBA-së me shumë sesa në politiken e jashtme dhe diplomacinë evropiane.
10. Politika e jashtme dhe diplomacia e ShBA-së për zgjidhjen e krizës Serbi-Kosovë duket se nuk ka kohezionin e brendshëm midis Shtëpisë së Bardhë dhe Departamentit të Shtetit, si dhe midis Ekzekutivit dhe Legjlativit. Mesa duket faktorë të ndryshëm, lëvizje influencash dhe lobingje të shumta po ndikojnë për cenimin e kohezionit të shumë viteve më parë të politikës së jashtme dhe diplomacisë ndaj Kosovës dhe Serbisë.
11. Duket se ka faktorë diplomatikë, sidomos në Shtëpinë e Bardhë, që po tentojnë të krijojnë një fare ‘balancimi’ midis Kosovës dhe Serbisë, po mbështesin, ose së paku nuk po kundërshtojnë opsione shkëmbimesh territoriale dukshëm në favor të Serbisë dhe në dëm të Kosovës dhe paqes e sigurisë në rajon, si dhe po përpiqen ta mbyllin në mënyrë të nxituar e të pamaturuar marrëveshjen përfundimtare Kosove-Serbi.

12. Ky reagim i fuqishmen ndërkombëtar kërkon dhe mbështet njëzëri nga diplomacia Perëndimore, në BE dhe ShBA një veprim diplomatik publik, dhe është kundër veprimit diplomatik konspirativ. Diplomacia konspirative është pjellë e sistemeve përpara Sistemit e Versajës, kur monarkët, perandorët dhe princat e botës së vjetër, bënë pazare me fatet e popujve dhe në përfitim të tyre. Kjo diplomaci konspirative prodhoi zgjidhje të padrejta, të padobishme dhe shumë të dëmshme. Diplomacia konspirative injoronte popujt, legjitimitetin e tyre, paqen e sigurinë ndërkombëtare.
13. Në rastin e krizës aktuale Serbi-Kosovë për një kohë të gjatë u ballafaquan dy diplomaci: diplomacia konspirative dhe diplomacia publike. Diplomacia konspirative me rrënjët në Ballkan dhe në Lindje. Ndërsa diplomacia publike kryesisht me rrënjët në Perëndim. Krisja me shqetësuese, opinionalisht lindi nga perceptimi publik kombëtar dhe ndërkombëtar, sipas të cilit disa aktorë diplomatikë dhe lobues rreth qarqeve me ndikim në Shtëpinë e Bardhë, kanë anuar në diplomacinë konspirative Ballkanike.
14. Aktualisht në krizën Serbi-Kosovë po veprojnë tri lloje diplomacish. Diplomacia konspirative me baze lokale Serbi-Kosovë, me mbështetje të aktorëve përreth dhe frymëzim Lindor. Diplomacia publike me baza legjitime demokratike lokale dhe ndërkombëtare Perëndimore në baza në BE-ShBA. Diplomacia ambigje pragmatike dhe konjunkturale me disa baza edhe lokale dhe Perëndimore, edhe në BE edhe në ShBA.
15. Është një betejë diplomatike e paparë, e panjohur, e paparashikueshme. Nga fitorja dhe fituesi i kësaj betejë diplomatike do të varet e ardhmja e diplomacisë së re dhe nga diplomacia e re do të varet në masë të konsiderueshme edhe vet rendi i ri botëror.
16. Zgjidhja përfundimtare e krizës Kosovë-Serbi duket se do të shënojë rënien e ‘murit të fundit në Evropë’, pjesë e skenarit për dhënien fund të Luftës së Ftohtë dhe fillimit të rendit të ri botw

BIBLIOGRAFIA

1. Baldini, Gianfranco dhe Adriano Pappalardo, *Elections, Electoral*
2. *Systems and Volatile Voters* (Palgrave Macmillan, 2009).
3. Baudrillard, Jean, *Simulacra and Simulation* (University of Michigan
4. Press, 1995).
5. Beha, Adem, ‘Minority Rights: An Opportunity for Adjustment of
6. Ethnic Relations in Kosovo?’, *Journal on Ethnopolitics and*
7. *Minority Issues in Europe*; Vol 13, No 4, 2014, 85-110.
8. Berge, Benjamin vo dem, Thomas Poguntke, Peter Obert dhe Diana
9. Pipei, *Measuring Intra-Party Democracy: A Guide for the Content*
10. *Analysis of Party Statutes with Examples from Hungary, Slovakia*
11. *and Romania* (Springer, 2013).
12. Biezen, Ingrid van dhe Daniela Romee Riccio, ‘Shaping Intra-Party
13. Democracy: On the Legal Regulation of Internal Party
14. Organizations’, në William R. Cross & Richard S. Katz (ed.) *The*
15. *Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press
16. (2013).
17. Binmore, Ken, *Game Theory: A Very Short Introduction* (Oxford

18. University Press, 2007).
19. Birch, Sarah, *Electoral Systems and Political Transformation in Post-*
20. *Communist Europe* (Palgrave Macmillan, 2003).
21. Buxhovi, Jusuf, *Kthesa Historike: Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LKDs*
22. (Faik Konica, Prishtinë, 2008).
23. Cana, Zekeria, *Apeli 215 intelektualëve shqiptarë*, (Rilindja, Prishtinë,
24. Chesterman, Simon, *You, The People: The United Nations, Transitional*
25. *Administration, and State-building* (Oxford University Press, 2004).
26. (2009) 9:1-1.
27. Cocozzelli, Fred, 'Between Democratisation and Democratic
28. Consolidation: The Long Path to Democracy in Kosovo',
29. *Perspectives on European Politics and Society* (2013), 14:1.
30. Cross, William P. & Richard S. Katz, 'The Challenges of Intra-Party
31. Democracy', në William P. Cross & Richard S. Katz (ed.), *The*
32. *Challenges of Intra-Party Democracy* (Oxford University Press,
33. 2013).
34. Cross, William P. dhe Richard S. Katz (ed.), *The Callenges of Intra-*
35. *Party Democracy* (Oxford University Press, 2013).
36. Deutsch, Karl, *The Analysis of International Relations* (Prentice Hall
37. College, 1988).
38. Doudriette, Richard W. Doudriette dhe Andrew Ellis, 'A Global
39. Snapshot', në Larry Diamond dhe Marc F. Plattner (ed.), *Electoral*
40. *Sysmtes and Democracy* (The Johns Hopkins University Press:
41. Baltimore, 2006).
42. Doyle, Michael W., *Ways of War and Peace: Realism, Liberalism and*
43. *Socialism* (New York: W. W. Norton, 1997).
44. Duverger, Maurice, *Political Parties: A Behavioural Analysis* (Rand
45. McNally, 1964).
46. Duverger, Maurice, *Political Parties: Their Organization and Activity*
47. *in the Modern State* (London: Methuen, 1954).
48. (Oxford University Press, 2010).
49. *Ethnopolitics* (2009), 8:2, 223-233.
50. King, Iain dhe Whit Mason, *Paqe me çdo kusht: Si dështoi bota në*
51. *Kosovë* (KOHA: Prishtinë).
52. Knoll, Bernhard, 'Fuzzy Statehood: An International Legal Perspective
53. on Kosovo's Declaration of Independence', *Review of Central and*
54. *East European Law* 34 (2009) 361-402.
55. Kostovicova, Denisa, 'Legitimacy and International Administration:
56. The Ahtisaari Settlement for Kosovo from a Human Security
57. Perspective', *International Peacekeeping* (2008), Vol. 15, No. 5,
58. 631-647.
59. Kraja, Mehmet, *Vitet të humbura*, (Shoqata Botuese e Lidhjes së
60. Shkrimtarëve të Shqipërisë, Tiranë, 1995).
61. Kurti, Albin, 'JISB Interview: Kosova in Dependence: From Stability of
62. Crisis to the Crisis of Stability', *Journal of Intervention and*
63. *Statebuilding*, 5: 1, 2011, 89 — 97.

64. Lemay-Hébert, Nicolas, 'Coerced transitions in Timor- Leste and
65. Kosovo: managing competing objectives of institution-building
66. and local empowerment', *Democratization* (2012), 19:3.
67. Leys, Colin, 'Models, theories, and the theory of political parties',
68. *Political Studies*, Vol. 7, Issue 2, 1959.
69. Lijphart, Arend, 'Consociational Democracy', *World Politics*, Volume
70. *një kryengritje*, (KOHA, Prishtinë, shtator 2008),
71. Pettifer, James, 'The Ahtisaari Report – Totem & Taboo', (Conflict
72. Studies Research Centre, Balkan Series 07/08, Feb. 2007.
73. Poguntke, Thomas dhe Paul Webb (ed.) *The Presidentialization of*
74. *Politics: A Study in Comparative Politics* (Oxford University
75. Press, Oxford, 2005)
76. Pond, Elizabeth, 'Kosovo and Serbia after the French non', *The*
77. *Washington Quarterly*, 28:4, 19-36.
78. Przeworski, Adam, 'Democracy as the contingent outcome of conflicts',
79. në J. Elster & R. Slagstad (eds.), *Constitutionalism and*
80. *Democracy*, (Cambridge, UK: Cambridge University Press, 1988).
81. Putman, Robert D., 'Diplomacy and domestic politics: the logic of töolevel
82. games', *International Organization* / Volume 42 / Issue 03 /
83. Summer 1988.
84. Putman, Robert D., *Making Democracy Work: Civic Tradition in*
85. *Modern Italy* (Princeton Universtiy Press, 1993).
86. Rahat, Gideon dhe Tamir Sheafer, 'The personalization(s) of politics:
87. Israel, 1949– 2003. *Political Communication* 24 (1), 2007, 65–80.
88. Issue 6, 953-970.